

Rep e Shqipërisë
Gjykata e Qrethit Tiranë

11803

Vendim

"J gjiqtarit të votëm"

Unë gjyqtare e Gjykatës së Qrethit
Tiranë Florina Tegu, sot, më dt. 03.08.1995
morë në shqyrtim kërkesën e parqitur nga
drejtori i Drejtorisë së shqërive Publike
Berth Piranian dhe

Konstatova

Se me kërkesën drejtuar gjykatës,
drejtori i Drejtorisë së Shqërive Publike
Berth Piranian kërkon miratimin nga ana e
kësaj gjykate të ekspertëve kontabël Eduart
Kila i cili do të bëjë vlersimin e kapitalit të
Ndërmarrjes së Prodhimeve Refraktore Elbasan në
kuadrin e shëndrimit të kësaj të fundit në shqëri
anonime sipos ligjit 7926 dt. 20.04.1995

Rezulton se Eduart Kila me profesion ekonomist
finance kanë pjesë në listat e ekspertëve kontabël
për vlersimin e kapitalit themelton të
shqërive tregtare të miratuar nga Ministri i Finan-
cave Dylber Vrioni.

Në kushte të tilla në rështim të ligjit 7638
dt. 19.11.1992. nenet 65, 84, 168 e 169 ligjit 7667
dt. 28.01.1993 dhe 7926 dt. 20.04.1995 si dhe
në bazë të deklaratës përkatëse të bëra
përpara gjykatës nga E. Kila ç'moj se ker-
kesa e parogjitur është e lajuar dhe
si e tilla duhet pranu.

P. K. A.

Në bazë të ligjit 7667 dt. 28.01.1993
dhe ligjit 7638 dt. 19.11.1992.

Vandosa

Miratimin si ekspert kontabil të
Eduart Kila's për ulësimin e kapitalit
themeltor të ndërmarrjes së Prodhimit
Refraktora Elbasan në kuadrin e
shëndrimit të kësaj të fundit në
shogëri anonime

Tiranë, më 03.08.1995

Gjyqtore
F. J.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

11803/1

V E N D I M
I Gjyqtarit te vetem

Une gjyqtare e Gjykates se rrethit Tirane M. Dea, sot me date 17.2.96 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Drejtori i Drejtorise se Shoqerive Publike z. Berzh Piranian, lidhur me depozitimimin e urdherit te Ministrit te Financave, z. Dylber Vrioni dhe

K O N S T A T O V A

se me vendimin nr 11803 date 10.08.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, shoqeria anonime, Prodhime refraktare Elbasan eshte rregjistruar si person juridik, me kapital themeltar 420000000. leke.

Me urdherin nr 16/1, date 29.1.1996, te Ministrit te Financave eshte vendosur zmadhimi i kapitalit themeltar te shoqerise Prodhime refraktare Elbasan sh.a, duke futur ne kapitalin themeltar edhe vieren e trualit te objektit Prodhime refraktare Elbasan, prone e shtetit, perfaqesuar nga Ministri i Financave, e cila sipas vleresimit te bere kap shumen 30624000 leke, dhe kapitali themeltar behet gjithsej 450624000 leke.

Nga shqyrtimi i akteve te depozituara rezultoi se kerkesa e paraqitur eshte e bazuar dhe dokumentacioni i paraqitur eshte i plote.

Per keto arsye

Ne baze te nenit 24 te ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992

V E N D O S A

Depozitimimin ne zyren e regjistrimit tregtar te urdherit nr 16/1, date 29.1.1996, te Ministrit te Financave lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise anonime Prodhime refraktare Elbasan, duke u bere shenimi perkates ne fleten e regjistrimit ne kollonen nr 4 dhe 5 me nr rendor 2. Te ndahen rregjistrimet me vije nga njeri tjetri. Te publikohet vendimi i mesiperm.

GJYQTARE

M. Dea
M. Dea

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

V E N D I M

GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 17-1-96 une gjyqtarja e Gjykates se rrethit Tirane M. Deda
mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Ministri Dylber Vrioni per depozitim
ne regjistrin tregtar te urdherit per transferimin e aksioneve nga shteti tek persona
te trete si dhe listen e aksionereve qe ju eshte transferuar aksioni ne baze te nenit
198 te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe

Konstatova

Se aktet e paraqitura nga kerkuesi jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

Per kete arsye

Ne baze te nenit 2 te ligjit 7667 date 28.01.1993.

V e n d o s a :

- Pranimin e kerkeses
- Depozitim e urdherit Nr.2/17 date 26.10.1995 te aksionerit te vetem te shoqerise duke bere shenimin ne fleten perkatese te regjistrit, ne kollonen Nr.4 dhe 5 me Nr. rendor me kete permbajtje:
shlyt sh. aksioneve 100% te sht. Repartit Elbari.
Numri aksionerit 371.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije.

Tirane, me 17-1-1996

GJYQTARE

M. Deda

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

V E N D I M

GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 17-7-96 une gjyqtarja e Gjykes se rrethit Tirane M. Desh.
mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Ministri Dylber Vrioni per depozitimin
ne rregjistrin tregtar te urdherit per transferimin e aksioneve nga shteti tek persona
te trete si dhe listen e aksionereve qe ju eshte transferuar aksioni ne baze te nenit
198 te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe

Konstatova

Se aktet e paraqitura nga kerkuesi jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

Per kete arsye

Ne baze te nenit 2 te ligjit 7667 date 28.01.1993.

V e n d o s a :

- Pranimin e kerkeses

- Depozitimin e urdherit Nr.2/17 date 26.10.1995 te aksionerit te vetem te
shoqerise duke bere shenimin ne fleten perkatese te regjistrit, ne kollonen Nr.4 dhe
5 me Nr. rendor me kete permbajtje.

*Privatizimi n.p.u
shlyti ne aksionere. 100% te S.A.A.
Refraktore Elbasan.
Numri aksionerit 371.*

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije.

Tirane, me 17-7- 1996

GJYQTARE

Megjone Desh.
M. Desh.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA RRETHIT TIRANE

Nr. 11803/2 Akti

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane MARJANA DEDI sot me date 04.7.96 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Kryetari i Asamblese se Aksionereve te Shoqerise Anonime "REFRAKTARE sh. a." Elbasan per depozitimin e Vendimeve te Asamblese se Aksionereve per ndryshimet ne Aktet e themelimit te Shoqerise, per zgjedhjen e Keshillit Mbikqyres, proces-verbalet e mbledhjes se aksionereve si dhe listen e aksionereve qe u jane transferuar aksionet ne baze te nenit 198 te Ligjit 7638 date 19. 11. 1992 dhe

KONSTATOVA

se vendimet e paraqitura nga Kerkuesi jane te plota dhe Kerkesa e bazuar ne Ligj

PER KETE ARESYE

Ne baze te nenit 24 te ligjit 7667 dt. 28. 01. 1993

V E N D O S A

- Pranimin e kerkeses
- Depozitimin e Vendimit Nr. 1 dhe Nr. 2 date 05. 04. 1996 te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise "REFRAKTARE sh. a." Elbasan duke bere shenimin ne Fleten perkatese te Rregjistrimit, ne kollonen nr. 4 dhe 5 me Nr. 3 rendor me kete permbajtje:

Vendim per zgjedhjen e Keshillit Mbikqyres me keta anetare:

1. Edmond Karafili
2. Agron Shaplllo
3. Grigor Dhaskali

Vendim i Asamblese per ndryshime ne statut dhe ne aktin e themelimit.
Te ndahen regjistrimet me vije njeri nga tjetri.

GJYQTARE

Tirane me 04.7.96

MARIANA DEDI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 11803/05 Akti

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 28.7.2000 une gjyqtarja, Merita Gjiriti, prane Gjykates rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e shoqerise tregetare **REFRAKTARE** sha Elbasan dhe aktet bashkelidhur saj per depozitimin e Vendimit te Asamblese se Jashtezakoneshme te aksionereve date 31.5.2000,

K O N S T A T O V A

Se me Vendim te Gjykates rrethit Tirane Nr.11803 date 10.8.1995 eshte vendosur rregjistrimi si person juridik i shoqerise tregetare Prodhime Refraktare sha Elbasan me aksioner te vetem Ministrine e Financave.

1) Me Vendimin e Gjykates rrethit Tirane Nr.11803/1 date 23.2.1996 eshte vendosur depozitimi i Urdherit Nr.16/1 date 29.1.1996 i Ministrise se Financave lidhur me zmadhimin e kapitalit te shoqerise tregetare Prodhime Refraktare sha Elbasan, nga 420.000.000 leke ne 450.624.000 leke.

2) Me Vendim te Gjykates rrethit Tirane date 17.7.1996 eshte vendosur depozitimi i Urdherit Nr.2/17 date 26.10.1995 te aksionerit te vetem, lidhur me privatizimin nepermjet shitjes te 100 % te aksioneve te shoqerise tregetare **REFRAKTARE** sha, Elbasan.

3) Me Vendimin e Gjykates rrethit Tirane Nr 11803/2 date 24.7.1996 eshte vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 dhe Nr.2 date 5.4.1996 te Asamblese te jashtezakoneshme te aksionereve te shoqerise tregetare **REFRAKTARE** sha Elbasan per ndryshimet ne Statut dhe ne Aktin e Themelimit, si dhe zgjedhjen e antareve te Keshillit Mbikqyres.

4) Me Vendimin e Asamblese se jashtezakoneshme te aksionereve te shoqerise tregetare **REFRAKTARE** SHA Elbasan, Nr 1, dt. 31/5/2000, eshte aprovuar raporti i ekspertit kontabel te autorizuar Z. Edmond Kila, per zvogelimin e kapitalit, jo duke patur si shkak humbjet dhe eshte vendosur zvogelimi i kapitalit te shoqerise tregetare **REFRAKTARE** sha ne masen 110.000.0000 leke. Mbas realizimit te ketij zvogelimi, kapitali do te behet

340.624.000 leke, me vlere nominale te aksionit te pandryshuar dhe pakesim te numrit te aksioneve per cdo aksioner, ne perpjestim me pjesen e tyre ne kapital .

Sa me siper Gjykata cmon te pranoje kerkesen per depozitim e vendimit Nr. 1 date 31/5/2000 te Asamblese se Jashtezakoneshme te shoqerise tregetare REFRAKTARE sha Elbasan per zvogelimin e kapitalit dukre u detyruar shoqeria te respektoje kushtet e parashikuara ne nenin 165 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 lidhur me fillimin e operacionit te zvogelimit te kapitalit, mbas mbarimit te afatit te kundershimit te kreditorëve apo perfundimit te gjykimit te kundershimeve te mundeshme te kreditorëve, afat qe nis me publikimin te ndryshimit ne statut dhe qe ka te beje me kete rast me zvogelimin e kapitalit themeltar.

PER KETE ARESYE

Gjykata ne baze te Ligjeve Nr. 7667 date 28.1.1993 dhe Nr. 7638 date 19.11.1992

VENDOSI

Depozitim e Vendimit te Asamblese se Jashtezakoneshme te Shoqerise Tregetare REFRAKTARE sha Elbasan Nr. 1, date 31.05.2000. *dhe kapaciteti e ekspertit kontabil te autorituar*

Te behet publikimi i Vendimit te mesiperm sipas ligjeve Nr. 7632, date 4.11.1992, Nr. 7638 date 19.11.1992 dhe Nr. 7667, date 28.01.1993.

GJYQTARE
Merita Gjirati



V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 12.02.2002 une, gjyqtarja e gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqerise "REFRAKRATE" SH.A. Z. Vasil Dhono, per depozitimin ne zyren e regjistrimit tregetar te dokumentave te paraqitur ne emer te shoqerise aksionere te emertuar "REFRAKTARE" SH.A.

KONSTATOVA

Se shoqeria aksionere "REFRAKTARE" SH.A. regjistruar Person Juridik me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.11803 date 10.08.1995, ne mbledhjen e asamblese se aksionereve te shoqerise te dates 25.01.2002 ,ne baze te rezultatit te votimit 70% te aksionereve, eshte vendosur :

1. Ndryshimi i numri te anetareve te Keshillit Mbikqyres nga 4 ne 3 antare dhe
2. Zgjedhja e anetareve te Keshillit mbikqyres, te cilet jane:

- Edmond Karafili kryetar,
- Agron Shaplo anetar dhe
- Edmond Tafa antear.

Ne baze te vendimit te keshillit te ri mbikqyres me nr.1/V-02 date 25.01.2002, emerimin e drejtorise se Shoqerise "REFRAKTARE" SH.A. me personat dhe funksionet perkatese si me meposhte:

- Vasil Dhono Drejtor Ekzekutiv,
- Edi Stafa Drejtor Ekonomik dhe
- Besnik Avdiaj Drejtor Prodhimi

Dhe depozitimin prane Zyres se Regjistrimit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, vendimet e asamblese se aksionereve te shoqerise "REFRAKTARE"SH.A. date 25.01.2002 dhe te Keshillit Mbikqyres te shoqerise me nr.1/V-02 date 25.01.2002, si dhe pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise.

Per sa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :

Ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 " Per regjistrimin tregetar" dhe ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare"

VENDOSA :

Pranimin e kerkeses per depozitimn ne zyren e regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit te asamblese se aksionereve te shoqerise "REFRAKTARE" SH.A. date 25.01.2002 dhe te vendimit 1/ V – 02 date 25.01.2002 te Keshillit Mbikqyres te saj, dhe


Te urdherohet Zyra e Regjistrin Tregetar te Gjykates Tirane te beje ndryshimet ne kolonen germa..... ne regjistrin tregetar ne lidhje me ndryshimin e Keshillit Mbikqyres dhe te drejtorise e shoqerise.

Te ndahen regjistrimet njeri nga tjetri me vije tse kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

Enkela Bajo

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Enkela Bajo', is written over a diagonal line that extends from the bottom left towards the top right.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE RRETHIT TIRANE
NR.....11803/4 VENDIMIT

V E N D I M I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date.....23.7.03 une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare e Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga drejtori ekzekutiv i shoqerise REFRAKTARE SH.A Elbasan, z.Vasil Dhono per plotesimin ne Vendimin e Gjykates te shteses se objektit te veprimtarise te shoqerise Anonime Refraktare Elbasan, ne perputhje me Vendimin Nr.11803/2 date 24.7.96 te Gjykates se Rrethit Tirane

KONSTATOVA

Se Shoqeria Anonime REFRAKTARE SH.A , regjistruar Person Juridik me vendim e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 11803 date 10.08.1995, ne mbledhjen e asamblese te aksionereve date 24.04.1996 me Vendimin Nr.1, asambleja ka vendosur per ndryshime ne Aktin e themelimit dhe Statutin e shoqerise, te cilat jane pasqyruar dhe depozituar me Vendimin Nr.11803/2 date 24.7.1996. Sipas ketij vendimi te kesaj mbledhje te Asamblese objekti I veprimtarise se shoqerise eshte shtuar si me poshte vijon:

“Veprimtari prodhuese per materiale refraktare e qeramike, ndertimore, inerte, mineralogjike, konstruksione metalike, pajisje e makineri duke

perdorur burimet e brendshme dhe ato jashte vendit. Veprimtari ndertimi duke perfshire ato civile e industriale. Veprimtari transportuese brenda dhe jashte vendit te mallrave per vete dhe per te trete.

Veprimtari eksportuese dhe importuese te lendeve te para, produkteve te gateshme, mineraleve, naftes si dhe produkteve te tyre, pajisje e makineri si dhe linja industriale.

Veprimtari tregetare perfshire tregetimin e mallrave industriale dhe ndertimore si dhe pajisje e makineri e linja industriale.

Veprimtari studimore dhe projektuese ne fusha te ndryshme te ekonomise, ndertimore, mekanike dhe elektrike, etj.

Veprimtari investuese dhe financuese ku shoqeria do te perdore per kete qellim fonde te saj si dhe fonde te institucioneve financiare dhe bankare vendase e te huaja, private e publike, marrje dhe dhenje me qera objekte dhe mjete, pajisje dhe zyra, ambiente te ndryshme, pasuri te lujtshme e te palujtshme.

Brenda kuadrit te dispozitave ligjore shoqeria ka te drejte te marre te gjitha masat dhe te kryeje çdo biznes brenda dhe jashte vendit te pershtatshem per arritjen e qellimit te shoqerise, kjo e cila perfshin krijimin e filialeve te reja brenda e jashte vendit, blerjen dhe krijimin e subjekteve te tjera ekonomike dhe interesat e saj per pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.”

Per sa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te Nenit 17 te Ligjit 7667 date 28.01.1993 “Per regjistrin tregetar”,

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses se shoqerise REFRAKTRE SH.A Elbasan per plotesimin e shteses te objektit te veprimtarise se shoqerise si me poshte vijon:

“Veprimtari prodhuese per materiale refraktare e qeramike, ndertimore, inerte, mineralogjike, konstruksione metalike, pajisje e makineri duke perdorur burimet e brendshme dhe ato jashte vendit. Veprimtari ndertimi duke perfshire ato civile e industriale. Veprimtari transportuese brenda dhe jashte vendit te mallrave per vete dhe per te trete.

Veprimtari eksportuese dhe importuese te lendeve te para, produkteve te gateshme, mineraleve, naftes si dhe produkteve te tyre, pajisje e makineri si dhe linja industriale.

Veprimtari tregtare perfshire tregetin e mallrave industriale dhe ndertimore si dhe pajisje e makineri e linja industriale.

Veprimtari studimore dhe projektuese ne fusha te ndryshme te ekonomise, ndertimore, mekanike dhe elektrike, etj.

Veprimtari investuese dhe financuese ku shoqeria do te perdore per kete qellim fonde te saj si dhe fonde te institucioneve financiare dhe bankare vendase e te huaja, private e publike, marrje dhe dhenje me qera objekte dhe mjete, pajisje dhe zyra, ambiente te ndryshme, pasuri te lujtshme e te palujtshme.

Brenda kuadrit te dispozitave ligjore shoqeria ka te drejte te marre te gjitha masat dhe te kryeje çdo biznes brenda dhe jashte vendit te pershtatshem per arritjen e qellimit te shoqerise, kjo e cila perfshin krijimin e filialeve te reja

brenda e jashte vendit, blerjen dhe krijimin e subjekteve te tjera ekonomike dhe interesat e saj per pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.”

GJYQTARE

Blanca Zepke
Beq

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË, TIRANË
Nr. 11803/5 Akti

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot më datë 23.12.2004, Unë [Signature]..... gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, mora në shqyrtim kerkesen e kërkuessit VASIL DHONO, i biri i Llazit, lindur në Ersekë, më 1950, banues në Elbasan, me cilesinë e Drejtorit Ekzekutiv të shoqërisë anonime “REFRAKTARE” sh.a, për depozitimin e dokumentave pranë Zyres së Regjistrimit Tregtar për rritjen e kapitalit të kësaj shoqërie. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

K O N S T A T O V A

Shoqëria anonime “Prodhime Refraktare”sh.a, Elbasan është regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me vendimin 11803 datë 10.08.1995, me aksioner të vetem Ministrinë e Financave.

Me vendimin 11803/1 date 23.02.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.16/1 datë 29.01.1996 i Ministrisë së Financave lidhur me zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “Prodhime Refraktare” sh.a Elbasan, nga 420.000.000 leke në 450.624.000 Lekë.

Me vendimin e datës 17.07.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.2/17 datë 26.10.1995 të aksionerit të vetëm të shoqërisë, lidhur me privatizimin nëpërmjet shitjes 100% të aksioneve të shoqërisë tregtare Refraktare sh.a Elbasan.

Me vendimin 11803/2 date 24.07.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 dhe Nr.2 date 05.04.1996 të Asamblese së Jashtezakonshme të aksionereve të Shoqërisë tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan për ndryshimet në statut dhe në aktin e Themelimit, si dhe zgjedhjen e antareve të Këshillit Mbikëqyres.

Me vendimin e dates 28.07.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 date 31.05.2000 të Asamblese së Jashtezakonshme të Aksionereve të Shoqërisë tregtare “REFRAKTARE” sh.a Elbasan, me të cilën është aprovuar raporti i ekspertit kontabël të autorizuar Eduart Kila për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë tregtare “REFRAKTARE” sh.a në masën 110.000.000 Lekë, dhe pas kësaj kapitali i shoqërisë është 340.624.000 Lekë.

Me vendimin 11803/3 date 12.02.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit të date 25.01.2002 të Asamblese së Aksionereve të Shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a Elbasan, në të cilën është vendosur: 1- Ndryshimi i numrit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga 4 në 3 antarë dhe 2- Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të cilët janë: Edmond Karafili, Kryetar, Agron Shaplo anetar dhe Edmond Tafa anëtar dhe vendimi Nr.1/V-02 date 25.01.2002 i Këshillit Mbikëqyrës me të cilën është vendosur emërimi i drejtorisë së shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a më përbërje si më poshtë: 1. Vasil Dhono, Drejtor Ekzekutiv, 2. Edi Stafa, Drejtor Ekonomik e 3. Besnik Avdiaj drejtor prodhimi.

Me vendimin e dates 11803/4 date 23.07.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur për shtese në objektin e veprimtarisë së shoqërisë "Refraktare" sh.a Elbasan.

Me vendimin e Asamblese së Aksionerve të shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a Elbasan, datë 25.06.2004 është vendosur:

- Rezerva nga rivleresimi prej 66.856.706 (Gjashtedhjetë e gjashtë milionë e teteqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e gjashtë) Lekë të kalojë në rritje të kapitalit të shoqërisë.
- Rezerva ligjore në masën 30.062.400 (tridhjetë milion e gjashtedhjetë e dy mijë e katerqind) Lekë të kalojë në rritje të kapitalit të shoqërisë.
- Fondi rezerve në masën 30.079.313 (tridhjetë milion e shtatedhjetë e nente mijë e treqind e trembedhjetë) Lekë të kalojë në rritje të kapitalit të shoqërisë.
- Fitimi i vitit 2003 në masën 35.564.581 (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e gjashtedhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) Lekë të kalojë në rritje të kapitalit të shoqërisë.

Në këtë mënyrë, pas rritjeve të mësipërme të kapitalit të shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a Elbasan, kapitali i shoqërisë nga 340.624.000 Lekë bëhet 503.187.000 (peseqind e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtate mijë) Lekë.

- Miratimi i raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar z. Eduart Kila, me të cilin është bërë certifikimi rritjes së kapitalit nga 340.624.000 Lekë bëhet 503.187.000 (peseqind e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtate mijë) Lekë
- Ekspert Kontabël i Autorizuar për auditimin e shoqërisë rizgjidhet z. Eduart Kila.

Gjithshtu, nga raporti i ekspertit kontabel të autorizuar z. Eduart Kila, datë 28 Maj 2004, konstatohet se është bërë certifikimi i rritjes së kapitalit, të shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a, Elbasan.

Pasi shqyrtova kerkesen e tij dhe çmova se ajo është e drejte dhe e bazuar në ligj, si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitimim ne Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, të Vendimit e Asamblesë së Aksionereve të shoqerise "REFRAKTARE"sh.a datë 26.06.2004, me të cilin është vendosur:
 - 1- Rezerva nga rivleresimi prej 66.856.706 (Gjashtedhjetë e gjashtë milionë e teteqind e pesedhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e gjashtë) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
 - 2- Rezerva ligjore ne masen 30.062.400 (tridhjetë milion e gjashtedhjetë e dy mijë e katerqind) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
 - 3- Fondi rezerve ne masen 30.079.313 (tridhjetë milion e shtatedhjetë e nente mijë e treqinde trembedhjetë)Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
 - 4- Fitimi i vitit 2003 në masën 35.564.581 (tridhjetë e pese milion e peseqind e gjashtedhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.

Pas rritjeve të mësipërme, kapitali i shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a nga 340.624.000 Lekë bëhet 503.187.000 (peseqind e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtate mijë) Lekë.

 - 5- Miratohet raporti i Ekspertit Kontabel të Autorizuar z. Eduart Kila, date 28 Maj 2004, me të cilin është bërë vlerësimi i rritjes së kapitalit të Shoqërisë "REFRAKTARE"sh.a, Elbasan nga 340.624.000 Lekë bëhet 503.187.000 (peseqind e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtate mijë) Lekë.
 - 6- Ekspert Kontabël i Autorizuar për auditimin e shoqërisë rizgjidhet z. Eduart Kila.
 - Depozitimim ne Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë të proces-verbalit të mbledhjes se Asamblese se Aksionereve te shoqerise "REFRAKTARE"sh.a Elbasan, te datës 25.06.2004.
 - Depozitimim ne Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë të raportit te ekspertit kontabël të autorizuar lidhur me vlerësimin zmadhimit të kapitalit të shoqërisë datë 28 Maj 2004.
 - Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor në kollonën duke bere vijezimet me boje te kuqe.

GJYQTARE
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. ___ Prot. *11803*

V E N D I M

PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date *10.08* 1995, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, si shqyrtova kerkesen dhe materialet e paraqitura nga Ministria e Financave per regjistrimin e shoqerise tregtare: Ndermarrja "Prodhime Refraktare" Elbasan ne formen e nje shoqerie anonime :

KONSTATOVA SE :

Kerkuesi Ministria e Financave ka paraqitur kerkesen per t'u rregjistruar si person juridik shoqerine ne formen e nje shoqerie anonime "Prodhime Refraktare" Elbasan me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapital themeltar 420.000.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, perfaqesuar nga Drejtoria e Shoqerive Publike, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke me objekt: prodhim dhe tregtim tulla dhe materiale refraktare ,tulla per ndertim dhe sherbime per te trete ne fusha te ndryshme.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, Urdher Nr.4, date 5.07.1995 i ministrise se Financave, kerkese per miratim eksperti jane te plote dhe te bazuar ne ligj dhe si te tille duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare", si dhe nenit 33 ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te.

V E N D O S A


Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "Prodhimeve Refraktare" Elbasan me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapitali themeltar 420.000.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, perfaqesuar nga Drejtoria e Shoqerive Publike, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke dhe me

objekt: prodhim dhe tregtim tulla dhe materiale refraktare, tulla per ndertim dhe sherbime per te trete ne fusha te ndryshme..Selia e shoqerise eshte ne Elbasan. Anetare te Keshillit Mbikqyres jane :

1. Merita Kafexhiu
2. Pjereta Dauti
3. Gezim Dauti

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

G J Y Q T A R E


Florina Pëgu

Tirane,me 10.03 1995

6

**V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M**

Sot më datë 06.12.2005. Unë A. Celço..... gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e kërkuessit Edi Stafa, i biri i Fiqiret, i lindur me 13.12.1969, në Elbasan dhe, banues në Elbasan, Lagjia "28 nentori", rruga "Abdyl Frashri Nr.28" me cilesinë e Drejtorit Ekzekutiv i shoqërisë anonime "REFRAKTARE" sh.a. për depozitimin e dokumentave pranë Zyres së Regjistrimit Tregtar vendimin e Këshillit Mbikëqyrës datë 01.11.2005. Pasi shqyrtova kërkesën e tij.

K O N S T A T O V A

Shoqëria anonime "Prodhime Refraktare" sh.a, Elbasan është regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me vendimin 11803 datë 10.08.1995, me aksioner të vetëm Ministrinë e Financave.

Me vendimin 11803/1 datë 23.02.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.16/1 datë 29.01.1996 i Ministrisë së Financave lidhur me zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Prodhime Refraktare" sh.a Elbasan, nga 420.000.000 leke në 450.624.000 Lekë.

Me vendimin e datës 17.07.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.2/17 datë 26.10.1995 të aksionerit të vetëm të shoqërisë, lidhur me privatizimin nëpërmjet shitjes 100% të aksioneve të shoqërisë tregtare Refraktare sh.a Elbasan.

Me vendimin 11803/2 datë 24.07.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 dhe Nr.2 datë 05.04.1996 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionereve të Shoqërisë tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan për ndryshimet në statut dhe në aktin e Themelimit, si dhe zgjedhjen e antarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Me vendimin e datës 28.07.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 datë 31.05.2000 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionereve të Shoqërisë tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan, me të cilën është aprovuar raporti i ekspertit kontabël të autorizuar Eduart Kila për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë tregtare "REFRAKTARE" sh.a në masën 110.000.000 Lekë, dhe pas kësaj kapitali i shoqërisë është 340.624.000 Lekë.

Me vendimin 11803/3 datë 12.02.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit të datë 25.01.2002 të Asamblesë së Aksionereve të Shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a Elbasan, në të cilën është vendosur: 1- Ndryshimi i numrit të antarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga 4 në 3 antarë dhe 2- Zgjedhja e antarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të cilët janë: Edmond Karafili, Kryetar, Agron Shaplllo anëtar dhe Edmond Tafa anëtar dhe vendimi Nr.1/V-02 datë 25.01.2002 i Këshillit Mbikëqyrës me të cilën është vendosur emerimi i drejtorisë së shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a në përbërje si më poshtë: 1.Vasil Dhono, Drejtor Ekzekutiv, 2.Edi Stafa, Drejtor Ekonomik e 3.Besnik Avdiqaj drejtor prodhimi.

Me vendimin e dates 11803/4 date 23.07.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur për shtese në objektin e veprimtarisë së shoqërisë "Refraktare" sh.a Elbasan.

Me vendimin e dates 11803/5 date 23.12.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur rritja e kapitalit të shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a. dhe kapitali i shoqërisë është bërë 503.187.000 (peseqind e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) Lekë.

Këshilli Mbikëqyres i shoqërisë "REFRAKTARE" Sh.a në mbledhjen e dates 01.11.2005 ka vendosur:

- 1- Lirimin nga detyra Drejtorit Ekzekutiv të Refraktare Sh.a, zotin Vasil Dhono.
 - 2- Lirimin nga detyra e Drejtorit Ekonomik të shoqërisë Refraktare Sh.a, zotin Edi Stafa.
 - 3- **Te emëroje në detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të shoqërisë Refraktare Sh.a, z. EDI STAFJA.**
 - 4- Kohezgjatja e mandatit të Drejtorit Ekzekutiv, Z. Edi Stafa të jete 2 vjet.
 - 5- Pagesa e z. Edi Stafa do të fillje nga data 01.11.2005 me page mujore neto 120.000 Leke.
 - 6- Ky vendim hyn në fuqi menjëher, duke filluar efektet nga data 01.11.2005.
- Bashkelidhur kësaj kërkesë gjenden procesverbalit i mbledhjes së datës 01.11.2005, vendimin e Këshillit Mbikëqyres të kësaj shoqërie.

Pasi shqyrtova kërkesën e tij dhe çmova se ajo është e drejte dhe e bazuar në ligj, si e tillë duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Dhe në bazë të ligjit 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe të ligjit 7667 date 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar".

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, të Këshillit Mbikëqyres të shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a datë 01.11.2005, me të cilin është vendosur:
 1. Lirimin nga detyra Drejtorit Ekzekutiv të Refraktare Sh.a, zotin Vasil Dhono.
 2. Lirimin nga detyra e Drejtorit Ekonomik të shoqërisë Refraktare Sh.a, zotin Edi Stafa.
 3. **Te emëroje në detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të shoqërisë Refraktare Sh.a, z. EDI STAFJA.**
 4. Kohezgjatja e mandatit të Drejtorit Ekzekutiv, Z. Edi Stafa të jete 2 vjet.
 5. Pagesa e z. Edi Stafa do të fillje nga data 01.11.2005 me page mujore neto 120.000 Leke.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëher, duke filluar efektet nga data 01.11.2005.
- Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë të proces-verbalit të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyres të shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a Elbasan, të datës 01.11.2005.
- Urdhërimin e zyrës së Regjistrin Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr. rendor në kolumnën duke bërë vijezimet me boje të kuqe.

GJYQTARE
A. M. M. Depo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR, TIRANË
Nr. 11803/1 Akti

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot më datë 20.06.2006, Unë Ariona Coco (Garibordiu) gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mora në shqyrtim kerkesen e kërkuarit Edi Stafa, i biri i Fiqiret, i lindur me 13.12.1969, në Elbasan dhe, banues në Elbasan, Lagjia "28 nentori", rruga "Abdyl Frashri Nr.28" me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv i shoqërisë anonime "REFRAKTARE" sh.a, për depozitim dhe dokumentave pranë Zyres së Regjistrimit Tregtar, vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të kësaj shoqërie, datë 12.05.2006 dhe vendimin e Këshillit Mbikëqyres date 15.05.2006. Pasi shqyrtova kerkesen e tij dhe aktet që e shoqërojnë,

K O N S T A T O V A

Shoqëria anonime "Prodhime Refraktare" sh.a, Elbasan është regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me vendimin 11803 datë 10.08.1995, me aksioner të vetem Ministrinë e Financave.

Me vendimin 11803/1 date 23.02.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.16/1 datë 29.01.1996 i Ministrisë së financave lidhur me zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Prodhime Refraktare" sh.a Elbasan, nga 420.000.000 leke në 450.624.000 Lekë. Me vendimin e datës 17.07.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.2/17 datë 26.10.1995 të aksionerit të vetëm të shoqërisë, lidhur me privatizimin nëpërmjet shitjes 100% të aksioneve të shoqërisë tregtare Refraktare sh.a Elbasan.

Me vendimin 11803/2 date 24.07.1996 të Gjykatës së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 dhe Nr.2 date 05.04.1996 të Asamblese së Jashtëzakonshme të aksionerëve të Shoqërisë tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan për ndryshimet në statut dhe në aktin e Themelimit, si dhe zgjedhjen e antarëve të Këshillit Mbikëqyres.

Me vendimin e dates 28.07.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 date 31.05.2000 të Asamblese së Jashtëzakonshme të aksionerëve të Shoqërisë tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan, me të cilën është aprovuar raporti i ekspertit kontabël të autorizuar Eduart Kila për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë tregtare "REFRAKTARE" sh.a në masën 110.000.000 Lekë, dhe pas kësaj kapitali i shoqërisë është 340.624.000 Lekë.

Me vendimin 11803/3 date 12.02.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit të date 25.01.2002 të Asamblese së Aksionerëve të Shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a Elbasan, në të cilën është vendosur: 1- Ndryshimi i numrit të antarëve të Këshillit Mbikëqyres nga 4 në 3 antarë dhe 2- Zgjedhja e antarëve të Këshillit Mbikëqyres, të cilët janë: Edmond Karafili, Kryetar, Agron Shapllo anetar dhe Edmond Tafa anetar dhe vendimi Nr.1/V-02 date 25.01.2002 i Këshillit Mbikëqyres me të cilën është vendosur emerimi i drejtorisë së shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a më përbërje si më poshtë: 1.Vasil Dhono, Drejtor Ekzekutiv, 2.Edi Stafa, Drejtor Ekonomik e 3.Besnik Avdiaj drejtor prodhimi.

Me vendimin e dates 11803/4 date 23.07.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur për shtese në objektin e veprimtarisë së shoqërisë "Refraktare" sh.a Elbasan.

Me vendimin e dates 11803/5 date 23.12.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur rritja e kapitalit të shoqërisë "REFRAKTARE" sh.a, dhe kapitali i shoqërisë është bërë 503.187.000 (peseqind e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtate mijë) Lekë.

Me vendimin e dates 11803/6 date 06.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur, depozitimi i vendimit të Këshillit Mbikëqyres i dates 01.11.2005 është vendosur: Lirimi nga detyra Drejtorit Ekzekutiv të Refraktare Sh.a, zotin Vasil Dhono. Lirimin nga detyra e Drejtorit Ekonomik të shoqërisë Refraktare Sh.a, zotin Edi Stafa. **Te emëroje në detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të shoqërisë Refraktare Sh.a z. EDI STAFA.** Kohezhgatja e mandatit të Drejtorit Ekzekutiv, Z. Edi Stafa të jete 2 vjet. Pagesa e z. Edi Stafa do të fillje nga data 01.11.2005 me page mujore neto 120.000 Leke.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve e shoqërisë "Refraktare" sh.a, Elbasan më datë 12.05.2006 me vendimin e saj Nr. **2&3/12.05.2006 ka vendosur:**

Vendimi 2/12.05.2006

- *Të ndryshojë Nenin 27 të Statutit të shoqërisë, si më poshtë vijon:*
"Këshilli Mbikëqyrës përbehet nga 3(tre) anëtarë. Kohëzgjatja e funksionimit të tyre është 6(gjashtë) vjet, ku çdo vit shtrihet midis Asamblesë të Zakonshme Vjetore të njëpasnjëshme"

Vendimi 3/12.05.2006

- *Të zgjedhë Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë me përbërje si më poshtë:*
 - Edmond Karafili, anëtar.
 - Agron Shaplo, anëtar.
 - Edmond Tafa, anëtar.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 6 vjet, dhe fillon nga data 12.05.2006
Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë "Refraktare" Elbasan sh.a, i zgjedhur nga Asambleja e Jashtëzakonshme e datës 12.05.2006, në mbledhjen e tij të dates 15.05.2005 është konstituuar si organ dhe ka vendosur:

- **Të zgjedhë si Kryetar të Këshillit Mbikëqyrës, zotin Edmond Karafili, për një periudhë 6 vjeçare.**
- **Ngarkon zotin Edi Stafa, Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë, të depozitojë vendimet 2&3/12.05.2006 dhe vendimin e Këshillit Mbikëqyrës në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.**

Pasi shqyrtova kërkesen e tij dhe aktet e shoqërisë "REFRAKTARE"sh.a çmova se ajo është e drejte dhe e bazuar ne ligj, si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar",

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Depozitimim ne Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të vendimit Nr. **2&3/12.05.2006** të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve e shoqërisë "Refraktare"sh.a, Elbasan më datë 12.05.2006, me të cilat është vendosur:
 - **Vendimi 2/12.05.2006** : *Të ndryshojë Nenin 27 të Statutit të shoqërisë, si më poshtë vijon:*
"Këshilli Mbikëqyrës përbehet nga 3(tre) anëtarë. Kohëzgjatja e funksionimit të tyre është 6(gjashtë) vjet, ku çdo vit shtrihet midis Asamblesë të Zakonshme Vjetore të njëpasnjëshme"
 - **Vendimi 3/12.05.2006**: *Të zgjedhë Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë me përbërje si më poshtë:*
 - Edmond Karafili, anëtar.
 - Agron Shaplo, anëtar.
 - Edmond Tafa, anëtar.
 - **Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 6 vjet, dhe fillon nga data 12.05.2006.**
- Depozitimim ne Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të vendimit të konstituimit të Këshillit Mbikëqyrës i Shoqërisë "Refraktare" Elbasan sh.a, datë **15.05.2005**, me të cilin është vendosur:
 - **Të zgjedhë si Kryetar të Këshillit Mbikëqyrës, zotin Edmond Karafili, për një periudhë 6 vjeçare.**
- Depozitimim ne Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë të procesverbalit te mbledhjes se Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionereve datë 12.05.2006 dhe të procesverbalit të mbledhjes së këshillit Mbikëqyrës datë 15.05.2006.
- Urdherimin e zyres se Regjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese me nr. rendor ne kollonen duke bere vijezimet me boje te kuqe.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

G J Y Q T A R E

Ariona Cas (Guvernatori)



Ukolica - registri

1/3 ' ' 1

2 (a) "Priloga" "Produkcije Republike
Ekonomske"

(b) Ekonomske

(c) "Produkcija i trgovina
u materijalnoj sferi"

(d) 420.000.000 dinara

3 "Klasifikacija
linija"

"Klasifikacija
poslova"

"Klasifikacija
poslova"

4 Statuti E m/Sluzbeni št 03.03.

1965

5. št 10 08. 1965.

Statuti 10 10. 1965.

2 "Klasifikacija
poslova"

-> "Klasifikacija
poslova"

-> "Klasifikacija
poslova"

-> "Klasifikacija
poslova"

Predložak X

Priloga
Ekonomske

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 2.08.1995, Ministria e Financave, ne baze te ligjit Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetere ne shoqeri tregtare" Ministri i Financave, vendosi

1. Te krijoj shoqerine anonime te Ndermarrjes se Prodhimeve Refraktare Elbasan .

2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete prodhim dhe tregtim tulla dhe materiale refraktare, tulla per ndertim dhe sherbime per te trete ne fusha te ndryshme.

3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Elbasan ajo mund te çele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithe Territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.

4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 420.000.000 leke, i ndare ne 420.000 aksione me vlere nominale 1.000 per aksion.

5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.

6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :

1. Merita Kafexhiu

2. Pjereta Sata

3. Gezim Dauti

7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE



STATUT

I

SHOQERISE ANONIME

Ne baze te dispozitave te ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", me autorizim te Ministrit te Financave, Z. Berzh Piranian, Drejtor i Drejtorise te Shoqerive Publike nenshkruan statutin e shoqerise anonime si me poshte :

Neni 1

Shoqeria anonime formohet nga transformimi i Ndermarrjes Prodhimeve Refraktare Elbasan (SH.A.).

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet shoqeria anonime Ndermarrja Prodhimeve Refraktare Elbasan.

Selia e shoqerise eshte ne Elbasan.

Neni 2


Objekti i shoqerise eshte prodhim dhe tregtim tulla dhe materiale refraktare, tulla per ndertim dhe sherbime per te trete ne fusha te ndryshme.

Shoqeria, brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e sipermarrjeve te tjera dhe pjesemarrjen ne sipermarrje te tjera si brenda, ashtu edhe jashte vendit.

Neni 3

Kapitali themeltar-aksionet

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 420.000.000 leke. Ai eshte i ndare ne 420.000 aksione te se njejtës kategori, te cilat zoterohen teresisht nga shteti.



para nominale e aksionit eshte 1.000 leke.

Ne shumen e kapitalit te shoqerise nuk eshte perfshire vlera e truallit, gje qe do te behet ne nje kohe te dyte perpara se shoqeria te privatizohet ose ne momentin e privatizimit.

Neni 4

Shitja e aksioneve ne rastin e privatizimit.

Aksionet e shoqerise mund t'u shiten personave fizike e juridike shqiptare vetem ne rastin e nje vendimi te marre nga Ministri i Financave per privatizimin e shoqerise nepermjet bonove te privatizimit dhe/ose lekeve te privatizimit.

Personat e huaj, fizike a juridike, mund te blejne aksione te shoqerise vetem ne rastet dhe ne masen e caktuar nga Ministri i Financave. Shlyerja e aksioneve nga personat e huaj, fizike a juridike, behet vetem me para ose me anen e kontributeve ne natyre per qellime teknologjike.

Neni 5

Organet drejtuese

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Keshilli mbikqyres.
2. Drejtori i pergjithshem

Neni 6

Keshilli mbikqyres

- I. Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 anetare.
Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen :
1/3 nga Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike
2/3 nga ministri i Finances

II. Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar vetem per shkaqe te perligjura.



III. Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.

IV. Nese nje ose disa vende te anetareve te keshillit te mbikqyrjes mbeten bosh per shkak vdekjeje, shkarkimi ose doreheqjeje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se tre muaj.

Anetari i keshillit mbikqyres, i emeruar ne zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit.

V. Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se tre keshilla mbikeqyres te shoqerive anonime qe e kane seline ne territorin e Republikes se Shqiperise.

VI. Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 vjeç nuk mund te jene me shume se nje e treta e numrit te pergjithshem ne mbyllje te ushtrimit te çdo viti financiar. Nese kjo perqindje tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

Neni 7

Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet ngarkohen te mbledhin keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata emerohen per te gjithe kohen e mandatit te tyre ne keshillin mbikqyres dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te emeroje nje sekretar jashte anetareve te tij.

Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit mbledhjet e e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

Neni 8

Vendimet e keshillit

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendes kryetarit.



Kryetari duhet te therrase keshillin mbikqyres, brenda pesembedhjete diteve, kur drejtori ose nje e treta e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim.

Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere autoret e saj mund te therrasin keshillin, duke i permendur rendin e dites.

Ne parim thirrja duhet te behet tre dite perpara, me leter, telegram, teleks ose telefaks. Por ajo mund te behet me goje dhe pa afat ne qofte se anetaret e keshillit mbikqyres e pranojne ate.

Çdo thirrje duhet te tregojë çështjet kryesore te rendit te dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres behet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

II. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem, ne qofte se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te keshillit.

Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te barabarta, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

III. Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjet e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje.

IV. Vendimet e keshillit mbikqyres evidencohen me procesverbale te hartuara ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari i seances dhe nga nje anetar i keshillit ose, ne mungese te kryetarit, nga jo me pak se dy anetare te keshillit.

Kopjet e ketyre procesverbaleve vertetohen nga kryetari keshillit mbikqyres, zevendes kryetari dhe nga drejtori i pergjithshem.

Neni 9

Kompetencat e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtori i pergjithshem i saj dhe i jep ketij te fundit autorizimin



parap... er kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtori i pergj... em pa autorizimin paraprak te keshillit mbikqyres.

Keshilli mbikqyres emerohet drejtorin e pergjithshem.

Ai autorizon marreveshjet e parashikuara ne nenin 13 te ketij statuti.

Ai autorizon drejtorin e pergjithshem te kryeje veprimet dhe te marre masat e parashikuara ne nenin 12 te ketij statuti.

Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i çmon te pershtatshme, dhe kerkon te njihet me dokumentet qe ai i gjykon te nevojshme per permbushjen e detyres se tij.

Drejtori i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.

Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar, drejtori duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli te tyre nga ky i fundit.

Keshilli mbikqyres miraton llogarite vjetore dhe raportin vjetor te paraqitur nga drejtori i pergjithshem.

Keshilli mbikqyres mund t'i ngarkoje njerit ose disa anetareve te tij çdo mandat te posaçem per nje ose disa objekte te caktuara.

Neni 10

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres.

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.348 date 3.7.1995 "Per keshillat mbikqyres te shoqerive shteterore".

Neni 11

Drejtori i pergjithshem

I. Drejtori i pergjithshem emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 3/4 e anetareve te ketij keshilli. Ai mund te zgjidhet qofte ndermjet personave te shoqerise, qofte edhe jashte te punesuarve te saj.



ose nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet drejtor, mandati i tij ne merr fund me hyrjen e tij ne funksion.

Nje person nuk mund te emerohet drejtor ne me shume se nje shoqeri.

Drejtori mund te shkarkohet nga keshilli mbikqyres vetem per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur nje kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk eshte shkak per zgjidhjen e kesaj kontrate.

II. Drejtori emerohet per nje periudhe kohe prej 4 vjetesh. Ne rastet te pushimeve dhe te mungesave te tjera te zgjatura, keshilli mbikqyres ben menjehere zevendesimin e tij.

Drejtori eshte i riemerueshem. Ai nuk mund te jete ne moshen mbi 65 vjeç.

Drejtori qe mbush 65, quhet zyrtarisht i shkarkuar dhe zevendesohet menjehere.

Menyra dhe masa e shperblimit te drejtorit caktohen nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tij.

Neni 12

Kompetencat e drejtorit

I. Drejtori ka kompetenca te plota ndaj te treteve per te vepruar ne emer te shoqerise ne çfaredo rrethane, me perjashtim te kompetencave qe i jane caktuar shpprehimisht keshillit mbikqyres nga ligji dhe nga ky statut.

Ne marrredhenie me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorit kapercente objektin e shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt, duke pasur parasysh faktin se vete shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Kufizimet e kompetencave te drejtorit te caktuara ne statut duhet te respektohen nga te tretet.



- gjithate, ne cilesine e masave te rregullimeve te brendshme te shoqerise, te cilat u kundervihet te tretteve, veprimet dhe masat e meposhtme kryhen ne autorizim te keshillit mbikqyres:
- percaktimi dhe ndryshimi i programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate te shoqerise;
 - kryerja e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e buxhetit fillestar te shoqerise;
 - hapja e veprimtarive ose e njesive te reja, shkrija ose bashkimi dhe mbyllja teresisht a pjeserisht e veprimtarive dhe njesive te shoqerise;
 - blerja, shkembimi dhe shitja e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise;
 - themelimi i shoqerive ose pjesemarrja ne shoqeri te tjera te krijuara, ose per t'u krijuar;
 - marrja e huave afatmesem, afatgjate, dhania e dorezaneve ose e garancive te tjera kur keto te fundit tejkalojne veprimtarite e zakonshme te shoqerise;
 - negocimi, perfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 3 vjet ose per nje shume detyrimesh vjetore mbi dy milione leke;
 - percaktimi i kriterëve per diskutimin, perfundimin dhe ndryshimin e kontrates se punesimit me punonjesit;
 - ne pergjithesi marrja e vendimeve dhe masave qe e kapercejne veprimtarine e zakonshme te shoqerise dhe qe jane te tilla qe mund te sjellin ndryshime ne objektin e shoqerise.

II. Drejtori i pergjithshem mund te delegoje nje pjese te kompetencave te tij, qe ai i gjykon te dobishme tek nje ose disa persona te tjere qe kryejne funksione teknike ne drejtimin e shoqerise.

III. Drejtori i pergjithshem perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet.

Emerimi dhe pushimi i tij duhet te publikohet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.



Aktet, me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve, duhet te mbajne nenshkrimin e drejtorit te pergjithshem, ose te personit te autorizuar rregullisht nga drejtori per keto akte.

Neni 13

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorit ose nje anetari te keshillit mbikqyres

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe drejtorit te pergjithshem ose nje anetari te keshillit mbikqyres, qofte e drejtperdrejte ose jo e drejtperdrejte, duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Kjo dispozite eshte e zbatueshme edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te shoqerise tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja.

Dispozitat e mesiperme nuk jane te zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimet rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushtet normale.

Drejtori ose anetari i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres sapo merr dijeni per nje marreveshje, per te cilen zbatohen kerkesat e ketij neni te statutit. Anetari i keshillit mbikqyres i interesuar nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

Neni 14

Eksperti kontabel i autorizuar

Kontroli ushtrohet nga nje ose dy eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga keshilli mbikqyres dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

Neni 15

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar gjer me 31 dhjetor.



8

Neni 16

Inventari-llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

Ne mbyllje te ushtrimit, drejtori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar.

Drejtori pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara per te ardhmen, ngjarjet me te rendesishme qe kane ndodhur gjate periudhes nga data e mbylljes te ushtrimit financiar deri ne daten e hartimit te ketij raporti, si dhe veprimtarite e shoqerise ne fushen kerkimore-shkencore.

Neni 17

Rezultati i ushtrimit dhe caktimi i fitimeve

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provizionet.


Nga fitimet e ushtrimit te pakesuara, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, hiqen te pakten 5 per qind per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin nje te dhjeten e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye cfardo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen nje te dhjeten e kapitalit.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, shoqeria do te heqe jo me shume se 85 per qind per krijimin e rezerves per zhvillim.

Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjeve per krijimin e rezervave te permendura me siper perfaqeson dividentin, i cili derdhet ne buxhetin e shtetit.

Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk behet asnje heqje dhe asnje derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet



e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e ushtrimeve te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Neni 18

Emerimi i anetareve te pare te Keshillit Mbikqyres.

Si anetare te pare te Keshillit Mbikqyres emerohen :

1. Merita Kafexhiu banues ne Elbasan
2. Pjereta Sata banues ne Tirane
3. Gezim Dauti banues ne Tirane

Neni 19

Emerimi dhe shkarkimi i drejtorit te pare

Ne nje afat prej 6 muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise drejtori i ish ndermarrjes shtetere do te jete i emeruar zyrtarisht Drejtor i pergjithshem i Shoqerise dhe do te jete pergjegjes per ruajtjen e pasurise te saj.

Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet vetem nga Ministri i Financave dhe per shkaqe te perligjura mbi bazen e propozimeve te Drejtorise te Shoqerive Publike ose te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise.

Hartuar ne Tirane me 3 gusht 1995 ne 6 kopje te njejta.

DREJTORI I DREJTORISE TE SHOQERIVE PUBLIKE



BERZH PIRANIAN

R A P O R T
I
E K S P E R T E V E K O N T A B E L

Une i quajturi Edvard Jila, i ngarkuar me detyren e ekspertit kontabel per verifikimin dhe vertetimin e bilancit te shoqerise Prodh. mat. Ref. qe krijohet nga transformimi i ndermarrjes prodh. mat. Ref., paraqes raportin si me poshte:

Nga data 12.7.1995, deri me daten 2.8.1995, kam ndjekur punen e komisionit te ndermarrjes lidhur me percaktimin e kapitalit themeltar te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi i saj.

- Nga verifikimet e kryera konstatoj se, komisioni ka respektuar rregullar e parashikuara ne vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.311, date 12.06.1995 "Per kriteret e percaktimit te kapitalit themeltar te shoqerive shteterore qe do te krijohen shnderimi i ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" si dhe ato te percaktuar ne Udhezimin e Ministrise se Financave Nr. 9 date 28.6.95.

Rregjistrimet kontabel per veprimet lidhur me percaktimin e kapitalit jane kryer ne menyre te plote dhe te rregullt.

Bilanci i celjes te shoqerise qe do te krijohet si pasoje e transformimit te ndermarrjes, jep ne pamje besnike te pasurise dhe te gjendjes financiare te ndermarrjes.

Kapitali i percaktuar prej \approx leke, i pergjigjet vleres se aktiviteti neto te shoqerise. $= 420.000.000 =$

Vendi Edhasan, data 2.8.1995

Emri Mbiemri
Nenshkrimi

Edvard Jila

Proces - verbal

i mbledhjes rreth me dat. 07.08.1995

Cot, me dat 07.08.1995, kurre per vepurme
me shlyete Eduert Kilm, i berr i kyrtetent,
dat 1949, londus e Bonues me Ellbenem, disped
kontrapol i caktuar per vleresimem e kapacitetit
shumetor te shprehur ne/ Pradherme Repraktore

Si u pyet kurr: Jam ekonomist financiare
dhe punoj me keshtem e breksh
Ellbenem. Rej prax me kintem e
amikatuar rrepe mundvotri i
financiare. Dhe i plotesoj rrepe
rrepe rrekat e porre shikimore me
nemet 168 e 169 te legjit 7633 dt
19.VI 1992.

Edvart
Eduard Jela
EJ.

Shyptore
Jegje

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE
Nr. 7822 Prot.

7.8.95

Tirane, me 31.07.1995

KERKESE
PER
MIRATIMIN E EKSPERTEVE KONTABEL PER VLERESIMIN E
KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE ANONIME

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Ne baze te Ligjit Nr.7926 ,date 20.4.1995"Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" kemi vendosur transformimin e Prodhimeve Refraktare Elbasan me shoqeri anonime.

Ne baze te ligjit Nr.7639, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", kerkojme miratimin nga ana e kesaj gjykata te eksperteve kontabel si me poshte:

1. Eduart Kila

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE



BERZH PIRANIAN

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE
Nr. 111 Prot.

Tirane, me 7.8 1995

URDHER
Nr.16 Date 05.07.1995

Ne baze te nenit 4 te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare",

URDHEROJ

1. Transformimin e Ndermarrjes "Prodhime Refraktare" me "shoqeri anonime".

2. Anetare te Keshillit Mbikqyres caktohen

1. Merita Kafexhiu

2. Pjereta Sata

Anetaret e tjere te Keshillit Mbikqyres emerohen nga Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetikes.


3. Eksperte per vleresimin e kapitalit themeltar te tyre caktohet Eduard Kila.

Veprimet per vleresimin e kapitalit dhe te rregjistrimit te shoqerise te mbarojne brenda dates 31.08.1995.

Ngarkohet Drejtoria e Shoqerive Publike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri.

Akti i themelimit, statuti i shoqerise, kerkesa per miratimin e eksperteve kontabel, kerkesa per rregjistrimin e shoqerise ne rregjistrin tregtar dhe aktet e tjera te nevojshme do te nenshkruhen nga Drejtori i Drejtorise se Shoqerive Publike.

MINISTRI
Dyber VRIONI



FIRMA.....
Dt e krijimit.....
Kerkese.....

10/8/1995

11803/1

DEPOZITIM

Prodhues
Reproditore
Elbasan

1. URDHER DEPOZITIMI:
dt.

2. KERKESE:
Kerkuesi:
dt.
Nr. Rep Nr. Kol

- a) putim kapitali
- b) fuqell
- c)

3. VENDIM ASAMBLEJE:
dt.
Nr. Rep Nr. Kol

Ortaku i vetem
Ortakët :

4. KONTRATE SHITJE KUOTASH:
dt.
Nr. Rep Nr. Kol

Shitesi: %
Bleresi: %

5. VENDIMI I GJYGTARIT TE VETEM :
dt.
Nr.
Gj Dedi

6. Nr. i depozitimit ne liber 1903

Tirane , me 23/2/1996

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE
NR 700 PROT

11803/1

Tirane, me.....1996

**KERKESE
PER
DEPOZITIMIN E AKTEVE TE SHOQERISE TREGTARE PER
NDRYSHIME TE PERMBAJTJES TE AKTEVE TE RREGJISTRIMIT.**

Perpara

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Shoqeria anonime Prodhimë Refaktare ELBASAN është regjistruar pranë gjykates se Rrethit Tirane, me vendimin nr. 11803, date 10.8.1995.

Ministri i Financave me cilesine e aksionerit te vetem te saj ka nxjerre urdherin (ose vendimin e aksionerit te vetem) per te bere nje shtim ne kapitalin themeltar te kesaj shoqerie.

Ne baze te nenit 33 te ligjit 7667, date 28.01.1993 " Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te" kerkojme nga ana e gjykates tuaj te behen depozitimet perkatese pranë zyres rregjistrimit tregtar lidhur me shtimin e kapitalit te shoqerise. Shoqeria te ciles i behet shtimi i kapitalit nuk ka kaluar akoma ne procesin e transferimit te aksioneve.

Bashkangjitur kesaj kerkese jane:

1.Urdheri i Ministrit te Financave me cilesine e aksionerit te vetem, ne baze te paragrafit te dyte te nenit 4 te Ligjit 7926, date 20.04.1995 " per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare".

2.Akti i vleresimit te truallit, qe behet shtese kapitali, ne baze te vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 312, date 30.06.1994 " Per cmimin e truallit qe shitet dhe per qerane e truallit qe u jepet ne perdorim per ndertim personave fizike dhe juridike".

*Ec' depozitimi
nikesa
dt. 23-2-96.
gjyftare
M. Dede
M. Dede*

**DREJTORI
BERZH PIRANIAN**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
KABINETI

URDHER

I

AKSIONISTIT TE VETEM TE SHOQERISE ANONIME
PRODHIME REFRAKTARE

ELBASAN

Nr.16/1 date 29/1/96

Me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise anonime PRODHIME REFRAKATER ELBASAN, cilesi kete qe e kam ne baze te paragrafit te dyte te nenit 3 te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995

"Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" dhe ne baze te nenit 128 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare";


Urdheroj:

1. Ne aktet e themelimit te shoqerise anonime PRODHIME REFRAKTARE ELBASAN te behen ndryshimet e meposhtme:

Ne kapitalin themeltar te shoqerise te shtohet vlere e truallit prej 30624000 leke dhe numri i aksioneve 30624, si dhe me nje siperfaqe prej 191400 m². Keto ndryshime te behen ne piken 4 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 3 te Statutit te Shoqerise.

2. Vleresimi i truallit, qe do te behet shtese ne kapital sipas pikes se mesiperme, te behet sipas dispozitave ne fuqi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerive Publike te beje veprimet perkatese per shtimin e kapitalit ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te".



11803/2

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Shoqerive publike
Nr. 2375 Prot.

Tirane, me 6. 6. 1996

K E R K E S E
PER
DEPOZITIMIN E AKTEVE TE SHOQERISE ANONIME
REFRAKTARE ELBASAN NE RREGJISTRIN TREGTAR.

Shoqeria anonime Refraktare Elbasan eshte themeluar si e tille me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.11803 date 10.08.1995.


Me Urdherin Nr.2/17, date 26.10.1995, me cilesine e aksionerit te vetem kam urdheruar shitjen e aksioneve 100%.

Shitja e aksioneve eshte realizuar nga Agjensia Kombetare e Privatizimit dhe aksionet u kane kaluar aksionereve te rinj sipas dokumentacionit bashkengjitur kesaj kerkese.

Si ish aksioner i vetem i kesaj shoqerie po depozitoj ne tregjistrin tregtar per shoqerine e mesiperm keto akte :

1. Urdherin per transferimin e aksioneve nga shteti tek personat e trete.
2. Lista e aksionereve qe u eshte transferuar aksioni ne baze te nenit 198 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Bea
deputet
Ministria e Financave
akt. 17. 7. 96
Gjykatore
Deoli
separat



12edri

REPubLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Shoqerive Publike
Nr. 2375 Prot.

6

Tirane, me 8. 6. 1996


URDHER
Nr.2/17 date 26.10.1995

PER
SHITJEN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME
REFRAKTARE ELBASAN

Ne baze te nenit 4, paragrafi i dyte i ligjit Nr.7926, date 20.04.1995, me cilesine e aksionerit te vetem,

Urdheroj:

1. Te privatizohet nepermjet shitjes me aksione shoqeria anonime Refraktare Elbasan.
2. Shitja e aksioneve te behet 100%
3. Shitja e aksioneve ne perputhje me piken 2 te ketij Urdheri te perfundoje brenda afateve ligjore ne fuqi.



REPubLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT
Nr. 979 Prot.

Tiranë, 15.3 .1996

Lenda: Dergohet akt transferimi aksionesh

MINISTRISË SE FINANCAVE
(Drejtorese se Shoqerive Publike)


TIRANE

Bashkengjitur ju dergojme aktin e transferimit te aksioneve per Shoqerine Anonime

Refraktare, EL BASAN

DREJTORI I PERGJITHSHEM

NIKO GLIOZHENI



REPUBLICA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT

AUTORIZIM TRANSFERIM AKSIONESH

MINISTRISE FINANCEVE

TIRANE

Ne baze te nenit 22 te Ligjit Nr. 7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimin", ne baze te urdherit te Ministrit te Financave Nr. 2, date 26.10.95 per shitjen e aksioneve te shoqerise anonime REFRAKTARE, ELBASAN dhe ne baze te nenit 198 te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare", është realizuar shitja e aksioneve te kesaj shoqerie si me poshte:

1. Aksionet e shoqerise te zoteruara 100% nga Ministri i Financave, ne baze te paragrafit te dyte te nenit 4 te Ligjit Nr. 7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve Shteterore ne Shoqeri Tregetare" jane shpallur per publikim per shitje me date 4.11.95.
2. Ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi shitja ka perfunduar me date 20.12.95
3. Aksioneret dhe rezultatet e ankandit jane sipas listes bashkangjitur.

DREJTORI I PERGJITHSHEM

NIKO GLIOZHENI

Protokoll i llogaritjeve për Ankandet
Qendra Informatizimit Financiar

2/1/96


Emri i Shoqërisë Aksionere:

REFRAKTARE ELBASAN

Kapitali themeltar.....	100%	450624000 Lekë
Pjesa e Kapitalit për Truallin.....	6.80%	30624000 Lekë
Pjesa e Kapitalit që mban Shteti.....	0.0%	
Pjesa e kapitalit që shitet.....	100.00%	450624000 Lekë
Vlera Nominale e një Aksioni.....		1000 Lekë
Vlera totale e Lekëve e mbledhur nga Ankandi.....		78628161 Lekë
Vlera e Aksionit e vendosur nga Ankandi.....		174.52021024 Lekë
Numri i Aksioneve të shitura.....	99.98%	450519
Numri i Aksionerëve.....		371
Numri i Aksioneve të mbetura.....	0.02%	105
Numri i Aksioneve për Pronarët e Truallit.....	0.00%	0
Pjesa e Kapitalit që mban Shteti.....		0
Përqindja e Aksioneve të shitura		99.9766989774 %
(Raporti i Numrit të Aksioneve të shitura me numrin e Aksioneve të ofruara për shitje, i shprehur në përqindje)		
Koeficienti i shitjes.....		0.17452021024
(Raporti i vlerës së Aksionit e vendosur nga Ankandi me vlerën nominale të Aksionit.)		

Drejtori

Lulzim BASHA



REPUBLIKA E SHQIPERISE

REFRAKTARE sh. a. - ELBASAN

Nr..... Prot.

Tirane, me1996

11803/2

KERKESE

**PER DEPOZITIM NDRYSHIMESH
NE AKTET E THEMELIMIT TE SHOQERISE**

*Be depozitimi i
akt. 24-7-96
p. 11. 11. 1992
Gjykatës*

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Ne baze te nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28. 01. 1993 " Per rregjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te" dhe te ligjit Nr. 7638 date 19. 11. 1992 " Per shoqerite tregetare ", kerkojme nga ana e gjykates tuaj te behen depozitimet e ndryshimeve ne aktet e themelimit te shoqerise anonime " **NDERMARRJA PRODHIMEVE REFRAKTARE** ", Elbasan regjistruar prane gjykates se rrethit Tirane, me Vendimin Nr. 11803 Akt. Date 10. 08. 1995.

Kjo kerkese mbeshtetet ne vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 608, date 30. 10. 1995 "Per transferimin e aksioneve te shtetit personave pjesemarres ne ankandet per privatizimin e shoqerive tregetare shteterore" dhe rezultateve te ankandit te shpallura nga Agjencia e Privatizimit Kombetar, Tirane, derguar me shkresen Nr. 919, date 11. 03. 1996, bashkangjitur kesaj kerkese.

Kryetari i Asamblese se Aksionereve

Agron Shaplo



Elbasan, me1996

V E N D I M N R . 1

PER NDRYSHIMIN E AKTEVE TE THEMELIMIT TE SHOQERISE

Sot me date 05. 04. 1996 ne sallin e Institutit te Kombinatit Siderurgjik, ne mbledhjen e Asamblese se Aksionereve te Shoqerise anonime "REFRAKTARE sh.a.", Elbasan, ne prani te 78,5% te aksioneve, Asambleja e Jashtezakonshme

V E N D O S I


Ndryshimet e akteve themelore te shoqerise dhe konkretisht:

1. Ndryshime ne aktin e themelimit te Shoqerise.
2. Ndryshime ne statutin e shoqerise.

Te dy keta dokumenta jane pergatitur me vete duke pasqyruar ndryshimet nen per nen.


SEKRETARI

Altin Kruja



**KRYETARI I ASAMBLESE SE
AKSIONEREVE**

Agron Shaplo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
REFRAKTARE sh.a - ELBASAN

Elbasan, me1996

Nr.....Prot.

V E N D I M N R . 2
Z G J E D H J A E K E S H I L L I T M B I K Q Y R E S

Sot me date 05. 04. 1996 ne sallën e Institutit të Kombinatit Siderurgjik, Elbasan, ne mbledhjen e Asamblese se Aksionereve te Shoqerise Anonime " **REFRAKTARE sh.a.** ", Elbasan, ne prani te 78,5 % te pjesemarrjes se aksioneve, Asambleja e Jashtezakonshme

V E N D O S I

1. Keshilli Mbikqyres i Shoqerise Anonime " **REFRAKTARE sh.a.** " do te perbehet nga tre anetare.

2. Keta jane:

Z. Agron Shaplo

Z. Edmond Karafili

Z. Grigor Dhaskali

3. Anetaret e Keshillit Mbikqyres te mesiperm u propozuan pasi perfaqesojne deshiren dhe vullnetin e grupeve te medha te aksionereve te shoqerise. Per keta u votua ne menyre unanime nga perfaqesuesit e aksioneve (ne kapital).
Per sa me sipër votimet u vleresuan te rregullta.

SEKRETARI

Altin Kruja



KRYETARI I ASAMBLESE SE
AKSIONEREVE

Agron Shaplo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
REFRAKTARE sh.a - ELBASAN

Nr.....Prot.

Elbasan, me1996

V E N D I M N R . 2

ZGJEDHJA E KESHILLIT MBIKQYRES

Sot me date 05. 04. 1996 ne sallën e Institutit të Kombinatit Siderurgjik, Elbasan, ne mbledhjen e Asamblese se Aksionereve te Shoqerise Anonime " **REFRAKTARE sh.a.**", Elbasan, ne prani te 78,5 % te pjesemarrjes se aksioneve, Asambleja e Jashtezakonshme

V E N D O S I

1. Keshilli Mbikqyres i Shoqerise Anonime " **REFRAKTARE sh.a.**" do te perbehet nga tre anetare.
2. Keta jane:
 - Z. Agron Shaplo**
 - Z. Edmond Karafili**
 - Z. Grigor Dhaskali**
3. Anetaret e Keshillit Mbikqyres te mesiperm u propozuan pasi perfaqesojne deshiren dhe vullnetin e grupeve te medha te aksionereve te shoqerise. Per keta u votua ne menyre unanime nga perfaqesuesit e aksioneve (ne kapital).
Per sa me siper votimet u vleresuan te rregullta.


SEKRETARI

Altin Kruja



KRYETARI I ASAMBLESE SE
AKSIONEREVE

Agron Shaplo



PROCES - VERBAL NR. 1

I mbajtur sot me date 05. 04. 1996 ne sallën e Institutit të Kombinatit Siderurgjik, Elbasan, për mbledhjen e jashtëzakonshme të aksionereve të Shoqërisë anonime Ndermarrja e Prodhimeve Refraktare, Elbasan, mbështetur në njoftim me telegram rekomandë 15 ditë përpara mbledhjes sipas shkresës Nr. 427/1, datë 25. 3. 1996, me këto rend dite:

1. Zgjedhja e organeve drejtuese të shoqërisë
2. Miratimi i ndryshimeve në Statutin e shoqërisë
3. Zgjedhja e Keshillit Mbikqyres (KM)
4. Miratimi i ndryshimeve në aktet e themelimit të shoqërisë

Mbledhja u hap në orën 10.00 e u drejtua nga Keshilli Mbikqyres egzistues i shoqërisë tregëtare Ndermarrja Prodhimeve Refraktare. Kryetari i KM z. Gezim Dauti propozon që Kryetar i Asamblesë së Aksionereve të jetë aksioneri kryesor z. Agron Shaplllo dhe sekretar i saj të jetë z. Altin Kruja. Gjithashtu ai njofton për prezencën në mbledhje të noteres Pranvera Karafili. Propozimi i bere nga z. Gezim Dauti u aprovua unanimisht nga aksioneret pjesëmarrës në mbledhje.

Behet verifikimi i pjesëmarrjes së aksionereve në mbledhje dhe rezultojnë prezent 78, 5% e aksioneve. Aksioneri Nikolla Nosi përfaqësohet me prokurë të posacme nga aksioneri Agron Shaplllo, prokurë e cila depozitohet pranë sekretarisë.

Sipas shifrës së mesiperme të pjesëmarrjes mbledhja legjitimohet e vlefshme, sipas ligjit 7638 "Për shoqëritë tregëtare". Në vijim të rendit të ditës kalohet në miratimin e ndryshimeve të Statutit të Shoqërisë nën për nën. Përpara kesaj u lexua rregullorja e votimit.

Z. Gezim Dauti propozon që neni 1 të shfuqizohet dhe në vend të tij të formulohet neni 1 si më poshtë si dhe neni 1/1 për formën e shoqërisë.

Neni 1

Emertimi dhe selia (vendndodhja) e shoqerise

Emertimi i plote i shoqerise eshte “ **REFRAKTARE Sh.A.**” ELBASAN. Selia (vendndodhja) e shoqerise eshte ne Elbasan. Shoqeria mund te transferoje seline e saj apo te cele filiale ne cdo vend tjeter si brenda ashtu dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.

Ne rastin e transferimit te shoqerise me vendim te Keshillit Mbikqyres, ky i fundit eshte i autorizuar te beje ndryshimet e nevojshme ne statutin e shoqerise.

Neni 1/1

Forma e shoqerise

Shoqeria do te jete shoqeri anonime pa oferte publike, per sa kohe qe Asambleja e Aksionereve nuk do te marre nje vendim per shndrimin e saj ne shoqeri anonime me oferte publike, ose ne nje forme tjeter te shoqerive tregtare te parashikuar ne Ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”.

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit 7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, si dhe nga ky statut e legjislacioni ne fuqi.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 2 te plotesohet me :

Shoqeria do te kete si objekte te veprimtarise se saj:

Veprimtari prodhuese per materiale refraktare e qeramike, ndertimore, inerte, mineralogjike, konstruksione metalike, paisje e makineri duke perdorur burimet e brendeshme dhe ato jashte vendit.

Veprimtari ndertimi duke perfshire ato civile e industriale.
Veprimtari transportuese brenda dhe jashte vendit te mallrave per vete dhe per te trete.
Veprimtari exportuese dhe importuese te lendeve te para, produkteve te gatshme e gjysem te gatshme, mineraleve, naftes si dhe produktetve te tyre, paisje e makineri si dhe linja industriale.
Veprimtari tregtare perfshire tregetin e mallrave industriale dhe ndertimore si dhe paisje e makineri e linja industriale.
Veprimtari studimore dhe projektuese ne fusha te ndryshme te ekonomise, ndertimore, mekanike dhe elektrike, etj.
Veprimtari investuese dhe financuese ku shoqeria do te perdore per kete qellim fonde te saj si dhe fonde te institucioneve financiare dhe bankare vendase e te huaja, private e publike, marrje dhe dhenje me qera objekte dhe mjete, paisje dhe zyra, ambiente te ndryshme, pasuri te lujtshme e te palujtshme.
Brenda kuadrit te dispozitave ligjore shoqeria ka te drejte te marre te gjitha masat dhe te kryeje cdo biznes brenda e jashte vendit te pershtatshem per arritjen e qellimit te shoqerise, kjo e cila perfshin krijimin e filialeve te reja brenda e jashte vendit, blerjen dhe krijimin e subjekteve te tjera ekonomike dhe interesat e saj per pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrrese ne mbledhje.
Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 2 te shtohet neni 2/1 me kete permbajtje:

Neni 2/1

Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar, duke filluar llogaritja e ketij afati qe nga data e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar, me perjashtim te rasteve kur shoqeria pushon veprimtarine e saj sipas Mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve, ose sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrrese ne mbledhje.

Per nenin 3 z. Gezim Dauti propozon te ndryshoje si me poshte:

Neni 3

Kapitali themeltar i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 450.624.000 leke.

Ai eshte i ndare ne aksione me te zakonshme, me vlere nominale 1000 leke secili te numertuara nga 1 deri tek 450.519.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 3 te shtohet neni 3/1 me kete permbajtje:

Neni 3/1

Ndryshimet e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar mund te zmadhohet me te gjitha menytrat dhe mopdalitetet e kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim.

Ne baze te nenit 152 Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", i vetmi organ kompetent per te vendosur zmadhimin e kapitalit eshte Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme e cila merr vendim ne baze te raportit te drejtorise qe permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Ne perputhje me ligjin aksioneret kane perpjestimisht me shumen e aksioneve te tyre, nje te drejte paresore me nenshkrimin e aksioneve te para te emetuara per te kryer nje zmadhim te kapitalit. Ata mund te heqin dore nga kjo e drejte vetem individualisht.

Me rezerven, kur eshte rasti, te te drejtat e kreditoreve, Asambleja e Pergjitheshme e Jashtezakonshme mund te autorizojë ose te vendose zvogelimin e kapitalit per cfaredo arsye ose me cfaredo menyre qofte, por ne

asnje rast zvogelimi i kapitalit nuk mund te cenoje barazimin ndermjet aksionereve.

Zvogelimi i kapitalit, per cfaredo shkaku qofte, ne nje shume me te vogel se minimumi ligjor mund te vendoset vetem me kushtin pezullues te nje zmadhimi te kapitalit, i destinuar te coje kete te fundit te pakten ne minimumin ligjor, pervec rastit kur shoqeria transformohet ne nje shoqeri te nje forme tjeter qe nuk kerkon nje kapital me te larte se ai i zvogeluar.

Ne rastin e mosrespektimit te kesaj dispozite, cdo i interesuar mund te kerkoje nga gjykata kompetente prishjen e shoqerise. Prishja e shoqerise nuk mund te shpallet nese ne ditën kur gjykata shqyrton ceshtjen, gjendja eshte rregulluar.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrrese ne mbledhje.

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 4 te formulohet si me poshte:

Neni 4

Aksioneret e shoqerise

Aksioneret e shoqerise jane persona fizike dhe juridike qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksione te shoqerise me te gjitha menytrat e parashikuara nga ligji.

Pronesia mbi aksionet e shoqerise permбан aderimin me te drejta te plota ne statutin e shoqerise nepermjet perfaqesimit ne Asamblene e Pergjithshme te Aksionereve.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrrese ne mbledhje.

Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 4 te shtohet nenet 4/1, 4/2, 4/3, 4/4 me kete permbajtje:

Neni 4/1

Te drejtat dhe detyrat e aksionereve

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndashme te shoqerise ne perputhje me aksionin e tij sipas vleres nominale te zoteruar prej tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Cdo aksioner ka te drejte te marre, kur eshte rasti, nje pjese nga teprica e likujdimet te shoqerise ne te njejtin perpjestim sipas paragrafit te pare te ketij neni.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblene e pergjithshme te aksionereve ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe nga ky statut.

Aksioneret jane vete pergjegjes per detyrimet dhe humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne: kerkimi i fondeve te kesaj mase eshte i ndaluar.

Te drejtat dhe detyrimet e permendura me siper ndjekin aksionin ne cfaredo forme qe ai tjetersohet tek te tretet.

Neni 4/2

Format e aksioneve dhe libri i aksioneve

Aksionet jane te formes emerore.

Pronesia e aksioneve rezulton nga rregjistrimi i tyre ne emer te titullarit ose titullareve ne librin e aksioneve te mbajtura nga ana e shoqerise ose nga ndermjetesat financiare.

Libri i aksioneve do te permbaje ne cdo kohe informatat qe vijne, numrin dhe kategorine e aksioneve, daten e marrjes nga aksioneri, emrin mbiemrin dhe adresen e cdo aksioneri si dhe vlera nominale per cdo aksion te zoteruar.

Secili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga libri i aksionereve i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Secili aksioner ka te drejte te verifikojte nese emri i tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar t`i tregojte aksionerit, me kerkesen e ketij te fundit, hyrjen perkatese ne liber.

Neni 4/3

Shitja dhe transferimi i aksioneve

Aksionet jane lirisht te transferueshme, pa miratimin e shoqerise. Ne rastin e zmadhimit te kapitalit, aksionet jane lirisht te tregtueshme pas realizimit te ketij zmadhimi.

Pas prishjes (likujdimit) te shoqerise, aksionet mbeten lirisht te tregtueshme deri ne mbylljen e likujdimit sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Ndryshimi i pronesise se aksioneve si rrjedhoje e nje shitje apo transferimi, kryhen nepermjet nje kalimi nga llogaria e dhenesit tek llogaria e marresit ne baze te nje urdher xhirimi.

Shoqeria eshte e detyruar te kryeje kete rregjistrim dhe te kete xhirim brenda gjashte diteve nga marrja e urdher xhirimit.

Urdher xhirimi i pergatitur ne nje formular te dhene nga shoqeria ose te miratuar nga shoqeria nenshkruhet nga dhenesi i aksionit ose perfaqesuesi i tij. Nese aksionet nuk jane shlyer teresisht, urdher xhirimi nenshkruhet edhe nga marresi.

Shoqeria do te kerkoje qe nenshkrimet e paleve te vertetohen nga noteri, pervec rasteve kur ky vertetim eshte perjashtuar nga ligji.

Transferimi i aksioneve falas si rrjedhoje e trashegimise kryhet gjithashtu me ane te kalimit ne llogari ne baze te nje dokumenti ligjor qe verteton transferimin.

Shpenzimet per transferimin e aksioneve jane ne ngarkim te marresit, pervec rastit te nje mareveshjeje te kundert midis dhenesit dhe marresit.

Aksionet e pashlyera per derdhjet e kerkuara nuk mund te pranohen per transferim.

Neni 4/4

Shlyerja e aksioneve

Aksionet e nenshkruara ne **para** lidhur me zmadhimin e kapitalit te shoqerise duhet te shqyrtohen sipas modaliteteve te caktuara nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme. Shlyerja e ketyre aksioneve nuk mund te jete me e ulet se sa nje e katerta e vleres nominale dhe nese eshte rasti, e teresise se primeve te emisionit.

Shlyerja e vleres nominale te mbetur duhet te kryhet ne nje ose disa keste me kerkese se Drejtorise se Pergjithshme te shoqerise, ne nje afat prej pese vjetesh nga data kur ky zmadhim i kapitalit eshte bere perfundimtar.

Kerkesat e fondeve per shlyerjen e aksioneve u behen te njohura nenshkruesve, te pakten pesembedhjete dite perpara dates se caktuar per cdo derdhje, me leter rekomande me kthim pergjigje per marrjen ne dorezim te adresuar tek cdo titullar i aksioneve.

Cdo vonese ne derdhjen e shumave te duhura nga shumat e pashlyera te aksioneve sjell pagimin e interesave me perqindjet ligjore dhe kjo pavaresisht nga veprimi personal qe shoqeria mund te ushtroje ndaj aksionerit qe nuk ka

shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi per kete problem.

Keto nene u votuan dhe u miratuan me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 5 te formulohet si me poshte:

Neni 5

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e Pergjithshme
2. Keshilli Mbikqyres
3. Drejtoria

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 5 te shtohet nenet 5/1, 5/2, 5/3, 5/4, 5/5, 5/6, me kete permbajtje:

Neni 5/1

Asambleja e pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme merr te gjitha vendimet te cilat jane te percaktuara nga ligji ose nga ky statut, me perjashtim te rasteve kur vendimet nuk perfshihen ne Asamblene e Jashtezakonshme.

Kjo asamble do te mbahet ne zyren e rregjistruar te shoqerise.

Keshilli Mbikqyres ose bordi drejtues(ose drejtori i pergjithshem) do te therrasin asamblene.

Asambleja do te mbahet ne 6 muajt e pare te cdo viti fiskal. Asambleja e jashtezakonshme do te thirret nese kjo do te konsiderohet e sukseshme ne interes te shoqerise dhe nese jane percaktuar kushtet ligjore per nje mbledhje te tille.

Mbledhja e asamblese kryhet me ane te nje lajmerimi ne publikimin e autorizuar, qe permban informacionin ligjor, ne menyre te tille qe te jete nje periudhe kohe prej te pakten 4 javesh ndermjet dites se publikimit dhe dites se mundesise se fundit per depozitim.

Neni 5/2

Cdo vlere nominale prej 50.000 lekesh ose 50 aksionesh perfaqeson vetem nje vote.

E drejta e votes mund te ushtrohet me ane te nje autorizimi per te cilin kerkohet nje forme e shkruar dhe e noteruar.

Kushtet, ne baze te te cilave aksionmbajtesit mund te ushtrojne te drejten e votes ne asamble, percaktohen ne ftesen per te marre pjese ne asamblene e aksionmbajtesve per aq kohe sa nuk jane dhene certifikatat e aksioneve.

Neni 5/3

Nese kryetari i asamblese nuk eshte caktuar unanimitisht nga asambleja, atehere si kryetar i asamblese do te jete kryetari i Keshillit Mbikqyres.

Kryetari drejton asamblene dhe vendos mbi vazhdimesine, objektet e bisedimit dhe mbi menyren e votimit.

Neni 5/4

Asambleja formon nje quorum nese jane perfaqesuar te pakten 25 % e aksioneve me te drejte vote. Ne qofte se perfaqesimi eshte me pak se 25%, thirret menjehere nje mbledhje e dyte. Mbledhja e dyte formon nje quorum pa mbajtur parasysh perfaqesimin e aksioneve me votim nese kjo pike eshte percaktuar ne lajmerim, me perjashtim te rasteve kur, per marrjen e vendimit te hartuar ne rendin e dites, kerkohet me ligj nje mazhorance me e larte.

Vendimet e asamblese merren me shumicen e thjeshte te votave, me perjashtim te rasteve kur ligji e parashikon ndryshe. Ne raste te tilla kur ligji percakton mazhorance te kapitalit ne **para** qe shoqeria ka ne dispozicion te saj qe ekziston ne kohen e miratimit te rezolutes, do te jete e mjaftueshme nje mazhorance e thjeshte e kapitalit themelor ekzistues nese ligji nuk parashikon nje mazhorance me te larte.

Rezultati i votes mund te percaktohet me ane te metodes se zbritjes se votave 'po' ose 'jo' dhe abstenimit te votave te aksionmbajtesve te lejuara ne total.

Nese mazhoranca e thjeshte nuk arrihet ne votimin e pare , atehere ndermjet dy personave qe kane marre numrin me te madh te votave do te zhvillohet nje votim deciziv. Ne rastin e barazimit te votave ne balotazhin e dyte do te hidhet short.

Neni 5/5

Ne asmlene e aksionmbajtesve do te merren aktet noteriale, te cilat do te firmosen nga noteri dhe kryetari i asamblese.

Neni 5/6

Drejtoria e shoqerise duhet t'i paraqese Keshillit Mbikqyres dokumentat ligjore ne lidhje me aktivitetin e shoqerise gjate vitit te fundit sipas kerkesave ligjore ne tre muajt e pare te cdo viti fiskal.

Bilancet financiare te fund-vitit, raporti mbi aktivitetin, raporti i keshillit mbikqyres dhe te gjitha projekt-vendimet dhe dokumentat e tjera te parashikuara me ligj duhet te paraqiten 15 dite perpara asamblese ne seline e

aktivitetit te shoqerise per t'u shqyrtuar nga aksionmbajtesit ose duhet t'u dergohen atyre ne baze te kerkeses se tyre.

Cdo vit, pas marrjes se raportit, i cili duhet t'i dorezohet Keshillit Mbikqyres brenda 6 muajve te pare te vitit ushtrimor, asambleja vendos mbi zevendesimin e Drejtorise se Shoqerise dhe Keshillit Mbikqyres, mbi perdorimin e perfitimit neto te vitit dhe, ne rastet e tjera te parashikuara me ligj, mbi percaktimin e treguesve financiare vjetore.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 6 te shfuqizohet dhe te formulohet si me poshte vijon:

Neni 6

Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 anetare.

Koha e ushtrimit te detyres per te gjithë anetaret eshte 2 vjet.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te japin doreheqjen nga detyra me ane te nje deklarate me shkrim, e cila duhet t'i dergohet kryetarit te Keshillit Mbikqyres, duke respektuar nje limit prej dy javesh.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 7 te formulohet si me poshte vijon:

Neni 7

Keshilli Mbikqyres zgjedh midis anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes per kohen e ushtrimit te detyres te percaktuar ne kete statut. Zgjedhja e tyre behet ne mbledhjen e pare qe thirret pas mbledhjes se pergjithshme te aksionmbajtesve ne te cilen eshte zgjedhur ky keshill. Ne qofte se kryetari ose zevendesi i tij lirohen nga detyra para mbarimit te afatit, do te kryhet nje

zgjedhje tjetër për periudhën e mbetur nga koha e ushtrimit të detyrës së personave që janë liruar.

Ne pamundësi ardhjeje të kryetarit dhe zëvendësimit të tij, gjatë kësaj kohe detyrat do të kryhen nga anëtarët me i vjetër në moshe.

Këshilli Mbikqyres mund të përcaktojë rregulla të brendshme lidhur me procedurën e punës. Kështu, detyrat individuale mund të u kalohen komiteteve. Megjithatë, vendimet mund të nxirren vetëm nga Këshilli Mbikqyres në teresi.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse në mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon që pas nenit 7 të shtohet neni 7/1 me këto përmbajtje:

Neni 7/1

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyres thirren me shkrim nga kryetari dhe në pamundësi ardhjeje nga zëvendësi i tij. Lajmerimi bëhet 15 ditë përpara. Në raste urgjente lajmerimi mund të bëhet brenda një kohe me të shkurter dhe ftesa mund të komunikohet gojarisht, me telefon, teleks ose telegram. Në këto ftese duhet të specifikohen rendi i ditës dhe sugjerimet e vendimeve.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % të votave të aksioneve pjesëmarrëse në mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon që neni 8 të formulohet si më poshtë:

Neni 8

Nëse të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyres janë ftuar në kohën e duhur dhe nëse të paktën gjysma e numrit legal të tyre marr pjesë në miratimin e një rezolute, atëherë Këshilli Mbikqyres formon një quorum (numur anëtarësh që duhet të jete prezent për të konsideruar një mbledhje të vlefshme). Miratimi i një rezolute, e cila nuk ka qene e përfshirë në rendin e ditës të përcaktuar,

eshte e lejueshme vetem nese asnje nga anetaret e pranishem te keshillit mbikqyres nuk kundershton rezoluten dhe te pakten dy te tretat e anetareve jane te pranishem.

Mbledhja do te drejtohet nga kryetari dhe ne rast se ai nuk eshte i pranishem nga zevendesi i tij. Kryetari vendos rradhen e rendit te dites, llojin dhe rradhen e votimit.

Vendimet mund te miratohen vetem nga mbledhjet e Keshillit Mbikqyres. Vendimet e Keshillit Mbikqyres do te miratohen me mazhorance te thjeshte, me perjashtim te rasteve kur ligji e parashikon ndryshe. Kjo eshte e vlefshme edhe per votimin.

Ne rast barazimi votash, do te ndermeret nje tjeter diskutim lidhur me ceshtjen konkrete vetem nese shumica e Keshillit Mbikqyres vendos per kete, perndryshe do te behet nje votim tjeter i menjehershem. Nese dhe rezultati i votimit te dyte eshte i barabarte, atehere kryetarit i jepet e drejta e dy votave.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 8 te shtohet nenet 8/1 dhe 8/2 me kete permbajtje:

Neni 8/1

Procesverbalet e mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres, dhe te komiteteve nese ekzistojne, duhet te pergatiten dhe te nenshkruhen nga drejtuesi perkates i mbledhjes.

Neni 8/2

Anetaret e Keshillit Mbikqyres duhet te ruajne menyren e gjykimit dhe te veprimit ne lidhje me informacionin konfidencial dhe sekretet e shoqerise, vecanerisht ato industriale dhe te biznesit per te cilat ata jane bere te vetedijshem nepermjet punes se tyre. Kjo mbetet e vlefshme dhe pas largimit

nga Keshilli Mbikqyres. Informacioni lidhur me shoqerine mund t'i transferohet paleve te treta vetem me miratimin e kryetarit te Keshillit Mbikqyres dhe me kusht qe transferimi nuk rrezikon interesat e shoqerise.

Ne qofte se palet e treta kane marre pjese ne mbledhjet e Keshillit Mbikqyres, ato duhet gjithashtu te ruajne maturine.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 9 te shfuqizohet dhe propozon kete nen te ndryshuar:

Neni 9

Keshilli Mbikqyres kontrollon Drejtorine e shoqerise dhe eshte pergjegjes per heqjen e detyrave dhe mbrojtjen e te drejtave te cilat i kalojne atij me ane te ligjit, statutit ose ne ndonje forme tjeter. Keshilli Mbikqyres ka gjithashtu te drejten te therrase Asamblene e aksionmbajtesve.

Keshilli Mbikqyres mund te percaktoje nje liste te atyre masave dhe veprimeve te cilat mund te merren nga Drejtoria e Shoqerise. Keto i nenshtrohen marreveshjes fillestare te Keshillit Mbikqyres. Kjo eshte e vlefshme vecanerisht per politiken e objekteve te biznesit, investimit dhe financimit, fushat e veprimit te shoqerise dhe personelit si dhe drejtimin e kontrates.

Keshilli Mbikqyres ka te drejte te mbikqyre ne cdo kohe manazhimin e plote te Drejtorise se Shoqerise. Ne kete menyre mund te shihen dhe te inspektohen nga keshilli mbikqyres gjithashtu dhe librat, regjistrimet dhe qellimet e shoqerise.

Drejtoria e Shoqerise eshte e detyruar te vere ne dijeni Keshillin Mbikqyres sipas menyres se percaktuar me ligj. Perverc kesaj Keshilli Mbikqyres mund te kerkoje nje raport per problemet e shoqerise, marredheniet ligjore dhe te

biznesit me shoqerite qe kane lidhje, si edhe per aktivitete te biznesit qe jane sinjifikative per pozicionin e aksionmbajtesve.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 9 te shtohet neni 9/1 me kete permbajtje:

Neni 9/1

Deklaratat e Keshillit Mbikqyres do te jepen ne emer te ketij keshilli nga kryetari dhe ne mungese te tij nga zevendes kryetari.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 10 per shperblimin e anetareve te KM te ndryshoje si me poshte:

Neni 10

Cdo anetar i Keshillit Mbikqyres pervec kompensimit per shpenzimet e tij do te marre edhe nje shperblim vjetor si me poshte:

- Kryetari: 50 % te pages se Drejtorit
- Zv/Kryetari: 45 % te pages se Drejtorit
- Anetaret: 40 % te pages se Drejtorit

Kjo pagese do te jete e detyrueshme pas perfundimit te cdo viti fiskal.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe nenet 11, 12, 13 te shfuqizohen dhe ne vend te tyre te formulohen nenet 11,12, 13 si me poshte vijon:

Neni 11

Drejtoria e shoqerise mund te perbehet nga nje ose disa persona fizike. Emerimi i disa anetereve zevendes te Drejtorise se Shoqerise eshte i lejueshem. Ata kane te drejta te njejta sikurse anetaret e tjere te Drejtorise se Shoqerise persa i perket formes se jashtme te perfaqesimit.

Jane e drejte e Keshillit Mbikqyres:

- percaktimi i numrit te anetareve te Drejtorise se Shoqerise
- perfundimi i kontratave te punesimit
- emerimi ose shkarkimi i Drejtorise
- emerimi i nje anetari si kryetar i Drejtorise se Shoqerise
- emerimi i nje anetari tjeter te kesaj Drejtorie si zevendes kryetar te Drejtorise se Shoqerise nese Drejtoria perbehet nga disa anetare

Neni 12

Nese bordi drejtues perbehet nga disa persona, do te percaktohen rregullat e perhershme te cilat do t'i nenshtrohen aprovimit te Keshillit Mbikqyres. Vendimet e Drejtorise se Shoqerise do te miratohen me mazhorance votash. Ne rast barazie votash, vota e kryetarit te Drejtorise se Shoqerise do te jete percaktuese. Nese ai nuk eshte i pranishem, atehere vota e zevendes kryetarit mbetet decizive.

Neni 13

Nga ana ligjore shoqeria perfaqesohet nga Drejtoria e Shoqerise nepermjet kryetarit te saj.

Nese Drejtoria e Shoqerise perbehet nga disa persona, anetaret e kesaj Drejtorie kane te drejte te perfaqesojne shoqerine vetem bashkarisht. Keshilli Mbikqyres mund te nxjerre vendim tjeter.

Keto nene u votuan dhe u miratuan me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 13 te shtohet neni 13/1 me kete permbajtje:

Neni 13/1

Drejtoria e Shoqerise eshte e detyruar para shoqerise te respektoj kufizimet e percaktuara me ligj, statutin dhe Keshillin Mbikqyres lidhur me hapesiren e autoritetit te tij manazhues.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 14 te shfuqizohet dhe te formulohet si me poshte vijon

Neni 14

Shperndarja e shoqerise

Kur shoqeria shperndahet, pasi zbriten shumat qe i perkasin te gjitha detyrimeve, shoqeria ndan mbetjen e kapitalit themeltar ndermjet aksionereve perpjestimisht me kuotat qe ata posedojne ne kete kapital, kur nuk ka patur mundesi per cedimin e aksioneve.(Neni 265, 291, 292, 294)

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 14 te shtohet nenet 14/1, 14/2, 14/3 me kete permbajtje:

Neni 14/1

Veprimtaria e shoqerise

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne baze te parimeve ekonomike dhe rezultatet pasqyrohen ne bilancet e saj.

Veprimtaria e Shoqerise pasqyrohet ne librat e saj kontabel duke zbatuar punimet e kontabilitetit te parashikuara nga legjislacioni shqiptar. Aktiviteti i shoqerise kryhet mbi bazen e programeve ekonomiko-financiare qe jane pjese perberese e veprimtarise se shoqerise. Rezultatet financiare te aktivitetit te shoqerise pasqyrohen ne bilancin e saj vjetor. Cdo ankese apo kerkese qe te tretet i adresojne shoqerise, jane te vlefshme vetem kur ato dergohen tek Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise.

Neni 14/2

Pasurite e shoqerise

Shoqeria krijon nje fond-pasuri te saj dhe eshte pronare e pasurive te saj. Shoqeria ka te drejten e disponimit te fondeve sipas qellimeve dhe objektiveve te veprimtarise se saj. Ligji perkujdeset dhe mbron pronen e shoqerise si dhe te drejtat e aksionereve te huaj.

Neni 14/3

Fondet rezerve

Shoqeria krijon nje fond rezerve, si dhe fonde te tjera te posacme te nevojshme per zhvillimin e veprimtarise se saj. Perberja, shuma totale dhe burimet per krijimin e fondit rezerve, si dhe perdorimi dhe administrimi i cdo fondi te posacem, percaktohen nga Keshilli Mbikqyres nepermjet miratimit nga Asambleja e Aksionereve, ne perputhje me aktin e themelimit, kete statut dhe ligjin “ Per shoqerite tregetare “.

Shoqeria, nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur te gjitha detyrimet ligjore, le menjane nje shume me vlere 1/20 e ketij fitimi, e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve, te quajtur “ rezerve e domosdoshme “. Cdo vendim i kundert eshte i pavlefshem.(**Neni 213**) Lenia menjane e fondeve nga fitimi i shoqerise, nuk eshte me e detyrueshme, nese “rezerva e domosdoshme” arrin 1/10 e kapitalit themelor.

Shoqeria mund te disponoje te gjitha mjetet financiare, si nga ato te sajat ashtu dhe nga kredite, qe nevojiten per realizimin e qellimeve te shoqerise. Detyrimet eventuale qe mund te lindin pergjate aktivitetit te shoqerise do te mbulohen nga fondet rezerve dhe nga fondet e tjera, ose nga te nenshkruarit e kapitalit themelor(nga ana e aksionereve), per kuotat eventuale suplementare sipas nenit 8 te ketij statuti.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjese-marrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 15 te jete si me poshte vijon:

Neni 15
Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjese-marrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe pas nenit 15 te shtohet neni 15/1 me kete permbajtje:

Neni 15/1
Veprimtaria financiare

Veprimtarite financiare te shoqerise realizohen sipas planeve ekonomiko-financiare dhe programeve ekonomike vjetore.

Rezultatet financiare te veprimtarise se shoqerise do te percaktohen ne baze te bilancit vjetor. Konvertimi i monedhes shqiptare ne devize te huaj dhe anasjelltas do te behet konform ligjit te kontabilitetit nepermjet kursit te kembimit te Bankes se Shqiperise.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe neni 16 te shfuqizohet dhe te formulohet si me poshte vijon:

Neni 16

Bilanci

Bilanci dhe llogaria ekonomike e shoqerise aprovohen paraprakisht nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise mbi bazen e formes se bilancit dhe te llogarive ekonomike te percaktuara ne ligjin “ Per kontabilitetin “. **(Neni 103)**

Bilanci vjetor financiar mbyllet me 31 Dhjetor dhe duhet t`i paraqitet Asamblese se Zakonshme te Aksionereve nga ana e Keshillit Mbikqyres te shoqerise brenda 15 Shkurtit te vitit pasardhes.

Bilanci i shoqerise do te mbahet me leke, por nese eshte e nevojshme dhe e domosdoshme, ai mund te mbahet edhe me valute(dollare amerikane ose lireta italiane), ne perputhje me legjislacionin shqiptar per kete qellim.

Veprintaria financiare mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Lidhur me nenin 17 z. Gezim Dauti propozon qe te shfuqizohet dhe te formulohet si me poshte vijon:

Neni 17

Fitimi

Asamblea e Zakonshme e Aksionereve percakton nje vendim te saj per kete qellim, perdorimin e fitimit neto pasi te jene bere zbritjet e domosdoshme ligjore. **(Neni 214)**

Asambleja e Zakonshme e Aksionereve merr nje vendim te vecante per masen e perqindjes nga fitimi neto qe do te shperndahet si dividend proporcionalisht per cdo aksioner mbi bazen e perqindjes se posedimit te sejcilit ne kapitalin themelor te shoqerise.

Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar te shoqerise, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit, aktit te themelimit dhe ketij statuti dhe, nga ana tjeter pasi te zbriten ose te shtohen respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme. Asambleja e aksionereve mund te marre vendim qe te shperndahen shumat e lena menjane per rezerven qe ajo ka ne dispozicion. Ne kete rast vendimi tregon shprehimisht llojet e rezerves ku jane marre keto shuma.

Pervec rastit te zvogelimit te kapitalit themelor, asnje shperndarje nuk mund t`u behet aksionereve, ne qofte se kapitalet e shoqerise jane ose do te beheshin mbas kesaj shperndarje me te vegjel se shuma e kapitalit themelor, te cilit i shtohen rezervat qe ligji, akti i themelimit ose ky statut, nuk i lejon te shperndahen.

Ky nen u votua dhe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje

Z. Gezim Dauti propozon qe nenet 18 dhe 19 te shfuqizohen pasi kane te bejne me emerimin e KM te pare dhe te Drejtorit te pare. Ai propozon formulimin e ri te dy neneve 18 dhe 19 per ndarjen, bashkimin dhe likuidimin e shoqerise.

Neni 18

Shoqeria mund te ndahet ose te bashkohet me shoqeri te tjera me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme, me shumice votash te aksionereve, sipas kriterëve te caktuara per ndryshimin e statutit te shoqerise.

Ne rastin e ndarjes, bashkimit te shoqerise do te zbatohen dispozitat e seksionit IV te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 “ Per shoqerite tregetare “.

Neni 19

Likuidimi i shoqerise vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme e aksionereve, kur per te jane dakort shumica e quorumit per marrjen e vendimeve ne kete asamble.

Vendimi i likuidimit te shoqerise duhet tu behet e njohur te gjithe aksionereve te shoqerise nepermjet publikimit te tij ne mjetet e informacionit publik.

Aksioneret te cilet zoterojne aksione ne masen e parashikuar ne nenin 139 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 “ Per Shoqerite tregetare”, kane te drejte te kundershtojne ne rruge gjyqesore vendimin e marre nga Asambleja e Jashtezakonshme.

Procesi i likuidimit te shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e seksionit V te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregetare”.

Keto nene u votuan dhe u miratuan me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Pas kesaj, perfundimit te miratimit nen per nen te statutit, aksioneret Skender Kovaci dhe Sadi Hyra pyeten ne se ktij statuti mund ti behen ndryshime ne te ardhmen apo jo. Pergjigja u dha qe ndryshime e permiresime ne te ardhmen mund te behen, por gjithmone sipas procedures se percaktuar ne ligjin 7638 “ Per Shoqerite tregetare”.

Kalohet ne zgjedhjen e Keshillit Mbikqyres dhe ekspertit kontabel. U propozua dhe u miratua unanimisht qe KM te perbehet nga 3 (tre)veta. Aksioneri Hekuran Hasko propozon per anetar te KM z. Edmond Karafili, kandidature qe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Aksioneri Fuat Banja propozon per anetar te KM z. Agron Shapllo, kandidature qe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Aksioneri Agron Shaplo propozon per anetar te KM z. Grigor Dhaskali, kandidature qe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Aksioneri Agron Shaplo propozon gjithashtu qe ekspert kontabel i shoqerise te jete z. Eduart Kila, kandidature qe u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Pas kesaj kalohet ne piken e fundit te rendit te dites per miratimin e ndryshimeve te akteve te themelimit. Z. Gezim Dauti propozon keto ndryshime ne aktet e themelimit:

Pika 1. Shoqeria anonime emertohet: Shoqeria **“REFRAKTARE sh. a.”** Ky ndryshim u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Pika 2. Plotesohet me prodhim makinerish, paisje, konstruksione metalike dhe ndertimore, prodhime druri, prodhim stampash dhe pjese kembimi mekanike dhe elektrike, sherbime per te trete per aktivitetet e mesiperme dhe veprimtari export- import.

Ky ndryshim u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Pika 3. Fjalet “ me miratimin e organeve kompetente” zevendesohen me fjalet “ me vendim te Asamblese se Jashtezakoneshme te Aksionereve “

Ky ndryshim u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Pika 4. Ndryshon vlere e kapitalit themeltar te shoqerise ne 450. 624. 000 leke.

Ky ndryshim u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Pika 5. Nuk Ndryshon

U miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrese ne mbledhje.

Pika 6. Ndryshon perberja e KM. Ky keshill perbehet nga:

1. Agron Shaplo
2. Edmond Karafili
3. Grigor Dhaskali

Ky ndryshim u miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrrese ne mbledhje.

Pika 7. Nuk ndryshon

U miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrrese ne mbledhje.

Pika 8. Nuk ndryshon

U miratua me 100 % te votave te aksioneve pjesemarrrese ne mbledhje.

Me kete pike te rendit te dites u mbyll mbledhja e jashtezakoneshme e aksionereve te shoqerise anonime “ **REFRAKTARE sh. a.** “ Elbasan.

SEKRETARI

**KRYETARI I ASAMBLESE SE
AKSIONEREVE**

Altin Kruja



Agron Shaplo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E SHOQERIVE PUBLIKE
Nr. 11803 Prot.

11803

Tirane, me 7-8 1995

K E R K E S E
PER
RREGJISTRIMIN E SHOQERISE TREGTARE ANONIME
SI PERSON JURIDIK

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Ne baze te Ligjit Nr. 7926, date 20.4. 1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", kemi krijuar shoqerine anonime me pronar shtetin, me objekt veprimtarie prodhim dhe tregtim tulla dhe materiale refraktare, tulla per ndertim dhe sherbime per te trete ne fusha te ndryshme. me anetare te keshillit mbikqyres :

1. Merita Kafexhiu
2. Pjereta Sata
3. Gezim Dauti

Ne baze te Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar, kerkojme nga ana juaj rregjistrimin e shoqerise si person juridik

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE

BERZH PIRANIAN

*Te regjistruar
kerkesa
10.08.1995
Z. P. P. P.*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E

KESHILLI I RRETHIT OSE BASHKIA
DEGAE E SHOQERIVE PUBLIKE

URDHER

Nr. _____ . date _____

Ne baze te nenit 8 te ligjit Nr.7926 date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" dhe V.K.M Nr.348 date 3.7.1995 "Per keshillat mbikqyres te Shoqerive shteterore".

Urdheroj:

Emerimin e 1/3 te anetareve te keshillit mbikqyres sipas varesise se Ndermarrjes e. P. bashkicore. bashkicore te transformuar ne shoqeri tregtare te tipit (Anonime ose me pergjegjesi te kufizuara) si me poshte :

Nr.	Emri Mbiemri	Specialiteti	Ministria, Keshilli i Rrethit ose Bashkia ku punon
1.	<i>Yirim Dauti</i>	<i>Iny. miniera</i>	<i>Min. B. P. Energji</i>
2.	—	—	—

MINISTRI

(*Abdyl Haxhi*)

KRYETARI I KESHILLIT TE RRETHIT
OSE BASHKISE

()

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA AKSIONERE "REFRAKTARE" SH.A
ELBASAN

J. M. Gjeri
24/7/2000
Tabel 9
21.10.2000
LUG. 2000

K E R K E S E

**PER KOMPETENCE
GJYKATES SE RRETHIT TIRANE**

Mbeshtetur ne vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme se Aksionereve te Shoqerise Aksionere "REFRAKTARE" SH.A, te mbledhjes se dates 31.05.2000, vendim I cili eshte bashkangjitur, ndaj kerkojme nga ana juaj:

1. Percaktimin e Ekspertit Kontabel per vleresimin e vendimit te Asamblese per zvogelimin e kapitalit ne vleren 110.000.000(njeqind e dhjete milion) Leke.
2. Pasqyrimi I ndryshimit te kapitalit te zvogeluar ne Regjistrin Tregtar te Shoqerise Aksionere "REFRAKTARE" SH.A ELBASAN ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Tirane 12.07.2000

KRYETARI I KESHILLIT MIKQYRES

EDMOND KARAFILI

Edmond Karafili

EK

*Ne behet kerkesa neper
Keshillin Mikqyres
sh. 07. 2000*

[Signature]

KRYETARI I ASAMBLESE

AGRON SHAPLLO

Agron Shaplllo

*Ne depozite behet
1- Vendim i Asamblese
sh. 31.05.2000 Nr. 3380*

*2- Vendim i Kesh. Mikqyres
Nr. 3608 sh. 07. 2000
Asamble U. Shkendo*

3- Kerkesa Nr. ekstra sh. 02.04.2000

*4- Raport i ekspertit kontabel te
auditimit te sh. 31.12.1999
qelluar te sh. 01.01.2000*

*5- Raport i ekspertit kontabel te
auditimit te sh. 31.12.1999
qelluar te sh. 01.01.2000*

*Proces Verifikimit Kontabel te
auditimit te sh. 31.05.2000
Nr. 3485*

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
REFRAKTARE SH A ELBASAN

K E R K E S E

Pala kerkuese: Vasil Dhono, drejtor ekzekutiv i Shoqerise Aksionere Refraktare Sha Elbasan.

Me Objekt: Depozitim ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se rrethit Tirane te Vendimit te Asamblese se jashtezakoneshme te aksionereve te dates 31 maj 2000.
Baza ligjore neni 24 i Ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe te ligjit 7638 date 19.11.1992.

Perpara: GJYKATES SE RRETHIT TIRANE.

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane Nr. 11803 date 10.08.1995 eshte rregjistruar shoqeria anonime REFRAKTARE Sha Elbasan.

Me vendim te Asamblese se Jashtezakoneshme te aksionereve te dates 31 maj 2000 eshte vendosur te zvogelohet kapitali i kesaj shoqerie me 110.000.000 (njeqind e dhjete milion) leke.

I kerkojme gjykates te kryeje veprimet perkatese per te bere ndryshimet perkatese ne Rregjistrin tregetar.

K E R K U E S I


Vasil Dhono
Drejtor ekzekutiv




REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE, ELBASAN
Nr 3544 Regj.

V E R T E T I M

Ne Elbasan, sot me date 25 korrik 2000 ne zyren e noterise u paraqit personalisht Vasil Dhono, i biri i Llazit, i datlindjes 1950, banues ne Elbasan, i njohur personalisht prej meje, noterit, i cili nenshkroi me vullnet te lire e te plote kerkesen e mesiperme dhe une noter e vertetoj nenshkrimin e tij.



NOTER
PELLUMB BARCI





VENDIM I ASAMBLESE No. 1-2000

Sot me date 31.05.2000 u mbledh Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve te Shoqerise Aksionere "REFRAKTARE" SH.A, e cila degjoi raportin e ekspertit kontabel Z. Eduart KILA, sipas kerkeses qe atij i ishte paraqitur nga Keshilli Mikqyres i Shoqerise ne daten 01 Prill 2000, ku ne baze te Ligjit No. 7638, date 19.11.1992, Nenseksioni i dyte , Zvogelimi i Kapitalit, Neni 164, ku atij i kerkohej vleresimi perkates per terheqje (shlyerje) te pjeseve te kapitalit prej 110.000.000(njeqind e dhjete milion) Leke.

Mbeshtetur ne kete raport, i cili vleresohet i mbeshtetur ne ligj, Asambleja e Jashtezakonshme e Shoqerise Aksionere "REFRAKTARE"SH.A ELBASAN me 84.28% vota pro dhe 019% vota kunder,

VENDOSI

1. Zvogelimin e kapitalit prej 110.000.000(njeqind e dhjete milion) Leke.
2. Vlera e nje aksioni dhe perqindja e aksionereve ne shoqeri mbeten te pandryshuara. Per zvogelimin e kapitalit me 110.000.000(njeqind e dhjete milion) Leke do te zvogelohet numri i aksioneve per cdo aksioner, kundrejt numrit te aksioneve qe perfaqeson kjo vlere dhe numrit te aksioneve qe disponon cdo aksioner.
3. Pasqyrimi i ndryshimeve te kapitalit ne regjistrin tregtar ne Gjykates se Rrethit Tirane.

SEKRETARI
ELTON MERSINI

KRYETARI I ASAMBLESE
AGRON SHAPLLO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
REFRAKTARE Sha ELBASAN

VENDIM I KESHILLIT MBIKQYRES Nr

Sot me date 30 mars 2000 u mblodh Keshilli Mbikqyres i Shoqerise Anonime REFRAKTARE Sha, i cili diskutoi rreth rezervave te konsiderueshme monetare te krijuara gjate viteve 1995 - 1999, te cilat ne gjendjen qe jane nuk japin te ardhura. Ne keto kushte, ne zbatim te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992, nenseksioni II - Zvogelimi i kapitalit, neni 164 Keshilli Mbikqyres

V E N D O S I

1. Ti beje kerkese ekspertit kontabel te shoqerise lidhur me zvogelimin e kapitalit ne vleren 110.000.000 (njqind e dhjete milion) leke. Ne baze te kesaj kerkese eksperti kontabel te paraqise Raportin perkates perpara Asamblese se Jashtezakoneshme te aksionereve te Shoqerise REFRAKTARE Sha. Elbasan.

2. Asambleja e Jashtezakoneshme e Shoqerise do te mblidhet ne daten 31 maj 2000 per te shqyrtuar Vendimin e Keshillit Mbikqyres ne baze te raportit te ekspertit kontabel.

Per Keshillin Mbikqyres

Kryetari

Edmond Karafili

Edmond Karafili

ek


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr Regj.

3609


V E R T E T I M

Ne Tirane, sot me date 28 korrik 2000 ne zyren e noterise u paraqit personalisht Edmond Karafili, i biri i Ajazit, i datlindjes 1951, banues ne Tirane, rruga Zhan D Ark. pallati 1/1 Ap. 15, i njohur personalisht prej meje, noterese, i cili nenshkroi me vullnet te lire e te plote kerkesen e mesiperme dhe une noteri e vertetoj nenshkrimin e tij.

NOTERE



Ilir Shkurtaj



REFRAKTARE Sh.a.

Zona Industriale Elbasan

Phone: ++355 54 4565

Fax: ++355 54 53553

Nr Ekstra Prot

Elbasan, 01 Prill 2000

Lenda: Kerkese per vleresimin e zvogelimit te kapitalit te "Refraktare sha Elbasan"

- Ekspertit kontabel te autorizuar

Z. Eduart Kila

Ketu!


"Refraktare sha Elbasan", gjate viteve 1995-1999, ka krijuar rezerva monetare te konsiderueshme, te cilat ne formen ekzistuese nuk japin te ardhura. Ne keto kushte, ne perputhje me misionin Tuaj, si edhe ne zbatim te Ligjit nr 7638 dt 19.11.1992, nenseksioni II – Zvogelimi i kapitalit, neni 164 kerkojme nga ana Juaj vleresimin perkates per terheqje (shlyerje) te pjeseve te kapitalit per leke 110 (njqindedhjete) milion. Raporti Juaj te paraqise gjendjen perkatese si edhe ndryshimet e nevojshme ne bilancin e vitit 1999/31.12.

Meqenese mbledhja e Asamblese do te behet ne date 31 Maj 2000, lutemi te paraqisni raportin perkates brenda dates 15 Maj 2000.

Per **KESHILLIN MBIKQYRES**

KRYETARI


Edmond KARAFILI



3989

VERIFIKIM I BILANCIT TË SHËRKËTISË "REFRAKTARE SH.A." PËR VITIN 1999/31.12.

Tirane 18.07.2000





ZONJA ZORRINA EL
 SHOQERISE ANONIME "REFINANSALE"
 ELBASAN
 SHOQERI ANONIME ME KAPITAL
 THEMELTAR PER 450.594.000 Leke.

Titujmja e Noterëve Elbasan
 Nr. 3550 Rap. Data 26.09.2000
 Vënetohet pjesa në origjinalin
 Noter
 PELLUMB BARCI

[Handwritten signature]

R A P O R T I E K S P E R T I T
 K O N T A B E L T E A U T O R I Z U A R
 V A L E S I M I Z V O G E L I N I T
 T E K A P I T A L I T T E S H O Q E R I S E
 P E R T E R H E Q I E T E T I J.

Ne ekzekutim te misionit tim qe me eshte
 besuar prej dushme date 1 Prill 2000, kam qendur tu
 parages raportin e vleresimit te shkeqeve dhe kushteve te
 teknologjise se kapitalit (shlyerjen e tij), duke u beshtetur ne te
 dhenaat e bilencit te periudhes 1.1.1999 deri ne 31.12.1999.

VLERESIMI I GJENDJES SE KAPITALIT TE SHOQERISE ME 31.12.99

- Gjendja e kapitalit me 31.12.1999, paraqitur ne llogarime
 101 eshte per leke ~~XXXX~~ ----- 450.594.000 Leke
- * e barabarte kjo me aktet e themelimit te shoqerise.
- Gjendja e rezervave nga rivleresimi me 31.12.1999 eshte
 paraqitur me vleren leke ----- 33.256.705 Leke
- Gjendja e rezultatit financiar para vitit 1999 eshte
 paraqitur me vleren leke ----- -11.300.091 Leke
- Gjendja e rezultatit financiar ne vitin 1999 eshte
 paraqitur me vleren leke ----- 16.173.356 Leke
- Gjendja e provisioneve te krijuara ne bashkëpunim me kaluar
 per vlerenotime te medha ----- 257.742 Leke
- Ga sinqer kapitali i shoqerise "REFINANSALE" eshte
 me vleren leke 524.521.733.



VLERESIMI I GJENDJES FINANCIARE TE SHOQERISE NE 31.12.1999



Aktivitet e qendrueshme te trupezuara paraqiten ne bilanc tek vleresuarat per vleren e mbetur leke 300.748.949.

Gjendja e tyre eshte e mire dhe garantojne vazhdimesin e procesit teknologjik. Kjo shoqeri ka investuar ne zhvillimin e prodhimin e materialeve refraktare.

-Po ne grupin e mesiperme paraqitet vlera e studimeve te kryera per prodhimet te reja per leke 3.185.125.

Kjo vlera eshte e rikuperueshme ne periudhen e ardhshme.

-Gjendjet e inventarit dhe ne proces paraqiten ne bilanc per vleren leke -----53.388.234

* Luk ka vlera materiale stogje dhe keto vlera ne pjesen me te madhe te tyre paraqesin gjendjen e lendes se pare argjile e lende diegese, gazoil.

-Kontesa per arketimin e debitorit paraqitet ne bilanc me vleresuarat per leke -----25.755.731.

Ne keto poste nuk ka vlera te arketueshme, te shprehese arketimi. keto paraqesin vleren e prodhimeve e shorbimeve te kryera ne vitin 1999, te pa arketuar ne ate periudhe.

-Likuiditete dhe vlera te tjera paraqitet ne bilanc per leke sipas dokumentave perhatese -----50.071.989.

Totali i aktiveve te shoqerise 583.644.785 leke.

Totali i aktiveve qarkulluese debitoreve (kliente) dhe C.A.Sh. 139.710.944 leke

Si dhe shihet nga te dhenat e mesiperme shoqeria gazon nje gjendje te mire financiare dhe gjendje te lire ne C.A.Sh.



1/2



VLERESIMI I GJENDJES SE KREDITOREVE TE SHOQERISE 31.12.1999



Ne shoqerine "REFRAKTARE" Elbasan gjendja e detyrimeve
ne total paraqitet per leke 59.123.053. vlere kjo e
analizuar si vijon :

-Furnitore per detyrime mbi nje vit	48.493.134 leke
Nga kjo - Buxheti shtetit	31.931.825 leke.
-Parashanimet dhene per porosi	30.000 "
-Furnitore per me pak se nje vit	2.800.670 "
-Page te personelit paguar me 3/1/2000	1.020.385 "
-Sigurime shoqerore e te ngjashme	586.046 "
-Shteti tatim dhe taksa	5.884.351. "
-Ortake per dividend te pa terhequr	271.919 "
-Detyrime per depozitues etj.	35.548 "

Gjendja e tyre ne kontabilitet (bilancin e 31.12.1999 paraqitet e vleresuar me detyrimin faktik. Muft do te kete rivleresime te ketyre vlerave gjate shlyerjes se detyrimeve. Ne te ka dhe furnitore per vlera te parashkruara, te falimentuar etj.

SHKAKU I ZVOGELIMIT TE KAPITALIT TE SHOQERISE "REFRAKTARE"

Mbashtetur ne kerkesen e bere ne emer te Koshillit Mbikqyres te shoqerise anonime "Refraktare" Elbasan nga Z.Edmond Karafili si dhe ne argumentimin e bere nga ana e tij (Koshilli Mbikqyres) se ne kete ndermarrje ka vlera monetare te lira, dhe per kete arsye do te behet terheqja e tyre ne zvogelim te kapitalit (me shlyerje te tij) **komentojmë** si vijon:

Gjendja ne C.A.Sh ne kete shoqeri paraqitet per leke 60.026.989, ~~vlere~~ vlere keto te justifikuara me ekstraktet bankare ne fund periudhen 31.12.1999. Debitore te arketuohem sipas bilancit 95.745.721 leke. Sipas kontrollit te ushtruar ne to nuk ka zhvlersime per te bere. Sa siper shuma e ketyre zenave jep nje vlere per leke 155.822.710.



Duke krahasuar te dhenat e mesiperme ne gjendjen ne total te detyrimeve sipas dhe bilancit me 31.12.1999, qe vleresohen me leke 59.123.053 rezulton :

Gjendja me 31.12.1999 e debitoreve	95.745.721	leke
" " " O.A.Sh.	60.076.989	"

Totali	155.822.710	"

Dhendra me 31.12.1999 e detyrimeve	59.123.053	"

Diferenca	96.699.657	"

pra nga sa shihet shqoeria ka gjendje mjebeshtesh te lira qe arrijne masa te konsiderueshme.

Veprimi i ndermarre eshte ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638 Dt.19.11.1992 neni 164 i nensksionit -Zvogelimi i Kapitalit.

Ne rastin konkret eshte e drejte e asamblese se ordoakeve te vendose per shumen perkatese por do te desha tu sugjeroja nivelin e vleres per te mos penguar procesin e punes se kesaj shqoerie

Se siper eshte i mundur veprimi mbeshtetur dhe ne rezultate e kater mujorit te ~~xxxxxx1999~~ te vitit 2000.

ZVOGELIMI I KAPITALIT SJEL SI PASOJE DHE ZVOGELIMI I numurit te akcionerit te akcionerave ne njera te bashkimit gjesemarrjen e tyre ne kontributin e derdhur.Shih listen ngjitur. Veprimet qe do te ndermarren te pasqyrohen dhe ne aktet perkatese ne Gjykatën e Rrethit Tirane .

Ne zbatim te ligjes sa siper nenit Nr.165 te cillojne veprimet sipas kerkesave perkatese.

OPINIONI

Sipas opinionit tim kerkesa per zvogelimin te kapitalit eshte motivuar dhe ne zbatim te ligjes Nr.7638 dt.19.11.1992 neni 164 dhe 165,pra miratoj veprimin perkates.

Ne rerefundim te veprimit sipas kerkeses qe kapitali te zvogelohet per leke 110.000.000 gjendja e tij pas kryerjes se aktit behet.

Kapitali pas



Kapitsli pas avogelimi eshte :

340.624.000 leke

(TRE QINDEZYETMILIONEGJASHTEQINDEHJEZETEKATERRHIJJELEKE)

ELBASAN



KONTABEL I AUTORIZUAR
KONTABEL I AUTORIZUAR
KONTABEL I AUTORIZUAR

Elbasan 10.Maj .2000



Bagja 5 Maj

Falleti 500/2

Tel. 537 95

ZONJA ANT ZONJAN LE

SHOQËRIE ANONIME "ALFAKREDIT"

E L B A S A N

SHOQËRI AMBULANSE E VARRIET

HEMBELIAR PER 450.504.000 leke.

R A P O R T I E K S P E R T I T
K O M P A B E L L E T E A U T O R I Z U A R
V E R S I N I S H E B E I Z V O G L I M I T
T E K A P I T A L I T E T S H O Q E R I S E
P E R T E R A D Q I E T E T I J ;

Ne shtesatim te misionit tim dhe te kerkeses
suej per te bene vleresimin e shtetesit financiar te shtetesit
te shqerites anonime "shqeritete "Elbasan ne dt.30.5.2000
konstatove si ne poshte vijon:

1. R E Z U L T E M I F I N A N C I A R I P E R D E T I T 1-1/30-5/2.000

Gjendja financiare e shqerites suej ne kete
periudhe e per mese suej eshte permirshuar ne menyre te ndjeshme
dhe te shant e bilancit financiar te perqarft ne kete periudhe
eshte rradhuar nje e ardhur per 80 milion leke dhe nje
nivel shqerimesh per 77 milion leke, per diferenco nje
shqerimi ne kete periudhe jep nje shtim bruto per 13 milion
leke, nje e ardhur per ne tej efektive parase te kesaj
shqerime.

2. G J E N D J A K O M P A B E L L E T E D t . 3 0 , 5 , 2 . 0 0 0

Ne verifikimin e bene per kete troves ne
dokumentat e ankes dhe bankes te dt.30.5.2000 rezultoi:

- Gjendja ne Alfa-Kredit Bank	106.314.099 leke
- " " Banken Komb. Dreg. Elbasan	2.353.348 "
- " " " e hurrimeve Elbasan	779.121 "



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN

Nr. 3485 Rep.

Elbasan, 22.07.2000

V E R T E T I M


Ne Elbasan, sot me date 22.07.2000 (Njezetedy Korrik Dymije) ne zyren e noterise ne prezence te noter Pellumb Barçi, u paraqiten z. Agron Shaplo dhe z. Elton Mersini, respektivisht i pari ne cilesine e Kryetarit dhe i dyti ne ate te Sekretarit te Asamblese se Aksionereve te "Refraktare sha Elbasan", te njohur ne baze te dokumenteve identifikues qe me paraqiten, me shtetesi dhe kombesi shqiptare dhe te afte per te kryer veprime juridike, te cilet kerkuan depozitimim e materialeve te mbledhjes se zakonshme nr. 4 dhe mbledhjes se jashtezakonshme nr.2 te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise Anonime "Refraktare sha Elbasan".

Konfirmohet bazueshmeria ne ligje dhe permbajtja e materialit, proçedura e zhvillimit te mbledhjes si dhe legalizimet perkatese te Kryetarit te Asamblese se Aksionereve te "Refraktare sha Elbasan dhe Sekretarit te saj, me prezence ne mbledhje te noterit Pellumb Barçi.

Vertetohen firmat nga noteri Pellumb Barçi

NOTERI

Pellumb Barçi





“REFRAKTARE Sh.a.”
ZONA INDUSTRIALE ELBASAN
ALBANIA

Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 53
(E – Mail) : refraktare@sanx.net

zj. F. Bajë
18.10.2001
Tello
18 OTT. 2001

Nr. *52-01/4* Prot.
Date, 06.08.2001

LENDË:

KERKESE

per Depozitim ne Regjistrin Tregetar te

Vendimit te Asamblese te Aksionereve te Shoqerise

“Refraktare” sh.a. Elbasan te dates 27.07.2001 dhe

Vendimit te Keshillit Mbikqyres per emerimin e Drejtorise

se shoqerise Refraktare sh.a. Elbasan.

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Shoqeria anonime Refraktare sh.a. Elbasan eshte regjistruar prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendim Nr. 11803 date 10.08. 1995.

Lutemi te behet depozitimi ne Regjistrin Tregetar i vendimit te Mbledhjes se Asamblese te Aksionereve te Refraktare sh.a. date 27.07.2001, i cili konsiston ne sa me poshte:

A. Te zgjedhe sekretarin e Asamblese Z. Edi Stafa

B. Te beje ndryshimet ne statut si me poshte:

Neni 5/1

1- Mbledhjet e Asamblese te aksionereve mbahen ne seline e shoqerise ose ne vendin e percaktuar ne thirrje.

4- Thirrja e Asamblese se aksionereve behet me ane te njoftimit qe i dergohet çdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi kryhet 15 dite perpara mbledhjes, dhe duhet te permbaje: *diten, oren, vendin e mbledhjes, natyren e asamblese dhe rendin e dites.*

Neni 6

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 4 anetare.

Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte sipas ligjit (6 vjet) ku çdo vit shtrihet midis asamblese te pergjithshme vjetore te njespasnjeshme.

C. Te zgjedhe Keshillin Mbikqyres te perbere nga zoterinjte:

- | | |
|-------------------|---------|
| - Edmond Karafili | Kryetar |
| - Agron Shaplllo | Anetar |
| - Edmond Tafa | Anetar |
| - Vath Gjylsheni | Anetar |

D. Te zgjedhe ekspertin kontabel Z. Eduart Kila

E. Te miratoje Programin e Investimeve

Te depozitohet gjithashtu vendimi i Keshillit Mbikqyres per zgjedhjen e Drejtorise te shoqerise Refraktare sh.a. Elbasan,


- 1) VASIL DHONO..... Drejtor Ekzekutiv
- 2) EDI STAFJA.....Drejtor Ekonomik
- 3) BESNIK ABDIAJ.....Drejtor Prodhimi

Bashkelidhur kesaj kerkese jane

- Procesverbali i Mbledhjes e Asamblese te Aksionereve Dt.27.07.2001 te shoqerise Refraktare sh.a. Elbasan.
- Vendimi i Mbledhjes te Asamblese se Aksionereve te Refraktare sh.a. i dates 27.07.2001
- Vendimi i Keshillit Mbikqyres Nr. 1/2001 date 20/09/2001

Drejtori

Vasil Dhono



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NO...3494.REP


VERTETIM

Sot me date 15/10/2001(dymije e nje) ditën e hene, ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje noteres Pranvera Karafili me seli ne rruga "Myslym Shyri" une bera konfirmimin e nenshkrimit te Vasil Dhono I biri I Llazit , lindur me 30/06/1950, banues ne Elbasan I njohur personalishte prej meje ,madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , drejtor ekzekutiv I Sh.Anonime "REFRAKTARE" Elbasan. e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

Pranvera Karafili

Qefy



Date 31. Maj. 2000

**PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE ZAKONSHME DHE TE
JASHTEZAKONSHME TE ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TE
REFRAKTARE SH.A.**



Sot me date 31.05.2000. ne oren 10⁰⁰, ne sallën e mbledhjeve te Institutit te Metalurgjise, ne Elbasan, ne baze te njoftimit qe i eshte bere çdo aksioneri nga Qendra e Regjistrimit te Aksionereve sh.a, ne Tirane, nepermjet postes rekomande, zhvillohet mbledhja e zakonshme dhe e jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve te Refraktare Sh.a, Elbasan.

Kryetari i Asamblese se Aksionereve njofton Asamblene se Sekretari i Asamblese nuk mund te jete prezent ne mbledhje, pasi ai ndodhet jasht shtetit, dhe i propozon Asamblese te aprovoje per sekretar te saj z. Elton Mersini.

Asambleja voton me shumice pro ketij propozimi

Sekretaria pasi kontrollon pjesmarrjen e çdo aksioneri mbi bazen e dokumentit te identifikimit dhe mandatet te leshuar nga Q.R.A. Sh.a., me date 03.05.2000, beri listimin e tyre dhe deklaroi qe 84,47% e aksioneve jane prezente.

Kryetari i Asamblese ne mbeshtetje te Statutit dhe te kerkesave te ligjes, shpalli te hapur mbledhjen.

U behet e njohur aksionereve nga sekretaria pjesmarrja ne mbledhje e Ekspertit Kontabel te Refraktare sh.a. Z. Eduart Kila dhe te noterit Z. Pellumb Barci.

Z. Agron Shaplo – Kryetari I Mbledhjes


Deklaroj hapjen e mbledhjes meqenese pjesmarrja e aksioneve eshte 84.47 % dhe si fillim kerkoj te falur per moszhvillimin e mbledhjes se asamblese se aksionereve per vitin 1998 pasi ishim ne fazen e pergatitjes per investime per prodhimin e tjegulles qeramike proces qe vazhdon edhe sot me interes per shoqerine dhe me deshiren per te informuar dhe marre nje vendim ne Asamble.

Rendi i dites eshte si meposhte:

Asambleja e Zakonshme

1. Raport i aktivitetit te shoqerise per vitet 1998 dhe 1999 – pergatitur nga drejtoria.



- 
2. Raport i ekspertit kontabel mbi kontrollin e aktivitetit te shoqerise per vitet 1998 dhe 1999.
 3. Raport i aktivitetit te shoqerise per vitet 1998 dhe 1999 – pergatitur nga Keshilli Mbikqyres.
 4. Diskutimi dhe miratimi i bilanceve te shoqerise per vitet 1998 dhe 1999
 5. Relacion per punen e kryer ne drejtim te investimeve – pergatitur nga drejtoria.
 6. Zgjedhja e Keshillit te ri Mbikqyres dhe Ekspertit Kontabel per vitin 2000.
 7. Te ndryshme.

Asambleja e Jashtezakonshme

1. Propozimi per zvogelimin e kapitalit dhe ndarjen e dividendit.

Pika 1 dhe 5 e rendit te dites

Z. Vasil Dhono – Drejtor Ekzekutiv I Refraktare sh.a.

Raporton mbi punen e kryer dhe rezultatet financiare per vitin 1998 dhe 1999 e ne vazhdim. (Shih raportin e Drejtorise te Refraktare sh.a.)

Pika 2 e rendit te dites

Z. Eduart Kila – Ekspert Kontabel

Raporton mbi ekspertizen kontabel te vitit 1998 dhe 1999. (Shih raportin e Ekspertit Kontabel)

Pika 3 e rendit te dites

Z. Edmond Karafili – Kryetari I Keshillit Mbikqyres


Raporton mbi punen e kryer nga Keshilli Mbikqyres I Refraktare sh.a. (Shih raportin e Keshillit Mbikqyres te Refraktare sh.a.)


Pika e 4 e rendit te dites.

Pas raporteve nga Drejtoria, Keshilli Mbikqyres dhe Eksperti Kontabel, u kalua ne pyetje pergjigje. Pyetjet ishin si me poshte:

Z. Fuat Banja:


1. Lidhur me investimet: Sa ka qene vlera e investimeve te autorizuar nga Asambleja ne mbledhjen e saj te vitit 1997?
2. Pse nuk eshte bere mbledhja e aksionereve per vitin 1998?



- 
3. Sa eshte norma e fitimit per shoqerine. Sa ka qene fitimi per vitet 1998, 1999?
Sa ishte menduar nga Keshilli Mbikqyres dividenti per keto vite?
 4. Sa valute ka sot shoqeria?
 5. Sa eshte perqindja e pagave ne shpenzime, pasi shohim qe eshte afersisht sa fondi i amortizimit?
 6. Sa eshte perqindja e pagave te administrates ne raport me totalin? Sa shpenzon administrata per qellimet e saj si nafte etj?
 7. Sa eshte vlera totale e investimit per tjegullen ktu?
 8. Per shkeljet qe degjova ne ekspertizen kontabel: sa eshte vlera ne leke dhe cilet jane personat pergjegjes?
 9. Cili eshte raporti i Ekspertit Kontabel per vitin 1998?
 10. Nqs nuk eshte bere matja e lendes se pare ne fund te vitit, a eshte i pranueshem bilanci kontabel?
 11. A ka te drejte shoqeria te beje sponsorizime per spektakle te ndryshem?

Z. Skender Kovaci:

1. Raportohet ne vitin 1998 se fitimi i gjashtemujorit te pare ishte i barabarte me fitimin e vitit 1997, gje qe nuk rezulton keshtu nga bilancet e paraqitur. Pse ka mosperputhje?
2. A mund te na sqaruni lidhur me shkeljet e mundshme te bere ne shoqeri?
3. Si mund te mbyllet nje bilanc pa mbajtur konsumet?
4. Si mund te behen shpenzime te konsiderueshme per administraten pa pyetur aksioneret?
5. Sqarime lidhur me mbledhjen e aksionereve per vitin 1998.
6. Kush i vendos pagat e administrates?
7. Pse disa objekte ne shoqeri jane pa perdorim? Pse te mos i veme ne ne shfrytezim ato?
8. Sygjeron te rishikohet statusi i shoqerise.
9. Te lexohet akti i themelimit te shoqerise.



Z. Fatmir Xhaferri

1. Mund te na sqaroni per perberjen dhe cilin perfaqeson komisioni i prokurimit te blerjeve?

2. Nje sqarim lidhur me analizat qe i jane bere argjilave lidhur me prodhimin e tjegullave.

Z. Petrit Pepa

1. Sa eshte prodhimi ditor ne repartin e formimit?

Z. Shemsi Gucaj

1. Kam po ato pyetje te parafollesve.

Z. Arben Feratozi

1. A ka pasur interesa te bankes per leket e lena aty?
2. Sa jane shpenzimet e bera lidhur me investimin per linjen e tjegullave dhe a jane ato te dokumentuara me fatura perkatese?

Z. Sabaudin Çerma

1. Raportet kane dicka qe nuk shkon: Drejtoria dhe Keshilli Mbikqyres flasin per mire, kurse Eksperti Kontabel konstaton parregullsi.
2. A ka hile ne blerje?
3. Pas mbledhjes se vitit 1997, kemi depozituar leke per investime. Interesat per keto leke a jane futur ne aksione apo jo.
4. Keshilli Mbikqyres a konstaton anomali dhe a mban qendrim per personat pergjegjes?

Z. Nikolla Nosi

1. Per mjedise e pashfrytezuara: a ka politika per shfrytezimin e tyre?
2. Amortizimi i llogaritur eshte shume i madh. Cili eshte efekti i tij ne bilanc?
Ku eshte destinuar ai?



Pergjigjet per pyetjet e bera ishin si me poshte:

Per Z. Fuat Banja:

Pergjigje nga Keshilli Mbikqyres

1. Nuk ka pasur shifer te percaktuar me vendim te asamblese per investime, por vetem eshte autorizuar Keshilli Mbikqyres per ndjekjen e tyre. Normalisht nuk mund te kishte percaktim ne kete drejtim pa pasur oferta perkatese.

Pergjigje nga Keshilli Mbikqyres

2. Aresyeja jone per moszhvillimin e mbledhjes se aksionereve per vitin 1998 ishte vetem se ishim ne proces per vleresimin e investimit. Menduam te diskutonim edhe kete, si nje problem me rendesi te madhe per shoqerine. Pritem qe te konkludonim me pare vete, pastaj ta fusnim per diskutim ne mbledhjen e aksionereve.

Pergjigje nga Drejtori Ekzekutiv

3. Fitimi i vitit 1998 ishte 13.325 mije leke, kruse fitimi i vitit 1999 eshte 18.173 mije leke. Fitimet jane ne kete mase per arsye te politikese se ndjekur nga ana jone ne interes te shoqerise. Kjo ka cuar ne rritjen e gjendjes financiare te shoqerise. Nuk ka pasur paramendim per caktimin e fitimit te ketyre viteve, per arsye se eshte asambleja e aksionereve ajo qe do te vendose per kete problem.

Pergjigje nga Drejtori Ekzekutiv

4. Ne periudhen ku shoqeria zoterohej nga shteti si pronar, ishin rreth 44 mije \$ ne llogari te saj, por keto para ne pjesen me te madhe te tyre u moren me iniciative nga Dega e Tatim Taksave Elbasan per shlyerjen e detyrimeve fiskale te prapambetura. Per 13 mije \$ eshte blere makina prerese e tullave dhe pjesa e mbetur eshte konvertuar ne banke ne leke, per vazhdimin e aktivitetit te Shoqerise. Prodhimi i Shoqerise eshte rritur vazhdimisht, nga 10800 cope tulla format normal ne momentin e privatizimit, ne 65000-70000 cope tulla format normal sot, duke arritur nje gjendje financiar prej 140 milion leke.

Pergjigje nga Drejtori Ekzekutiv

5. Shpenzimet per paga jane 17.466 mije leke, per trajtim te personelit punonjes jane 13.142 mije leke dhe per sigurimet shoqerore jane 5.400 mije leke.

Shpenzimet jane konform struktures organizative te miratuar nga kjo asamble.
Amortizimi i llogaritur per vitin 1999 eshte 28.400 mije leke.

Pergjigje nga **Drejtori Ekzekutiv**

6. Perqindja e pagave te administrates ne total eshte rreth 24% te fondit te pagave gjithsej. Ajo shpenzon rreth 0,1% te gjithe shpenzimeve te Shoqerise.

Pergjigje nga **Keshilli Mbikqyres**

7. Vlera totale e investimit per tjegullen me ofertat qe disponojme shkon afersisht 3,5-4 milion \$. Per kete eshte hartuar plan biznesi i rregullt.

Pergjigje nga **Eksperti Kontabel**

8. Nuk ka shkelje kundrejt kuadrit ligjor. Ekspertiza eshte bere mbeshtetur ne parimet nderkombetare per funksionimin e shoqerive tregtare, gje qe nuk mund te vije gjithmone pershtat realitetit shqiptar. Psh ne raportin e Ekspertit Kontabel thuhet se jo gjithmone blerjet shoqerohen me fatura te rregullta tatimore (me tvsh). Kete e kerkojne normat nderkombetare, por perderisa ne Shqiperi mund te besh edhe fatura te tjera te rregullta jasht ketyre normave, fatura te njohura ne kuadrin ligjor, atehere nuk mund te thuhet se ketu ka shkelje te ligjit. Problemi eshte qe te shkohet sa me teper drejt eliminimit te ketyre faturave.

Pergjigje nga **Eksperti Kontabel**

9. Raporti i vitit 1998 mund te lexohet nga eksperti kontabel, por kjo gje nuk konsiderohet e nevojshme nga ana e aksionereve. Eksperti kontabel i komunikon atyre gjerat me thelbesore te ketij raporti.

Pergjigje nga **Eksperti Kontabel**

10. Lenda e pare - argjila eshte matur e dokumentuar gjate te gjith vitit ne aspektin e blerjeve dhe shpenzimeve. Por ketu behet fjale per inventarin e fundit te vitit, e cila behet me topograf, i cili kerkon kushte per matje, te cilat objektivisht nuk jane te disponueshme nga shoqeria. Meqenese lenda e pare ze nje perqindje te vogel ne shpenzime (2-3%), bilancin e konsideroj te pranueshem.

Pergjigje nga Pergjigje nga Eksperti Kontabel

11. Nuk ka pasur asnje sponsorizim te cfaredo natyre qofte nga ana e shoqerise. Lajmi i dhene ne televizionin lokal eshte i rreme. Kjo gje vertetohet nga Eksperti Kontabel. i cili ka kryer kontroll me objektiv per kete problem.

Per Z. Skender Kovaci:

Pergjigje nga Drejtori Ekzekutiv

1. Ne mbledhjen e aksionereve te vitit 1997, eshte thene se ne tetor 1998, fitimi i ketij viti do te barazonte fitimin e vitit 1997, gje e cila eshte realitet.
2. Pergjigja lidhur me shkeljet e mundshme ne shoqeri eshte dhene me siper.
3. Po ashtu edhe pergjigja lidhur me matjen e lendes se pare gjendje ne fund te vitit.

Pergjigje nga Keshilli Mbikqyres

4. Nomenklature, sipas statusit te shoqerise, eshte e Keshillit Mbikqyres. Eshte pare e arsyeshme kryerja e shpenzimeve ne objekt, pasi kerkohet rritja e cilesise se punes nga personeli punonjes dhe prezantim me i mire ndaj te treteve si element i marketingut. Per analogji do te thonim se konkurentet tane kane ambjente shume me te mira se keto tonat.
5. Per mbledhjen e vitit 1998 eshte dhene pergjigje me pare.

Pergjigje nga Keshilli Mbikqyres

6. Pagat vendosen sipas statusit te miratuar ne asamble.

Pergjigje nga Keshilli Mbikqyres

7. Nuk eshte vepruar, pasi nuk ka pasur kerkesa serioze per dhenie me qira dhe duke gjykuar per investimin per linjen e tjegulles na eshte dashur te mos e nxisim kete gje. Megjithate, mendimi i shprehure qendron. Do ta shohim ne te ardhmen kundrejt interesave ekonomike te shoqerise dhe propozimet konkrete te aksionereve. Jeni te mirepritur per mendimet qe keni ne cdo kohe.

Pergjigje nga Keshilli Mbikqyres

8. Per statusin, cdonjeri eshte i lire te beje verejtjet me shkrimdhe t'i paraqese ne asamble per diskutim. Kundrejt mendimeve, mund te behen ndryshime sipas ligjit.

Pergjigje nga Keshilli Mbikqyres

9. Akti i themelimit te shoqerise eshte i disponueshem per cdo moment prane drejtorise se shoqerise, kush te doje mund te vije ta lexoje.

Per Z. Fatmir Xhaferri:

Pergjigje nga Drejtori Ekzekutiv

1. Komisioni i prokurimit percaktohet nga drejtoria e shoqerise, i aprovuar nga Keshilli Mbikqyres. Funkcionon ne interesa te shoqerise.

Pergjigje nga Keshilli Mbikqyres

2. Lidhur me analizat per argjilen, ato jane bere nga disa laboratore te specializuar ne Austri e Gjermani, jane bere edhe prova industriale ketu dhe ne Itali dhe ka rezultuar me probleme te ndryshme persa i perket gelqeroreve pjesemarres ne te ose plasticitetit. Mendojme qe me kerkime te reja si psh per varferues te gjejmë nje zgjidhje te pershtatshme per kete problem. Puna eshte ne vazhdimesi.

Per Z. Petrit Pepa:

Pergjigje nga Drejtori Ekzekutiv

1. Prodhimi ne formim per 24 ore eshte 11 mije cope tulla SAP, ose 24 mije cope tulla 8B.

Per Z. Arben Feratozi:

Pergjigje nga Drejtori Ekzekutiv

1. Leket e viti 1998 jane ne banke, totali i gjendjes, sot 31.05.200, se shoqerise eshte rreth 140 milion leke, i teri i disponueshem. Per vitin 1999 kemi rreth 4 milion leke interesa te fituara nga llogaria jone.

Pergjigje nga Drejtori Ekzekutiv

2. Shpenzimet per tjegulla jane te gjitha te dokumentuara, per to ka fatura te rregullta. Te interesuarit jane mirepritur per te verifikuar shpenzimet konform ligjeve.

Per Z. Sabaudin Çerma:

Pergjigje nga Eksperti Kontabel

1. Nuk ka shkelje ligjore per asnje problem te trajtuar, por sygjerimi im eshte per nje funksionim me te mire te shoqerise, bazuar ne normat nderkombetare.
2. Pyetjet e tjera te bera jane te ezauruara me pare.

Per Z. Nikolla Nosi

Pergjigje nga Eksperti Kontabel

1. Pyetja ne lidhje me mjediset e pashfrytezuara eshte ezauruar me pare.
2. Amortizimi i llogaritur, ne pjesen me te madhe te tij eshte shnderruar ne mjete monetare ne llogarine e shoqerise, nje pjese e vogel e tij eshte shnderruar ne aktive te trupezuara dhe mjete qarkulluese. Ne keto drejtime eshte shtrire edhe efekti i amortizimit te llogaritur ne bilanc.

Pas pergjigjeve te pyetjeve te bera nga aksioneret filloi diskutimi.

Z. Fuat Banja

Nga pergjigjet e pyetjeve nuk degjova pergjigjen e dy pyetjeve te mia. Ndoshta eshte bere me qellim ose sekretari nuk po e mban te rregullt protokollin.

Z. Elton Mersini

Per cilat pyetje e ke tjalten

Z. Fuat Banja

Per pyetjet 2 dhe 10.

Z. Elton Mersini

Mund ti shikosh nese jane mbajtur shenim ose jo.

Z. Fuat Banja

Propozoj qe te shenohet ne protokoll, qe ju nuk jeni i rregullt.

Z. Elton Mersini

Dakort.

Z. Fuat Banja

Pyetjet jane : Kush eshte pergjegjes per mos zhvillimin e mbledhjes te vitit 1998?, Sa eshte kostoja e nje tulle dhe sa eshte cmimi i shitjes?, Sa % jane shpenzimet e administrates dhe vecanerisht sa karburant shpenzohet ne muaj per makinen e Drejtorit Ekzekutiv ?. Mospergjigja ndaj ketyre pyetjeve per mua jane te qellimshme.

Z. Vasil Dhono

I jam pergjigjur ketyre pyetjeve duke I shprehur ne menyre tjeter. Norma e fitimit eshte 25 % para takses. Cmimi I shitjes nuk mund ta them me sakte si pasi ai ndryshon ne varesi te ndryshimit te lendeve te para. Sot cmimi I shitjes per 8B eshte 27.0 leke/cope me TVSH, dhe 22.5 leke/cope pa TVSH. Kostoja eshte 180 leke/cope. Fitimi $22.5 - 18.0 = 4.5$ leke/cope. Ne muaj harxhoj rreth 200 litra karburant. Shpenzimet e administrates ne zerin paga jane 25% e fondit te pagave. Per kete kontrollohem dhe jap llogari sipas ligjit Keshillit Mbikqyres.

Z. Agron Shaplllo

Pergjegjesia per mosmbledhjen e aksionere eshte imja dhe ju kerkova falje qe ne fillim te mbledhjes.

Z. Fuat Banja

Duhet te mbash pergjegjesi ligjore

Z. Agron Shaplllo

Une do te mbaj pergjegjesine si kryetar i asamblese dhe si aksioneri kryesor i shoqerise.

Z. Sabaudin Cerma

Me falni por se degjova pergjigjen e pyetjes se ku kane qendruar leket e depozituar per investime dhe mosperputhjet midis raportit te drejtorise dhe ekspertit kontabel.

Z. Agron Shaplllo

U tha dhe me perpara ne xhiro llogarine bankare te Shoqerise.

Z. Vasil Dhono

Pyetjes mbi parregullshte iu pergjigj Z. Eduart Kila si ekspert kontabel I autorizuar nga asambleja.

Z. Nazmi Sadushi

Ne lidhje me pyetjet u be diskutim dhe u tha qe harxhohej 120 kg solar ne fillim dhe tani 117 kg. Se kuptoj? Sa eshte sasia e solarit qe konsumohet jo si cmim?

Z. Agron Shaplllo

Eshte 117 kg/1000 FN

Z. Nazmi Sadushi

Me duket absurde, sasia me duket e tepert me deklarimet e viteve me pare (Me perpara me 2 furra ne pune dhe ne 1500°C harxhohej 330 ton.

Mbi investimet, nuk me duket e drejte investimi per tjegulla pa rregulluar me pare linjen e tullave. Pse nuk cohet ajri I ngrohje I furres ne ajerngrohes.

Z. Agron Shaplo

Ideja jote eshte realizuar. Me sa duket nuk keni qene i vemendshem kur u lexua raporti i Drejtorit.

Z. Nazmi Sadushi

Dhe investimi per tjegullen te behet sa me i efekshem

Z. Agron Shaplo

Per kete jam i interesuar une i pari.

Z. Skender Muska

Lavderoj stafin per punen e kryer. Propozoj qe ne Keshillin Mbikqyres te ri te zgjidhet nje njeri nga 38% e te tjereve.

Mbi sponsorizimin si ka mundesi qe nuk eshte bere?!!

Z. Vasil Dhono

Nuk eshte bere sponsorizimi. Per kete keni te drejten sipas ligjit te verifikoni.

Z. Agron Shaplo

S' te kundershton njeri per zgjedhjen e nje njeriu qe te perfaqesoje 38%, te behen propozime per ndryshime ne status.

Z. Skender Kovaci

Per territoret e lira. A mund te bejme dicka ne menyre qe te punesohemi dhe ne?

Z. Agron Shaplo

Kush nuk do te perfitoje nga kjo? Sillni propozimet, planin e biznesit. N.q.s eshte rentabel do te pranohet. Kush ka propozime konkrete ti sjelle. Jemi te hapur dhe momentalisht shpreh kerkesen qe ju te jeni me active me mendime dhe veprime konkrete

Z. Nazmi

Ta kemi te hapur rrugen per kete problem.

Z. Agron Shaplo

Te hapur e keni.

Z. Nazmi

Propozoj qe mbledhjet te behen nje here ne 3 muaj ose 6 muaj dhe jo nje here ne vit.

Z. Yath Qylsheni

Jam dakort me shfrytezimin e siperfaqeve te lira ne ndermarrje.

Si do te rritet rendimenti i fabrikes?

Z. Nikolla Nosi

S'duhet te behen debate me ironi. Pse puna e ajernggrohesit su be meperpara. Duhet qe raportet ti shikonim meperpara. Nga raportet degjuam se koeficienti I shfrytezimit te makinerive eshte 97% Si do te rritet? Per shfrytezimin e siperfaqeve te lira kjo te behet me plan biznesi.

Per amortizimin. Meqenese jane 1 milion dollare s'do te ishte me mire se te liheshin ne logarine bankare me 2%, te investoheshin ne rruge te tjera. Pra keto para te investoheshin me mire. Kjo eshte nje verejtje per Keshillin Mbikqyres.

Mendim tjeter per perfaqesimin e 38 % . Cili do te jete personi? Ne jemi 4 veta ketu dhe kemi afro 15% te aksioneve por jemi te papergatitur per kete.

Z. Maksim Tabaku

Pse nuk vihet ne pune furra tjeter? Pse bllokohet leku dhe jo te mos investohet per rritjen e prodhimit? Pergjegjesi ka financa.

Eksperti kontabel duhet te jete me I sakte dhe I rrepte. Duhet qe analiza te jete 6 mujore.

Nga investimi te rritet dhe punesimi.

Z. Skender Kovaci

Z. Eduart Kila duhet te ishte me kerkuces.

Ne drejtim te siperfaqeve te lira te merret Keshilli Mbikqyres dhe jo drejtuesit e shoqerise.

Eshte nje pike tek statusi ku mandati i administrates eshte 4-6 vjet. S'kemi besim tek administrata, duhet te nderrohet.

Per mosrealizimin e asamblese ne vitin 1998 me con ne humbjen e besimit tek Keshillit Mbikqyres dhe administrata.

Z. Ilia Cullhai

Duke pare konkurrencen duhet te shikojme sesa duhet te investojme qe te mos falimentojme.

Une kam qene disa here ne ndermarrje dhe shikoj se punohet prandaj n.q.s shikohet e nevojshme nje shperblim per punetoret pasi nga ata fitojme edhe ne.

Naim Ramollari (pergjegjes reparti)

Duhet te behet dicka per te zbutur konkurrencen.

Ka me teper se 3 muaj qe ka fluks punetoresh te madh qe lidhet me kerkesat per pagat.

Cdo te bejme per vitin e ardhshem qe punetoret te lidhen me shume me punen duke pare pagat?

Z. Agron Shaplo

Keni nje shqetesim per pagat

Z. Naim Ramollari

Duhet te shikohet per vitin 2001 kjo gje.

Cdo te bejme per motivimin e punetoreve per ti lidhur ata me mire me prodhimin si dhe kjo te behet duke patur parasysh edhe inflacionin.

Z. Stavri Ranxha

Administrata duhet te ndryshoje sepse specialistet e mire kane ikur. Keshilli Mbikqyres duhet te degjoje keto per te vene dore ne administrate duke mbajtur ne administrate njerez te nenshtruar.

Jemi dakort me parafolesit per siperfaqet e lira.

Cdo 6 muaj te behet nje kontroll pasi administrata vihet ne kontroll.

Z. Sabaudin Cerma

Lavderoj stafin per pune te mire

Per problemet e tjera s'jam dakort. Nga administrata ka shkelje ligji. Investimet duhet te jene transparente dhe per tjegullen te merret kredi.

S'jam dakort qe presformat te blihen jashte vendit.

Po ju informoj se dhe ne Kucove po hapet nje fabrike tullash.

Rregullorja duhet te rishikohet, te ndryshoje duke u ndihmuar dhe nga aksioneret e tjere.

Investimet ne administrate jane te teperta dhe Keshilli Mbikqyres duhet ti ndaloje.

Kontrollet te behen me te shpeshta

S'jam dakort qe furra me tulla dinaz te riparohet.

S'I ta kuptojme amortizimin?

Z. Agron Shaplo I sqaron se c'eshte amortizimi.

Z. Sabaudin Cerma

Duhet te ndryshoje rregullorja per blerjen e mallrave per te shmangur abuzimet

Ne lidhje me karburantin me sa eshte blere. Raporti duhet te jete me i thjeshte per tu kuptuar. Perpara se te behet zgjedhja e stafit drejtues duhet te ndryshoje rregullorja.

Fuat Banja

Jam verejtje mbi raportin e Keshillit Mbikqyres I cili ishte me fjale te bukura por nga diskutimet doli e kunderta. Kritikoj Z. Edmond Karafilin si specialist

Verejtja e dyte per Keshillin Mbikqyres eshte largimi I specialisteve nga Refraktare sh.a.

Keshilli Mbikqyres nuk na tregoi shifrat e vitit 1997. N.q.s kjo vlere eshte e vertete duhet te konvertohet ne aksione. Ky Keshill Mbikqyres ka dy pale interesa, si aksioner dhe si pale tregtuese.

Kemi informacion qe GSA ble tulla nga Refraktare sh.a..

Raporti Ekonomik

Duhet te dalin qarte bilanci I vitit 98, 99. Dote votoj kunder dhe I bej thirrje dhe te jereve.

N.q.s. do te ndahen dividendet e vitit 1998 e akuzoj Keshillin Mbikqyres se ka abuzuar me dividendin tim

S'kam besim ne administraten e Refraktare sh.a.

Z. Petrit Pepa

Nuk ke te drejte te marresh vendim n.q.s s'ka 75 % te votave.

Z. Njazi Qemali

Mendoj te kalojme ne piken 1 te rendit te dites te Asamblese se Jashtezakonshme

Z. Nikolla Nosi

Hedhim ne vote piken 4 te rendit te dites te Asamblese se Zakonshme.

Nis procesi I votimit

Z. Agron Shaplllo

- Hidhet ne votim pika 4 e rendit te dites te Asamblese se Zakonshme.

Miratohen me unanimitet votash.

Z. Agron Shaplllo

Ne kete mbledhje u kerkua qe te behen ndryshime ne status, sic eshte edhe zgjerimi i Keshillit Mbikqyres me nje anetar te ri. Meqenese nje propozim i tille u be gjate mbledhjes dhe aksioneret jane jo te parapergatitur per kete problem, propozoj qe ne nje mbledhje tjeter te aksionereve (deri atehere propozimet e aksionereve per ndryshime duhet te depozitohen ne Drejtorine e Shoqerise) te diskutojme dhe te vendosim ne lidhje

me: ndryshimet ne statutin e Shoqerise, zgjedhjen e Keshillit Mbikqyres, zgjedhjen e

Ekspertit Kontabel, zgjedhjen e Sekretarit te Asamblese se Aksionereve.

Propozimi i mesiperm hidhet ne vote dhe miratohet me unanimitet.

Mbi ndarje dividenti

Ne kete pike u shpjegua se si rezultat i veprimtarise se saj (humbje te mbartura, fitim i realizuar, ndarje dividenti), "Refraktare sha" ka disponibel per ndarje vetem 6.8 milion leke. Aksioneret ishin te nje mendimi, per te mos proceduar per ndarje dividenti per kete vit.

Mbi zvogelimin e kapitalit

Ne kete pike e merre fjalen Eksperti Kontabel i Shoqerise Z. Eduart Kila, i cili tha se Keshilli Mbikqyres me shkresen e tij te dates 1 Prill 2000, ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992, nenseksioni i dyte – zvogelimi i kapitalit, neni 164, ka kerkuar vleresimin perkates per terheqje (shlyerje) te pjeses se kapitalit per 110 milion leke. Me pas ai lexon raportin qe ka hartuar mbi bazen e kesaj kerkese, sipas te cilit kerkesa eshte e rregullt, mbeshtetur ne ligj dhe i mbetet Asamblese se Jashtezakonshme per te votuar.

Hidhet ne votim dhe miratohet me 84.28% vota pro dhe 0.19% vota kunder.

Pas procedures se votimit, miratohet zvogelimi i kapitalit ne nivelin e siperpermendur me 84,28% vota pro dhe 0,19% vota kunder.

Vlora e nje aksioni dhe perqindja e aksioneve ne Shoqeri mbeten te pandryshuar. Nga zvogelimi i kapitalit me 110 milion leke do te zvogelohet numri i aksioneve per cdo aksioner kundrejt numrit te aksioneve qe perfaqeson kjo vlere dhe perqindjes qe ka cdo aksioner.

Ne perfundim te mbledhjes ngarkohet Drejtoria te mbaroje procedurat ligjore dhe te merret me njoftimin e aksionereve.

Sekretari i Asamblese se Aksionereve Refraktare sh.a.

Ilton Mersini

Kryetari i Asamblese se Aksionereve Refraktare sh.a

Agron Shaplllo





“REFRAKTARE Sh.a.”
ZONA INDUSTRIALE ELBASAN
ALBANIA

Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 53
 (E - Mail) : refraktare@sanx.net

Nr. 52-1..... Prot.
 Date, 06.08.2001

LENDA:

KËRKESE

20
 per Depozitim ne Regjistrin Tregetar te
Vendimeve te Mbledhjes se Jashtezakonshme Nr. 3, date 27.07.2001
te Asamblese te Shoqerise “Refraktare” sh.a. Elbasan.

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

20
 Shoqeria anonime Refraktare sh.a. Elbasan eshte regjistruar prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendim Nr. 11803, date 10.08. 1995.

20
 Asambleja e sh.a. Refraktare Elbasan ne mbledhjen e saj te jashtezakonshme Nr. 3, date 27.07.2001 vendosi:

20
 1. Te beje ndryshimet ne statut si me poshte:

20
 Neni 5/1

1- Mbledhjet e Asamblese te aksionereve mbahen ne seline e shoqerise ose ne vendin e percaktuar ne thirrje.

4- Thirrja e Asamblese se aksionereve behet me ane te njoftimit qe i dergohet çdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi kryhet 15 dite perpara mbledhjes, dhe duhet te permbaje:
 ditën, orën, vendin e mbledhjes, natyrën e asamblese dhe rendin e dites.



Neni 6

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 4 anetare.

Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte sipas ligjit (6 vjet) ku çdo vit shtrihet midis asamblese te pergjithshme vjetore te njespasnjeshme.

Kerkojme nga ana e gjykates Tuaj te behen depozitimet perkatese prane zyres se Regjistrimit Tregetar

Bashkelidhur kesaj kerkese eshte:

Procesverbali i Mbledhjes te Jashtezakonshme Nr. 3 te Asamblese

Dt.27.07.2001 te shoqerise Refraktare sh.a. Elbasan.

Drejtori

Vasil Dhono



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN

Nr. 6367 rep.

Elbasan me 10.09.2001

V Ë R T E T I M


Në Elbasan, sot me datë 10.09.2001(dhjetë shtator dymijë e një), në prezencën e noterit Pëllumb Barçi, me zyrë pranë gjykatës së shkallës së parë të rrethit gjyqësor Elbasan, u paraqit personalisht :

z. **Vasil DHONO**, i njohur prej meje personalisht, me cilësinë e drejtorit ekzekutiv të Shoqërisë "REFRAKTARE SH.A" i cili më konfirmoi përmbajtjen e vendimit të Mbledhjes të Jashtëzakonshme të Asamblesë Nr. 3 datë 27.07.2001 (ndryshimet në statut }, si dhe legalizimin përkatës

Vertetohet firma nga noteri


Noter

Pëllumb **BARÇI**



PROÇES VERBAL
I MBLEDHJES SE JASHTEZAKONSHME TE ASAMBLESE SE AKSIONEREVE
TE "REFRAKTARE SH.A."

25 JANAR 2002

- 
- Kryetari i Asamblese se Aksionereve Z. Agron Shaplo njofton per rendin e dites
 - Sekretaria numuron aksionet qe rezultojne 70 % te aksioneve dhe ne baze te ligjit deklarone hapjen e mbledhjes.
 - Kryetari i Asamblese njofton prezencen ne mbledhje te Noterit dhe te Ekspertit Kontabel.
 - Kalohet ne piken e pare te rendit te dites. **"Informacion mbi investimin"**

- **Edmond Karafili Kryetar i Keshillit Mbikqyres** lexon raportin e Keshillit Mbikqyres i cili dorezohet ne sekretarine e mbledhjes.

- **Edmond Karafili Kryetar i Keshillit Mbikqyres:**

Lexohet informacioni mbi ecurine e investimit. Materiali i investimit eshte depozituar ne "Refraktare sh.a."

Behet e qarte qe burimet e investimit do te jene nepermjet kredise bankare, gjendjes aktuale monetare ne llogarine e Refraktare sh.a., te ardhurat qe do te sigurohen nga "Refraktare sh.a." ne linjen egzistuese gjate periudhes se kryerjes se investimit. Vlefte e investimit llogaritet paraprakisht ne 3,5 milion EURO. Ne rast se vlefte reale e investimit do te kaloje vleren qe do te sigurohet nga burimet e mesiperme te financimit, atehere aksioneret, ne baze te perqindjes se aksioneve qe kane ne shoqeri mund te kontribuojne per shtesen monetare qe mund te kerkohet per perfundimin e investimit. Eshte e qarte qe kjo mund te ndodhe ne rastin kur nga bankat qe do tu kerkohet nje kredi shtese do te kete nje pergjigje negative.

- **Z. Agron Shaplo – Kryetar i Asamblese:**

- Aresye per te cilen ne bejme kete mbledhje eshte ndryshimi i numrit te anetareve ne Keshillin Mbikqyres.
- Procedurat me banken per marrjen e kredise kerkojne depozitim ne gjykate te vendimeve te Asamblese per perberjen e Keshillit Mbikqyres.

- Nga mbledhja e kaluar u vendos qe Keshilli Mbikqyres te perbehej nga 4 anetare. Gjykata nuk beri depozitim ne gjykate e ketij vendimi pasi ligji kerkon qe Keshilli Mbikqyres te perbehet nga 3 – 21 anetare, por gjithmone ky numer te jete



shumefish i treshit. Ne keto kushte ne jemi te detyruar qe te zbatojme ligjin dhe konkretisht une mendoj qe numri i anetareve te Keshillit Mbikqyres te behet perseri 3 anetare siç ka qene me pare.

- Kredia eshte e nevojshme per te perballuar investimin i cili ne kushtet e konkurrences do te beje te mundur qenjen prezente ne treg te shoqerise ne asortimente dhe ne cilesi.

Kalojme ne pyetje:

- **Hasan Kajanaku, anetar:** Neve na intereson investimi qe do te behet, por une shtroj pyetjen qe ky investim do te behet vetem per tulla?

- **Z. Agron Shaplo – Kryetar i Asamblese:** Me linjen e re do te prodhohen te gjitha llojet e tullave qe do te kerkoje tregu sipas asortimentit dhe cilesise. Makinerite dhe pajisjet qe do te importohen jane prodhim i viteve 1995-1998. Plani eshte qe ky investim te realizohet per 1 – 1,5 vjet. Nderkohe edhe linja e vjeter do te funksionoje normalisht ne vazhdimesi edhe pas investimit.

Kalojme ne piken e dyte te rendit te dites “ **Per miratimin e numrit te anetareve te Keshillit Mbikqyres**”.

Ne mendojme qe numrin e tij ta leme siç ka qene me pare ne tre anetare. Kam nje propozim personal qe te tre personat e pare te ngelen si anetare i K.Mbikqyres.

Nese keni ndonje propozim tjeter mund ta sugjeroni.

Propozime te tjera nuk ka, prandaj le ta hedhim ne vote!

Kalohet ne proceduren e votimit dhe ne baze te rezultatit te votimit del se 70% te aksioneve votoi qe ne perberje te Keshillit Mbikqyres te jene:

- 1- Edmond Karafili – Kryetar
- 2- Agron Shaplo – anetar
- 3- Edmond Tafa – anetar

Z. Agron Shaplo – Kryetar i Asamblese: Duke Ju falenderuar per pjesemarrjen, Mbledhjen e Jashtezakonshme te Asamblese se Aksionereve te “Refraktare sh.a” e deklaroj te mbyllur.


Kryetari i Asamblese

Agron Shaplo



Sekretari i Mbledhjes

Edi Stafa





V È R T E T I M

Në Elbasan, sot me datë 26.01.2002(njezet e gjashte janar dymijë e dy), une i nenshkruari Pëllumb Barçi, me cilesine e noterit, vertetoj nenshkrimin e proces verbalit te mbledhjes se jashtezakonshme se aksionereve te shoqerise "REFRAKTARE" SH.A. Elbasan, nga z.AGRON SHAPLLO dhe z. EDI STAFJA, mbajtur ne Elbasan me date 25.01.2002, mbledhje ne te cilen kam qene personalisht prezent.



Noter

Pëllumb BARÇI



REFRAKTARE sh.a. Elbasan
Nr. 08/A.i Prot.
Date, 25.01.02



V E N D I M

i Mbledhjes se Asamblese se aksionereve te shoqerise

Refraktare sh.a. Elbasan date 25.01.2002

Si perfundim Asamblea e Aksionereve te shoqerise Refraktare sh.a., e mbledhur me date 25.01.02 vendosi:

1. Te ndryshohet numuri i anetareve te Keshillit Mbikqyres nga 4 anetare ne 3 anetare.
2. Ne baze te rezultatit te votimit 70% e aksioneve, votuan qe ne Keshillin Mbikqyres te jene:
 - Edmond Karafili Kryetar
 - Agron Shaplo Anetar
 - Edmond Tafa Anetar

Kryetari i Asamblese
AGRON SHAPLLO

Sekretari
EDI STAFA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN

Nr. 311 rep.

Elbasan me 26.01.2002




V Ë R T E T I M

Në Elbasan, sot me datë 26.01.2002(njzet e gjashte janar dymijë e dy),
une i nenshkruari Pëllumb Barçi, me cilesine e noterit, vertetoj nenshkrimin e
vendimit te mbledhjes se Asamblese se Aksionereve te shoqerise
"REFRAKTARE" SH.A. Elbasan, mbajtur ne Elbasan me date 25.01.2002, nga
z.AGRON SHAPLLO dhe z. EDI STAFJA, mbledhje ne te cilen kam qene
personalisht prezent.

Noter

Pëllumb BARÇI





“REFRAKTARE Sh.a.”

**ZONA INDUSTRIALE ELBASAN
ALBANIA**

Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 53

(E-Mail) : refraktare@sanx.net



KESHILLI MBIKQYRES

Nr. 09/A Prot.
Date, 25.01.02

V E N D I M N R. 1/V-02

Keshilli Mbikqyres i Refraktare sh.a. sot me date 25.01.02. vendosi qe
Drejtoria e Refraktare sh.a. te perbehet si me poshte:

- 1) VASIL DHONO.....Drejtor Ekzekutiv
- 2) EDI STAFI.....Drejtor Ekonomik
- 3) BESNIK ABDIAJ.....Drejtor Prodhimi

Pagat mujore mbeten ato qe kane qene me pare.

Periudha e veprimtarise se kesaj drejtorie do te jete ne perputhje me Statutin e shoqerise.

Vendimi hyn ne fuqi menjehere.

Per Keshillin Mbikqyres

Edmond Karafili – Kryetar

Agron Shaplllo – anetar


Edmond Tafa – anetar

V È R T E T I M

Në Elbasan, sot me datë 26.01.2002(njezet e gjashte janar dymijë e dy),
une i nenshkruari Pëllumb Barçi, me cilesine e noterit, vertetoj nenshkrimin e
vendimit nr.1/V-02 te Keshillit Mbikqyres i "Refrektare" Sh.a. Elbasan, marre ne
mbledhjen e Asamblese se Aksionereve te shoqerise "REFRAKTARE" SH.A.
Elbasan, mbajtur ne Elbasan me date 25.01.2002, nga z. **EDMOND KARAFIL/**
AGRON SHAPLLO dhe z. **EDMOND TAF**A, mbledhje ne te cilen kam qene
personalisht prezent.

Noter

Pëllumb BARÇI



11.803/3
12.02.02



"REFRAKTARE Sh.a."
ZONA INDUSTRIALE ELBASAN
ALBANIA

Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 53
(E - Mail) : refraktare@sanx.net

Ë E Bazo
30.01.2002
[Signature]

Nr. 07/A Prot.
Date, 25.01.02



LENDA:

KERKESË

per Depozitim ne Regjistrin Tregetar te

Vendimeve te Asamblese te Aksionereve te Shoqerise

"Refraktare" sh.a. Elbasan te dates 23.01.2002

**GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE**

Shoqeria anonime Refraktare sh.a. Elbasan eshte regjistruar prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendim Nr. 11803 date 10.08. 1995 kerkon te depozitoje ne Regjistrin Tregetar vendimin e kesaj Asambleje si vijon:

1. Te ndryshohet numuri i anetareve te Keshillit Mbikqyres nga 4 anetare ne 3 anetare.
2. Ne baze te rezultatit te votimit 70% e aksioneve, votuan qe ne Keshillin Mbikqyres te jene:


- Edmond Karafili **Kryetar**
- Agron Shapilo **Anetar**
- Edmond Tafa **Anetar**

Drejtori

Vasil Dhono



[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN

Nr. 311 rep.


Elbasan me 26.01.2002

V Ë R T E T I M

Në Elbasan, sot me datë 26.01.2002 (njetzet e gjashte janar dymijë e dy), une i nenshkruari Pëllumb Barçi, me cilesine e noterit, vertetoj nenshkrimin e kerkeses per depozitim ne regjistrin tregtar te Vendimeve te Asamblese te Aksionereve te Shoqerise "REFRAKTARE" SH.A. Elbasan, drejtuar Gjykates se Rrethit Tirane, date 25.01.2002, nga z. **VASIL DHONO**.

Noter

Pëllumb **BARÇI**



REPUBLICA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr.4183.....Rep.
Nr.281.....Kol.

VERTETIM


Sot, me date 13.12.2004 (Dy mijë e katër) para meje noteres Pranvera Karafili, ne zyren e Noterise me seli rruga "Myslym Shyri", Pall.46/1 Tirane u paraqitën personalisht para meje:


Eduart KILA, i biri i Myrtezait, lindur në Elbasan, më 01.07.1950, banues ne Lagjia "5 Maji", pallati 500/2, Elbasan, i identifikuar me numer leternjoftimi QF 315242, madhorë me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili konfirmoi nenshkrimin e tij ne Raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar Lidhur me Vleresimin e Rritjes se Kapitalit te Shoqerise Anonime "**REFRAKTARE**" sh.a. si me siper me vullnetin e tij te lire e te pavesuar dhe une noterja pasi u binda per shprehjen e vullnetit te tij e vertetova ate sipas ligjit.

NOTER

Pranvera Karafili

[Signature]






"REFRAKTARE Sh.a."

**ZONA INDUSTRIALE ELBASAN⁴
ALBANIA**

**Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 53
(E - Mail) : refraktare@sanx.net**

S. Arjanne Colo
28.11.2000
MENTOR 2005
[Signature]



KËRKESË
PER DEPOZITIMIN E DOKUMENTAVE TE SHOQERISE ANONIME
"REFRAKTARE" SH.A. VENDIMI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS 01.11.2005

KËRKUES: Edi Stafa, i biri i Fiqiret, i lindur me 11.12.1969, ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, Lagjia "28 nentori" rruga "Abdyl Frashri Nr.28" me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv i shoqerise anonime "REFRAKTARE" sh.a

OBJEKTI: Depozitimi ne Regjistrin Tregtar te dokumenave te shoqerise anonime "Prodhime REFRAKTARE" sh.a. vendimin e Këshillit Mbiqëqyrës të "Refraktare" sh.a. Elbasan te dates 01.11.2005

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7638, date 28 Nentor 1992, "Per shoqerite tregtare". Ligjin Nr. 7667 date 28 janar 1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

PER KOMPETENCE

**SEKSIONI TREGTAR
GJYKATES SE RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË**

Shoqëria anonime "Prodhime Refraktare" sh.a. Elbasan eshte regjistruar prane Gjykates se rrethit Tirane me vendimin 11803 date 10.08.1995, me aksioner te vetem Ministrinë e Finaneave.


Me vendimin 11803/1 date 23.02.1996 të Gjykates se rrethit Tirane, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.16/1 date 29.01.1996 të Ministrisë së Financave lidhur me zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Prodhime Refraktare" sh.a Elbasan, nga 420.000.000 leke në 450.624.000 Lekë.

Me vendimin e datës 17.07.1996 të Gjykates se rrethit Tirane, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.2/17 date 26.10.1995 të aksionerit të vetëm të shoqërisë, lidhur me privatizimin nëpërmjet shitjes 100% të aksioneve të shoqërisë tregtare Refraktare sh.a Elbasan.

Me vendimin 11803/2 date 24.07.1996 të Gjykates se rrethit Tirane, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 dhe Nr.2 date 05.04.1996 te Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve te Shoqerise tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan për ndryshimet në statut dhe në aktin e Themelimit, si dhe zgjedhjen e antareve te Këshillit Mbiqëqyrës.

Me vendimin e dates 28.07.2000 të Gjykates se Shkallës se Parë, Tirane, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 date 31.05.2000 te Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve te Shoqerise tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan, me të cilën është aprovuar raporti i ekspertit kontabël të autorizuar Eduart Kila për





“REFRAKTARE Sh.a.”

ZONA INDUSTRIALE ELBASAN

ALBANIA

Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 53

(E - Mail) : refraktare@sanx.net

zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë tregtare REFRAKTARE s.a në masën 110.000.000 Lekë, dhe pas kësaj kapitali i shoqërisë është 340.624.000 Lekë.

Me vendimin 11803/3 date 12.02.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit të date 25.01.2002 të Asamblese së Aksionereve të Shoqërisë “REFRAKTARE” sh.a Elbasan, në të cilën është vendosur: 1- Ndryshimi i numrit të anetareve të Këshillit Mbikëqyrës nga 4 në 3 antarë dhe 2- Zgjedhja e anetarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të cilët janë: Edmond Karafili, Kryetar, Agron Shaplllo anetar dhe Edmond Tafa anetar dhe vendimi Nr.1/V-02 date 25.01.2002 i Këshillit Mbikëqyrës me të cilën është vendosur emerimi i drejtorisë së shoqërisë “REFRAKTARE” sh.a më përbërje si më poshtë: 1. Vasil Dhono, Drejtor Ekzekutiv, 2. Edi Stafa, Drejtor Ekonomik e 3. Besnik Avdiaj drejtor prodhim.

Me vendimin e dates 11803/4 date 23.07.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur për shtese në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “Refraktare” sh.a Elbasan.

Me vendimin e dates 11803/5 date 23.12.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, është vendosur rritja e kapitalit të shoqërisë “REFRAKTARE” sh.a. dhe kapitali i shoqërisë është bërë 503.187.000 (peseqind e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) Lekë.

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë “REFRAKTARE” Sh.a në mbledhjen e dates 01.11.2005 ka vendosur:

- 1- Lirimin nga detyra Drejtorit Ekzekutiv të Refraktare Sh.a. zotin Vasil Dhano.
- 2- Lirimin nga detyra e Drejtorit Ekonomik të shoqërisë Refraktare Sh.a. zotin Edi Stafa.
- 3- **Te emëroje në detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të shoqërisë Refraktare Sh.a z. EDI STAFA.**
- 4- Kohezgjatja e mandatit të Drejtorit Ekzekutiv, Z. Edi Stafa të jete 2 vjet.
- 5- Pagesa e z. Edi Stafa do të fillje nga data 01.11.2005 me page mujore neto 120.000 Leke.
- 6- Ky vendim hyn në fuqi menjëher, duke filluar efektet nga data 01.11.2005.

Bashkelidhur kësaj kerkese gjenden procesverbali i mbledhjes së datës 01.11.2005, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të kësaj shoqërie.

Per sa me sipër ju drejtohem juve si Gjykata kompetente që të pranoni depozitimin e dokumentave pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të pasqyruar ndryshimet e përmendura më lart në regjistrin tregtar, Tiranë, me 10.11.2005

KERKUESI

Edi Stafa
E Stafa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 3980 Rep.
Nr. Kol.



VERTETIM

Sot, me date 19.11.2005 (Dy mijë e pesë) para meje noteres Pranvera Karafili, ne zyrën e Noterise me seli rruga "Myslym Shyri", Pall.46/1 Tirane u paraqitën personalisht para meje:

Edi Stafa, i biri i Fiqiret, i lindur me 13.12.1969, ne Elbasan dhe, banues ne Elbasan, Lagjia "28 nentori", rruga "Abdyl Frashri Nr.28" me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv i shoqerise ananime "REFRAKTARE" sh.a, i njohur personalisht prej meje, madhorë me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili konfirmoi nenshkrimin e tij ne kërkesen drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane per depozitimimin e dokumentave te shoqerise anonime "REFRAKTARE" sh.a, si me siper me vullnetin e tij te lire e te pavesuar dhe une noterja pasi u binda per shprehjen e vullnetit te tij e vertetova ate sipas ligjit.

NOTER

Pranvera Karafili

[Signature]

REFRAKTARE SH.A.

KESHILLI MBIKQYRES

Nr. Prot.
Date 01.11.2005

**Lenda: VENDIM PER LIRIMIN NGA DETYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV,
Z. VASIL DHONO.**

Keshilli Mbikqyres, i mbledhur sot me date 28.10.05, pasi mori me shqyrtim kerkesen per lirim nga detyra e drejtorit ekzekutiv, te Z. Vasil Dhono dhe mbeshtetur ne statutin e shoqerise:

VENDOSI

1. Te miratoje lirimin e Z. Vasil Dhono nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv te RSA.
2. Te liroje nga detyra e Drejtorit Ekonomik te shoqerise RSA Z. Edi Stafa.
3. Te emeroje ne detyren e Drejtorit Ekzekutiv te shoqerise RSA Z. Edi Stafa.
4. Kohezgjatja e mandatit te Drejtorit Ekzekutiv, Z Edi Stafa te jete 2 vjet.
5. Pagesa per Z. Edi Stafa te filloje nga data 01.11.2005, me page mujore neto 120,000 leke.
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere, duke filluar nga data 01.11.2005.

Keshilli Mbikqyres

Z. Agron Shaplllo



Z. Edmond Tafa



Z. Edmond Karafilii



REFRAKTARE SH.A.

KESHILLI MBIKQYRES

Nr. Prot.
Date 01.11.2005

**Lenda: VENDIM PER LIRIMIN NGA DETYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV,
Z. VASIL DHONO.**

Keshilli Mbikqyres, i mbledhur sot me date 28.10.05, pasi mori me shqyrtim kerkesen per lirim nga detyra e drejtorit ekzekutiv, te Z. Vasil Dhono dhe mbeshtetur ne statutin e shoqerise:

VENDOSI


1. Te miratoje lirimin e Z. Vasil Dhono nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv te RSA.
2. Te liroje nga detyra e Drejtorit Ekonomik te shoqerise RSA Z. Edi Stafa.
3. Te emeroje ne detyren e Drejtorit Ekzekutiv te shoqerise RSA Z. Edi Stafa.
4. Kohezgjatja e mandatit te Drejtorit Ekzekutiv, Z Edi Stafa te jete 2 vjet.
5. Pagesa per Z. Edi Stafa te filloje nga data 01.11.2005, me page mujore neto 120,000 leke.
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere, duke filluar nga data 01.11.2005.

Keshilli Mbikqyres

Z. Agron Shaplo



Z. Edmond Tafa



Z. Edmond Karafili




11803/4

2 B Mue
16 07 2003



“REFRAKTARE Sh.a.”
ZONA INDUSTRIALE ELBASAN
ALBANIA

Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 53
(E - Mail) : refraktare@sanx.net



Nr. 51/1 Prot.

Date 11.07.2003

K E R K E S E

DREJTUAR: GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TE RRETHIT

Tirane

KERKUES: *Shoqeria Anonime Refraktare*

Zona Industriale Elbasan


OBJEKTI: Saktësim Vendimi ne baze te Nenit 17 te Ligjit Nr 7667
date 28.01.1993.

*Si depozitimet
kerkeses, shprehur
pune me shprehje
me shprehje
SHV 11803/2
24.7.96*

Shoqeria REFRAKTARE SH.A me seli ne Elbasan eshte rregjistruar
Person juridik me Vendimin Nr.11803 date 10.08.1995 te Gjykes se
Rrethit Tirane.

Asambleja e aksionereve ne mbledhjen e saj te dates 24.04.1996, me
vendimin Nr.1 ka vendosur ndryshime ne Aktin e Themelimit dhe ne
Statut, te cilat jane pasqyruar ne Vendimin Nr.11803/2 date 24.07.1996 te

Gjykates se Rrethit Tirane. Ndermjet te tjerash eshte vendosur shtesa ne objektin e veprimtarise se shoqerise, si me poshte vijon:



Veprimtari prodhuese per materiale refraktare e qeramike, ndertimore, inerte, mineralogjike, konstruksione metalike, pajisje e makineri duke perdorur burimet e brendshme dhe ato jashte vendit. Veprimtari ndertimi duke perfshire ato civile e industriale.

Veprimtari transportuese brenda dhe jashte vendit te mallrave per vete dhe per te trete.

Veprimtari eksportuese dhe importuese te lendeve te para, produkteve te gateshme, mineraleve, naftes si dhe produkteve te tyre, pajisje e makineri si dhe linja industriale.

Veprimtari tregtare perfshire tregtimin e mallrave industriale dhe ndertimore si dhe pajisje e makineri e linja industriale.

Veprimtari studimore dhe projektuese ne fusha te ndryshme te ekonomise, ndertimore, mekanike dhe elektrike, etj.

Veprimtari investuese dhe financuese ku shoqeria do te perdore per kete qellim fonde te saj si dhe fonde te institucioneve financiare dhe bankare vendase e te huaja, private e publike, marrje dhe dhenje me qera objekte dhe mjete, pajisje dhe zyra, ambiente te ndryshme, pasuri te lujtshme e te palujtshme.

Brenda kuadrit te dispozitave ligjore shoqeria ka te drejte te marre te gjitha masat dhe te kryeje çdo biznes brenda dhe jashte vendit te pershtatshem per arritjen e qellimit te shoqerise, kjo e cila perfshin krijimin e filialeve te reja

brenda e jashte vendit, blerjen dhe krijimin e subjekteve te tjera ekonomike dhe interesat e saj per pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.”

Duke qene se nga Gjykata ne Vendim eshte emetuar pasqyrimi i aktivitetit te shtuar me vendim Nr 1 te Asamblese date 24.04.1996, ne baze te Nenit 17 te ligjit 7667 date 28.01.1993, kerkoj te saktesohet ky vendim.

KERKUESI
REFRAKTARE SH.A
Drejtori ekzekutiv
Vasil Dhono





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NO. 2104...REP

VERTETIM

Ne Tirane sot me date 15.07.2003, ditën e marte u paraqit personalisht perpara meje noteres Pranvera Karafili ,me seli ne Rrugen "Myslym Shyri "P.46/1:


Z.Vasil Dhono I biri I Llazit , lindur me 30/06/1950,banues ne Elbasan , Drejtori Ekzekutiv I SH.A.Refraktare Elbasan , I njohur personalishte prej meje te cilit I konfirmoj nenshkrimin e vene ne kerkesen drejtuar Gjykater se Shkalles se Pare Tirane .

NOTERE

Pranvera Karafili

[Signature]





“REFRAKTARE Sh.a.”

**ZONA INDUSTRIALE ELBASAN
ALBANIA**

Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 53

(E - Mail) : refraktare@sanx.net

S B Mucy
3 12 009
BR2004

11803/5

KËRKESË
PER DEPOZITIMIN E DOKUMENTAVE TE SHOQERISE
ANONIME “REFRAKTARE” SH.A, “PER RRITJE TË KAPITALIT
TË KËSAJ SHOQËRIE”

KËRKUES: VASIL DHONO, i biri i Llazit, lindur në Ersekë, më 1950, banues ne Elbasan, me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv i shoqerise ananime “REFRAKTARE” sh.a

OBJEKTI: Depozitimi ne Regjistrin Tregtar të dokumenave te shoqerise anonime “Prodhime REFRAKTARE” sh.a, vendimin e Asamblese se Aksionereve te Shoqerise “Refraktare”sh.a, Elbasan te dates 25.06.2004

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7638, date 28 Nentor 1992, "Per shoqerite tregtare", Ligjin Nr. 7667, date 28 Janar 1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

PER KOMPETENCE

SEKSIONIT TREGTAR
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË


Shoqëria anonime “Prodhime Refraktare sh.a. Elbasan është regjistruar prane Gjykares së rrethit Tiranë me vendimin 11803 datë 10.08.1995, me aksioner të vetëm Ministrinë e Financave.

Me vendimin 11803/1 date 23.02.1996 të Gjykares së rrethit Tiranë është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.16/1 datë 29.01.1996 i Ministrisë së financave lidhur me zmadhimin e kapitalit të shoqërisë ‘Prodhime Refraktare’ sh.a Elbasan, nga 420.000.000 leke në 450.624.000 leke.

Me vendimin e datës 17.07.1996 të Gjykares së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Urdhërit Nr.2/17 datë 26.10.1995, të aksionerit të vetëm të shoqërisë, lidhur me privatizimin nëpërmjet shitjes 100% të aksioneve të shoqërisë tregtare Refraktare sh.a Elbasan.

Me vendimin 11803/2 date 24.07.1996 të Gjykares së rrethit Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 dhe Nr.2 date 05.04.1996 te Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve te Shoqerise tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan për ndryshimet në statut dhe në aktin e Themelimit, si dhe zgjedhjen e antareve te Këshillit Mbikëqyres.

Handwritten signatures and notes:
SEKSIONIT TREGTAR
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË
Prof. Dr. M. M. M.
29.06.04
25.06.04
Refraktare sh.a
Asamblese
Shoqerite
Refraktare
Report Asamblese



Me vendimin e dates 28.07.2000 të Gjykatës se Shkallës se Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 date 31.05.2000 te Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve te Shoqerise tregtare REFRAKTARE sh.a Elbasan, me të cilën është aprovuar raporti i ekspertit kontabël të autorizuar Eduart Kila për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë tregtare REFRAKTARE s.a në masën 110.000.000 Lekë, dhe pas kësaj kapitali i shoqërisë është 340.624.000 Lekë.


Me vendimin 11803/3 date 12.02.2002 të Gjykatës se Shkallës se Parë, Tiranë, është vendosur depozitimi i Vendimit të date 25.01.2002 te Asamblese së Aksionereve te Shoqerise “REFRAKTARE” sh.a Elbasan, në të cilën është vendosur:1- Ndryshimi i numrit te anetareve te Keshillit Mbikëqyrës nga 4 në 3 antarë dhe 2- Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të cilët janë: Edmond Karafili, Kryetar, Agron Shaplo anetar dhe Edmond Tafa anëtar dhe vendimi Nr.1/V-02 date 25.01.2002 i Këshillit Mbikëqyrës me të cilën është vendosur emerimi i drejtorisë së shoqërisë “REFRAKTARE”sh.a më përbërje si më poshtë:1.Vasil Dhono,Drejtor Ekzekutiv, 2.Edi Stafa, Drejtor Ekonomik e 3.Besnik Avdiaj drejtor prodhim

Me vendimin e dates 11803/4 date 23.07.2003 të Gjykatës se Shkallës se Parë, Tiranë, është vendosur për shtese në objektin e veprimtarise se shoqerise “Refraktare”sh.a Elbasan.

Me vendimin e Asamblese se Aksionerve te shoqërisë “REFRAKTARE”sh.a Elbasan, datë 25.06.2004 është vendosur:

- Rezerva nga rivleresimi prej 66.856.706 (Gjashtedhjetë e gjashtë milionë e teteqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e gjashtë) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
- Rezerva ligjore ne masen 30.062.400 (tridhjetë milion e gjashtedhjetë e dy mijë e katerqind) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
- Fondi rezerve ne masen 30.079.313 (tridhjetë milion e shtetëdhjetë e nente mijë e treqinde trembedhjetë)Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
- Fitimi i vitit 2003 në masën 35.564.581 (tridhjetë e pese milion e peseqind e gjashtedhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.

Në këtë mënyrë, pas rritjeve të mësipërme të kapitalit te shoqërisë “REFRAKTARE”sh.a, kapitali i shoqërisë nga 340.624.000 Lekë bëhet 503.187.000 (peseqind e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e shtate mijë) Lekë.



“REFRAKTARE Sh.a.”
ZONA INDUSTRIALE ELBASAN
ALBANIA

Tel: ++355 54 545 65 Fax: ++355 54 535 33
(E - Mail) : refraktare@sanx.net

313 Muses
88 12 2004
230 HIE T
OR 2004



- Fitimi i vitit 2003 ne masen 35.564.581 (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e gjashtedhjetë e katermijë e pesëqind e tetëdhjetë e nje) leke te kaloje ne rritje te kapitalit te Shoqerise.

Ne kete menyre, pas rritjeve te mesiperme te kapitalit te shoqerise “REFRAKTARE” sh.a, kapitali i shoqerise nga 340.624.000 Leke behet 503.187.000 (peseqind e tre milion e njeqind e tetëdhjetë e shtate mije) Leke.

Bashkengjitur kesaj kerkese gjendet procesverbali i mbledhjes se dates 25.06.2004 se Asamblese se Aksionereve te Shoqerise Refraktare sh.a me vendimet perkatese dhe raporti Ekspertit Kontabel te Autorizuar z. Eduart Kila, lidhur me vleresimin e kapitalit te shoqerise sipas kerkeses se bere nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise qe mban daten 28 Maj 2004, i cili ka certifikuar ndryshimet ne rritjen e kapitalit te shoqerise .

Per sa me siper, Ju drejtohem i Juve si Gjykata kopetente qe te pranoni depozitimin e dokumentave prane Gjykates se Rrethit te Tiranës, per te pasqyruar ndryshimet e permendura me lart ne regjistrin tregtar.

Tirane, me 11.12.2004

KERKUESI

DREJTORI EKZEKUTIV

Ing. Vasil DHONO



Vasil Dhono

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 4183 Rep.

Nr. 281 Kol.

VERTETIM

Sot, me date 13.12.2004 (Dy mijë e katër) para meje noteres Pranvera Karafili, ne zyren e Noterise me seli rruga "Myslym Shyri", Pall.46/1 Tirane u paraqitën personalisht para meje:

VASIL DHONO, i biri i Llazit, lindur në Ersekë, më 1950, banues ne Elbasan, me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv te shoqerise ananime "REFRAKTARE" sh.a, i njohur personalisht prej meje, madhorë me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili konfirmoi nenshkrimin e tij ne kërkesen drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane per depozitim e dokumentave te shoqerise anonime "**REFRAKTARE**" sh.a. si me siper me vullnetin e tij te lire e te pavesuar dhe une noterja pasi u binda per shprehjen e vullnetit te tij e vertetova ate sipas ligjit.

NOTER

Pranvera Karafili

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË, ELBASAN

Nr.....Rep

Nr.....Kol



PROCES-VERBALI
I Mbledhjes se Asamblese se Aksionereve te
Shoqërisë "REFRAKTARE"SH.A

Datë 25.06.2004

Në zbatim të dispozitave për shoqëritë tregatë, me lajmërim të bërë nga shoqëria „REFRAKTARE“sh.a, nëpërmjet Qendrës së Regjistrimit të Aksionereve”sh.a, me seli në Tiranë, në të cilën është bërë regjistrimi i aksioneve të kësaj shoqërie. Sot më datë 25.06.2004, ora 10-00, në **prezencën time, noterit publik Pëllumb Barçi, Elbasan** në Institutin e Metalurgjisë, Elbasan u mbajt mbledhja e Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë “REFRAKTARE”sh.a, dhe unë noteri në bashkëpunim me sekretarin e shoqërisë Edi Stafa, verifikova numrin e aksioneve ku kostatova që marrin pjesë aksionere që përfaqësojnë 76,66% aksione të shoqërisë. Pasi u konstatua quorumi i duhur për fillimin e mbledhjes së Asamblese se Aksionereve, u bë hapja e mbledhjes nga kryetari i saj zoti Agron Shaplllo.

Pas kësaj kryetari i Asamblesë së shoqërisë zoti Agron Shaplllo, publikoi dhe njëhere rendin e dites:

1- Analiza e aktivitetit ekonomiko- financiar për vitin 2003.

Raporti i - Drejtorit
- Eksperti Kontabel
- Këshilli Mbikëqyrës

2- Pyetje dhe diskutime rreth raporteve.


3- Miratimi i aktivitetit ekonomik të vitit 2003.

4- Miratimi i shtimit të kapitalit të shoqërisë me shumën 162.563.000 (njëqind e gjashtedhjetë e dy milion e pesëqind e gjashtedhjetë e tre mijë) leke, sipas projektit të bërë nga eksperti kontabel Eduart Kila dhe Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë.

Miratohet unanimisht rendi i dites nga të gjithë aksionerët pjesëmarrës.

ANALIZA E AKTIVITETIT EKONOMIKO-FINANCIAR PËR
VITIN 2003

- Kryetari i Asamblese zoti Agron Shaplllo, i jep fjalën zotit Vasil Dhono, Drejtor i Ekzekutiv i shoqërisë “REFRAKTARE”sh.a.

- 
- Drejtori Ekzekutiv i shoqërisë "REFRAKTARE"sh.a, zoti Vasil Dhono lexon raportin e Drejtorisë së Shoqërisë. (Pas kësaj raporti i tij depozitohet në sekretarinë e shoqërisë).
 - Kryetari i Asamblese zoti Agron Shaplllo, i jep fjalën zotit Eduart Kila, Ekspert kontabel i shoqërisë "REFRAKTARE"sh.a.
 - Eksperti Kontabël i shoqërisë "REFRAKTARE"sh.a zoti Eduart Kila, lexon raportin. (Pas kësaj raporti i tij depozitohet në sekretarinë e shoqërisë).
 - Kryetari i Asamblese zoti Agron Shaplllo, i jep fjalën zotit Edmond Tafa, Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë "REFRAKTARE"sh.a.
 - Zoti Edmond Tafa, Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë "REFRAKTARE"sh.a. lexon raportin e Këshillit Mbikëqyrës. (Pas kësaj raporti i tij depozitohet në sekretarinë e shoqërisë).
 - Pasi Asamblea degjon raportet e përgatitura e merr fjalën Zoti Agron Shaplllo- Kryetar i Asamblese.

PYETJE DHE DISKUTIME RRETH RAPORTEVE

Zoti Agron Shaplllo- Kryetar i Asamblesë

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, pas 15 minuta pushim, vazhdojmë me pyetje, përgjigje dhe diskutime.

AKSIONERET BEJNË PYETJE SI MË POSHTË

- Zoti Niazi Xhemalaj - Aksioner

Kur parashikohen të fillojnë provat pa ngarkesë?

Investimi mbulohet nga kredia e marrë dhe sa është ndryshimi?

- Zoti Ilia Çullhaj - Aksioner

Unë dhe zoti Nikolla nosi kemi përgatitur një listë me pyetje?

(Zoti Çullhaj dorëzon ato sekretarisë e cila i lexon dhe i dorëzon një kopje personave përgjegjës për përgjigje).

- Zoti Nimet Kasa - Aksioner

A është parashikuar të prodhohen materiale refraktare me investimet e reja?

- Zoti Edlund Rroka- Aksioner

Sa është kosto e prodhimit të një tulle?

Sa janë shpenzimet administrative në raport me të ardhurat në total?

Sa jnaë të ardhurat nga qeraja ?

Sa janë depozitat në USD ?

Sa është vlera e saktë e investimit ? Në një dokument ishte 3.000.000 EURO.

- Zonja Emine Shehu- Aksionere

A ka mundësi që raportet që lexohen këtu, të fotokopjohen ti kemi përpara edhe ne?

- Zoti Agron Shaplllo- Kryetar i Asamblesë

A ka pyetje të tjera?

(Pritet pak – dhe nuk ka pyetje të tjera)

Meqëse nuk ka pyetje të tjera bejmë gjysëm ore pushim.

PËERGJIGJE PYETJEVE

Zoti Vasil Dhono- Drejtor Ekzekutivë

Provat fillojnë që në mujain Gusht, me repartin e përpunimit të lendës së pare 01, në Tetor me Sillosin, në Nëntor me repartin e tharjes dhe pjekjes, në Dhejtor me stivim dhe shkarkim dhe ne Janr 2005 do të bëhen provat komplekse.

-Investimi mbulohet 2.5 milion Euro kredi dhe 1.000.000 Euro nga shoqëria, pra gjithesej 3.5 milion Euro. Vleresimi nuk është absolut, ne jemi te interesuar ta bejme me sa me pak shpenzime.

Për prodhim tjegulla apo materiale te tjera nuk mund te thuhej asnjehere jo. Gjithcka behet. Sot, i jemi kushtuar ketij investimi. Me pas ju takon juve te merrni vendime per keto probleme.

Përgjigje pyetjeve të Ilia Çullhai dhe Nikolla Nosi

Zoti Edmond Karafili- Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

- Lidhur me rezervuaret e solarit, procedura e plotesimit te dokumentacionit ka vazhduar. Ështe marre licenca këtë vit (në 2004, dy muaj më parë). Situata ka qënë shumë e pa përshtatshme për arsye të çmimit në treg. Për fat të mirë është shfrytëzuar karburanti vendas me çmim stabil.
- Shpenzimet në Gjermani janë emërtime të vecanta, nga pagesa për cmontim të linjës, blerje matëëriale dhe vegla pune etje. Këto shpenzime janë të evidentuara dhe të kontrolluara nga dega e financës. Kush të dojë, të shkojë ti shohë zë për zë.
- Mbi huanë e marrë në bank. Me të janë blerë makineri me EURO nga Gjermania. Shpenzimet e brendshme janë paguar në Lekë, që shoqëria i ka patur gjendje. Punimet ndertimore janë berë me Lekë. Në Gjermani shpenzimet janë bërë me Euro. Për supervizionin ka kontrata. Janë marrë oferta edhe në Gjermani nga firma dhe individë, kemi bërë zgjedhjen e duhur(130.000 euro për specialistin gjerman). Kontrata është bërë në pagë bazë orare.
- Për matëriale refraktare, kërkesat e tregut janë shumë të pakta, sa prodhimi i kësaj kërkesë të tregut mbulon vetëm 10 dite pune ne vit për prodhimin e tyre.

Zoti Vasil Dhono- Drejtor Ekzekutivë

- Për përmirësimet: 2,7 milion është bërë 4,4 milion për solarin. Për ujin kemi kursyer 1,4 milion Lekë nga sistemi i mbyllur i ujit që u bë në Korrik.
- Për pytjen e pestë - me siguri nuk është lexuar mirë raporti, shitja ka rënë por prodhimi ka qënë 100%.
- Pyetja e tete- Me kursion nuk ka patur probleme. Eshte marre Euro dhe paguhet Euro.
- Për interesat, kjo gjë do të varet nga shansi që do të kemi në kursin e kembimit.
- Kosta e një tulle: 6.048 Lekë/për FN.
- Raporti i shpenzimeve të administratës është 4% mbi xhiron.
- Të ardhurat nga qeraja janë 24.000 USD.
- Vlera e investimit është 3,5 milion Euro, është harxhuar 56% mbeten dhe 44%, po përpiqemi ti minimizojnë shpenzimet.

Zoti Eduart Kila- Ekspert Kontabel i shoqerise

Valuta ne banke. Vleresimi i bilancit behet ne Leke. Te dhenat jepen vetem ne Lekë. Depozita në USD baras 11.000.000 Lekë rreth 100.000 USD.

Zoti Edlund Rroka- Aksioner

A do të quhet investimi, kapital themeltar?

Zoti Agron Shaplo – Kryetar I Asamblese së Shoqërisë

Investimi është pjese e asetëve te shoqerise.

Zoti Edmond Karafili – Kryetar I Këshillit Mbikëqyrës

Për dokumenat e paraqitura, matërialet jane depozituar ne sekretari dhe mund t'i lexojnë të gjithë ata që dëshirojnë.

Zoti Agron Shaplo – Kryetar I Asamblese së Shoqërisë

Nuk është mire, që sekretet e shoqërisë t'i jepen cdo personi. Te dhenat duhet te jepen sintetike sepse ato mund te dekonspirohen dhe I prishin punë shoqërisë.

Zoti Niazi Xhemalaj - Aksioner

A jemi regjistruar në bursë?

Shitblerja e aksioneve brenda për brenda aksionereve ekzistues nuk përbën shkelje ligji?

Zoti Agron Shaplo – Kryetar I Asamblese së Shoqërisë

Bursë nuk ka. Nese do hapet do hyjmë me vendim të Asamblese se Aksionereve.

Shitblerja e aksioneve brenda per brenda nuk përbën shkelje ligji. Eshte vendimi i asamblese dhe eshte ne statut.

Zoti Eduart Kila- Ekspert Kontabel i shoqerise

Ligjërisht nëse ndonjëri do shesë aksione duhet ti ofroje ato më parë aksionereve të tjere. Nëse aksioneret e tjerre nuk deshirojnë ti blejnë, atëherë këto aksione iu ofrohen personave të tjere jashtë shoqërisë.

(Sqaron bursën në lidhje me shoqërinë "Birra Tirana")

Bursa ekziston vetëm për letra me vlerë. Nuk funksionon për shoqëritë aksionere si kjo e juaja.

DISKUTIME

Zoti Edlund Rroka- Aksioner

Kam dy sugjerime.

- 1- Për statutin e shoqërisë. Të gjitha aksioneret të kënaqur nga nje statut që të kenë mundësi të diskutojnë sic duhet.
- 2- U bene 7-8 vjet me te njejtat figura te Këshillit Mbikëqyres. Është normale të mos të jenë gjithmone po ata anetare te Këshillit Mbikëqyrës. Në statut të përcaktojmë ndryshimin për të krijuar një bashkëpunim e sinqeritet me te madh midis aksionereve me te medhenj dhe aksionereve të vegjel.

Në Asamble të raportohet mbi koston e cmimin, sepse une duhet te di, që në këte apo date, u bë ky apo ai vleresim cmimesh, për rritjen apo uljen e tyre. Kështu nuk krijojmë as dyshime. Ky problem është serioz. Edhe eksperti kontabel duhet te kontrolloje vendimet e Këshillit Mbikëqyrës.

- Shoqëria duhet të funksionojë mirë. Nuk më vjen mirë që nuk kanë ardhur të gjithë aksionerët.
- Kam besim tek ky staf drejtues që investimi do te eci mire. Është një investim serioz.
- Faturat duhet të jenë të sakta, sipas numrit te serise, sepse pa to mund te kalojne shifra.

Zoti Eduart Kila- Ekspert Kontabel i shoqërisë

Të gjithë blerjet bëhen me fatura të modulit 4. Por ka disa blerje me fatura të tjera. Shitjet bëhen me atura TVSH-je. Problemi është që të gjitha blerjet të bëhen me modularin 4.

Zoti Sopot Banka- Aksioner

Ne nuk jemi ne gjendje te kontrollojme punen tuaj sepse nuk jemi specialist. Eshte hera e pare qe bejme mbledhje te qete.

Degjova raportin e ekspertit kontabel dhe me pelqeu, këte pershtypje kam dhe për te tjeret. Për ne është fat i mirë që uzina drejtohet nga ju, dhe po ecen mirë. Por ju e keni vendosur që ne Tirane, që do të ndani 4 ose 6 % të fitimit. Ne na vine e na thone shoket tane informatore. Kështu duket që sikur ne mbledhje na matni pulsën. Ne presim të marrim dicka për të paguar faturat e dritave dhe të ujit, prandaj nëse ka mundësi ta drejtojmë punën me nikoqirlllek.

**NË PËRFUNDIM TË MBLEDHJES
ASAMBLEJA E AKSIONEREVE TE SHOQËRISË
"REFRAKTARE" SH.A E DATËS 25.06.2004
V E N D O S I**

- Miratimi i aktivitetit ekonomiko-financiar te vitit 2003 dhe treguesit kryesore per vitin 2004 te paraqitura ne raportet e Drejtorise dhe te Keshillit Mbikeqyres.

**Votohet pro me shumice votash te cilet i verifikova ne prezence une
noteri Pellumb Barçi.**

- Gjate vitit 2005 të bëhet riklasifikimi e aktiveve te qëndrueshme të trupëzuara nga një grup specialistësh të shoqërisë.

**Votohet pro me 100% te votave, të cilat i verifikova ne prezence une
noteri Pellumb Barçi.**

- Rezerva nga rivleresimi prej 66.856.706 (Gjashtedhjetë e gjashtë milionë e teteqind e pesedhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e gjashtë) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
- Rezerva ligjore ne masen 30.062.400 (tridhjetë milion e gjashtedhjetë e dy mijë e katerqind) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
- Fondi rezerve ne masen 30.079.313 (tridhjetë milion e shtetëdhjetë e nente mijë e treqinde trembedhjetë) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.
- Fitimi i vitit 2003 në masën 35.564.581 (tridhjetë e pese milion e peseqind e gjashtedhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) Lekë te kalojë në rritje te kapitalit të shoqërisë.

**Në këtë mënyrë, pas rritjeve të mësipërme të kapitalit të shoqërisë
REFRAKTARE"sh.a Elbasan, kapitali i shoqërisë nga
340.624.000 Lekë bëhet 503.187.000 (peseqind e tre milion e
njëqind e tetëdhjetë e shtate mijë) Lekë.**

**Votohet pro me 100% votave, te cilat i verifikova ne prezence une
noteri Pellumb Barçi.**

- Miratohet raporti i Ekspertit Kontabel i Autorizuar z. Eduart Kila, me të cilin ka berë certifikimin e rritjes kapitalit.

**Votohet pro me 100% te votave, të cilat i verifikova ne prezence une
noteri Pellumb Barçi.**

- Ekspert Kontabël i Autorizuar për auditimin e shoqërisë rizgjidhet z. Eduart Kila.

**Votohet pro me 100% te votave, te cilat i verifikova ne prezence une
noteri Pellumb Barçi.**

- Të depozitohet ky vendim në Regjistrin Tregtar të Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.


Për pasqyrimin e mbledhjes së Asamblesë së Aksionereve të Shoqërisë "REFRAKTARE"sh.a te dates 25.06.2004 dhe te vendimeve të marra në të u mbajt ky proces-verbal që nënshkruhet rregullisht nga Sekretari i Mbledhjes zoti, Edi Stafa, kryetari i Asamblese se Aksionereve te Shoqerise "REFRAKARE"sh.a zoti Agron Shaplo dhe nga unë noteri Pëllumb Barçi, e vertetoj atë sipas ligjës.

SEKRETARI I MBLEDHJES
EDI STAFA

KRYETARI I ASAMBLESE
AGRON SHAPLLO



NOTERI
PELLUMB BARÇI





**PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE JASHTEZAKONSHME TE ASAMBLESE SE
AKSIONEREVE TE SHOQERISE REFRAKTARE SH.A PER VITIN 2005**

Ne Elbasan, sot me date 12.05.2006, ora 10, ne sallën e mbledhjes te Institutit te Studimeve dhe Projektive Metalurgjike (prane ish-Kombinatit Metalurgjik Elbasan), dhe sipas thirrjes se bere nga Drejtoria e Shoqerise "Refraktare sh.a." nepermjet Qendres se Regjistrimit te Aksioneve Tirane, duke ja derguar çdo aksioneri ne adresen e tij personale, Aksioneret e shoqerise "Refraktare sh.a" me kapital themeltar prej 503.187.000 leke, ne pranine time notere Resmie Ruci, jane mbledhur ne Asamblene e Jashtezakonshme.

Lista e pranise eshte hartuar nga Qendra e Regjistrimit te Aksioneve Tirane. Çdo aksioner pjesemarrës dorezon ftesën derguar nga QRA gjate hyrjes ne Asamble.

Kryetari i Asamblese Z. Agron Shaplllo fton sekretarine e Asamblese te perbere nga Zj. Angjelina Gjeta dhe Z. Dolor Roshi te numerojne aksionet prezente. Kryetari i Asamblese, mbeshtetur ne listen e pranimit dhe konfirmuar nga noterja vezhguese, deklarën pjesemarrjen me 81.321% te aksioneve, perfaqesuar nga 38 aksionere.

Meqenese Asambleja ka siguruar quorumin e kerkuar nga ligji, Kryetari i Asamblese Z. Agron Shaplllo e deklarën Mbledhjen e hapur.

Kryetari i Asamblese Z. Agron Shaplllo shpall rendin e dites, sipas njoftimit te bere. Materialet e rendit te dites kane qene depozituar per tu pare ne Drejtorine e shoqerise nga çdo aksioner 15 dite para zhvillimit te mbledhjes.

1. Analiza e aktivitetit ekonomiko-financiar per vitin 2005 dhe investimin ne RSA2
 - a. Raport i Drejtorise
 - b. Raporti i Ekspertit Kontabel te autorizuar te shoqerise.
 - c. Raporti i Keshillit Mbikqyres.
2. Ndryshime ne Statut per Keshillin Mbikqyres dhe miratimi i anetareve te tij.
3. Miratimi i aktivitetit dhe bilancit kontabel te shoqerise "Refraktare sh.a." per vitin 2005. Caktimi i fitimit per kete periudhe.
4. Miratimi i pjesemarrjes se shoqerise "Refraktare sh.a." ne Shoqaten Kombetare te Industrialisteve te Tullave dhe Tjegullave (SH.K.I.T.T.)
5. Zgjedhja e Ekspertit Kontabel te Miratuar per vitin 2006
6. Pyetje dhe diskutime rreth raporteve.
7. Te ndryshme



Z. Nazmi Sadushi – Aksioner

Perse quhet Mbledhje e Jashtezakonshme dhe jo e Zakonshme

Z. Agron Shaplo – Kryetar i Asamblese.

Quhet Mbledhje e Jashtezakonshme sepse do te merren vendime per ndryshime ne statut lidhur me mandatin Keshillit Mbikqyres dhe me tej ne zgjedhjen e anetareve te tij.

Z. Agron Shaplo – Kryetar i Asamblese.

Para se te fillojme me leximin e raporteve kerkoj te bej nje lajmerim:

Nga muaji nentor 2005, Z. Edi Stafa eshte emeruar nga Keshilli Mbikqyres. Drejtor Ekzekutiv i Shoqerise ne vend te Z. Vasil Dhono dhe ne vend te z. Edi Stafa ka filluar detyren Zj. Angjelina Gjeta.

Z. Sabaudin Çerma – Aksioner

Perse ish drejtori nuk eshte ketu ne mbledhje? Ne duhet te dime perse u shkarkua ish drejtori.. Per dallavere apo per interesa te tjera? Ne se eshte pushuar per dallavere atehere duhej ti drejtoheshit organeve ligjore.

Z. Niazi Xhemalaj – Aksioner

Mbledhja duhej bere kur u shkarkua drejtori i meparshem dhe u vendos i riu.

Z. Agron Shaplo – Kryetar i Asamblese.

Shkarkimi dhe zevendesimi i Drejtorit Ekzekutiv eshte kompetence e Keshillit Mbikqyres dhe jo i Asamblese se Shoqerise mbi bazen e ligjit dhe Statusit.

Vazhdohet me Rendin e Dites.

- Kryetari i Asamblese Z. Agron Shaplo i jep fjales Z. Edi Stafa, Drejtor Ekzekutiv.
- Drejtori Ekzekutiv Z. Edi Stafa mban raportin e Drejtorise se Shoqerise “Mbi aktivitetin ekonomik financiar per vitin 2005” per RSA1 dhe “Aktiviteti investues per linjen e re RSA2 per vitin 2005”.
(Raporti depozitohet ne sekretari)
- Kryetari i Asamblese Z. Agron Shaplo i jep fjales Z. Eduart Kila, Ekspert Kontabel, i cili mban raportin e tij.
(Raporti depozitohet ne sekretari)
- Kryetari i asamblese Z. Agron Shaplo i jep fjalen Z. Edmond Karafili, Kryetar i Keshillit Mbikqyres i cili lexon raportin e Keshillit Mbikqyres.
(Raporti depozitohet ne sekretari)

Pasi Asambleja degjon raportet e pergatitura e merr fjalen Z. Agron Shaplo – Kryetar i Asamblese.



Z. Agron Shaplo – Kryetar i Asamblese.

Para se te kalojme ne piken e dyte te rendit te dites te vazhdojme me pyetje per raportet e mesiperme dhe pastaj bejme gjysme ore pushim.

Pyetjet nga Aksioneret jane si me poshte:

Z. Hajdar Hasa - Aksioner

- Pas investimit sa leke kane ngelur gjendje?
- Sa aksionere kane ngelur ne pune ne shoqeri?

Z. Nikolla Nosi - Aksioner

- Shifrat e dhena jane sipas planit, por edhe realiteti a ndjek pak a shume te njejten ecuri? Muajt Janar –Prill 2006 jane realizuar sipas planifikimit?

Z. Riza Fona – Aksioner

- A u eshte vene afat debitoreve per likujdim?

Z. Vladimir Agolli – Aksioner

- A dote kete jetegjatesi fabrika kundrejt konkurrenteve?
- A do te kete eksport?
- Keshilli Mbikqyres pse nuk i ben me konkrete problemet. Nga aksioneret ka specialiste te vjeter me pervojje. Na tregoni tipet e tullave qe prodhoni.
- Pse nuk beni oferta pune per aksioneret qe kane qene ne pune por merrni punonjes te rinj?
- Te gjithë e dime qe njeri nga aksioneret po lufton me jeten; pse te mos ndihmohet nga shoqeria.

Z. Edlung Roka - Aksioner

- Me vendimin e marre me BE nga 1 korriku do te hiqen taksat doganore. Si eshte menduar te perballohet konkurenca e tregut?
- Ku qendron ndryshimi midis Raportit te Drejtorise dhe raportit te Ekspertit Kontabel?

Z. Sabaudin Çerma – Aksioner

- Ne raport u tha qe ka nje sasi stoku prodhimi. Pse ka stok dhe si do te parandalohet?
- Çfare masash merren per parandalimin e debitoreve?
- Pse eshte hequr Drejtori Vasil Dhono, per paaftesi apo per dallavere? A ka shkelur ligjin?
- Sa jane te ardhurat e magazines te leshuar me qera?
- A eshte menduar ndonjehere qe tek ne mund te prodhohen tulla betoni, pllaka majolike etj. Majfton nje investim mjaft i vogel qe mund te shlyhet shpejt. Ka

kerkesa ne treg. Ne Tirane eshte nje firme qe ka nje prese te vogel dhe prodhon sasi te konsiderueshme pllakash.

Te behet nje plan kete vit, te shihet mundesia e ngritjes se linjes vitin tjeter.

Z. Naim Ramollari – Aksioner

- Per 3 vitet e fundit kemi kemi renje te fitimit. Po per 2006, pse biem ne 12 milion. Pastaj hiq edhe tatimin dhe shkon ne 8 milion.
- Si behet analiza e kostos, per te dy fabrikat apo vec e vec?
- Mendohet per ristrukturimin e njesise se Marketingut apo do te vazhdoje keshtu? Si mund te riorganizohet shitja, pasi une shoh qe tek fabrika e re ka shume produkt pa shitur.
- Shohim se ka material refraktar stok ne magazine. Pse nuk bluhen dhe te shiten. A ka program per te bluarjen dhe shitjen e materialeve refraktare?

Z. Skender Muska – Aksioner

Ka pese vjet qe nuk kemi marre dividend. A do te marrim dividend kete vit?

Pergjigje Pyetjeve

Nga Z. Edi Stafa - Drejtor Ekzekutiv.

Pergjigje pyetjeve te Z. Hajdar Hasa


- Rezultati faktik ka ndjekur ate te planit. Gjendja e parave me 31.12.2005 eshte 12 milion leke.
- Numri i aksionereve qe jane te punesuar ne shoqeri eshte 20.

Pergjigje pyetjeve te Z. Riza Fona

- Çeshtja e debitoreve eshte nje problem i vazhdueshem qe asnjehere nuk do te mbyllet perfundimisht. Mund te zvogelohet por jo te eliminohet krejtesisht. Kohet e fundit ka nje permiresim 20-30% te pagesave nga debitoret.

Pergjigje pyetjeve te Z. Vladimir Agolli.

